



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar përmbledhës “Për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2023”

RAPORTI I KONSOLIDUAR I AUDITIMIT
“MBI AUDITIMIN PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË
REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E VITIT 2023”

Shkurt 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqja
1	Përmbledhje ekzekutive	3-5
1.1	Hyrje	4
1.2	Objektivat e auditimit	4
1.3	Qëllimi i auditimit	4-5
1.4	Metodologjia	5
1.5	Konkluzione	5
2	Opinioni i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	5
3	Përshkrimi i auditimit	5-97
3.1	Kontrata e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit	6-29
3.2	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara	29-46
3.3	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	46-80
3.4	Licencimi dhe monitorimi i subjekteve me veprimtari në fushën minerare	80-97
4	Anekse	97-99

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 1325/7 prot., datë 04.11.2024, me objekt “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2023”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi zbatimin e rekomandimeve të lëna në 4 (katër) auditime të ushtruara gjatë vitit 2023, në 6 subjekte. Në përfundim të auditimit, janë hartuar projektraportet e auditimit për secilin subjekt, bazuar në Letrat e punës, Akt konstatimet, vërejtjet e bëra nga subjektet. Projekt raportet e auditimit janë dërguar në 6 (gjashtë) subjekteve përkatëse:

- Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dërguar PRA me shkresë nr. 1325/11, datë 31.12.2024;
- Ministrisë së Financave, dërguar PRA me shkresë nr. 1325/12, datë 31.12.2024;
- Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, dërguar PRA me shkresë nr. 1325/13, datë 31.12.2024;
- Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, dërguar PRA me shkresë nr. 1325/14, datë 31.12.2024;
- Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, dërguar PRA me shkresë nr. 1325/15, datë 31.12.2024;
- Agjencisë Kombëtare të Burimeve natyrore, dërguar PRA me shkresë nr. 1325/16, datë 31.12.2024.

Mbi këtë bazë është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të evaduara gjatë vitit 2023, për 4 auditime të zhvilluara në 6 institucione, në lidhje me respektimin e afateve për informimin e KLSH-së, rezultoi se:

- 3 subjekte (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore) kanë respektuar afatin 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15, shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.
- 3 subjekte (Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Konfiskuar dhe Sekuestruara) nuk ka respektuar afatin prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, jo në përputhje me nenin 15, shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.
- 2 subjekte (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj) kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- 4 subjekte (Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Konfiskuar dhe Sekuestruara, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore) nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Niveli i realizimit të masave sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:

- **Masa për përmirësime/ndryshime legjislacioni:** Nga 1 masë e rekomanduar është pranuar plotësisht 1 rekomandim ose 100%, i cili rezultoi i pazbatuar.
- **Masa organizative:** Nga 104 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 93 rekomandime ose 89%, 8 rekomandime janë pranuar pjesërisht ose 4% dhe 3 rekomandime nuk janë pranuar ose 7%. Nga masat e pranuar, janë zbatuar plotësisht 31 rekomandime ose 31%; janë zbatuar

pjesërisht 33 rekomandime ose 33%, janë në proces zbatimi 7 rekomandime ose 4% si dhe 31 rekomandime rezultojnë të pa zbatuara ose 32%.

- **Masa me efekt negativ financiar (3E) “Të ardhura të munguara”:** Nga 23 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 23 rekomandime ose 100% e tyre, nga të cilët 18 rekomandime janë zbatuar pjesërisht ose 91%, 1 rekomandim ose 4.5% është në proces zbatimi dhe 1 rekomandim ose 4.5% nuk është zbatuar.

- **Masa shpërblim dëmi:** Nga 2 masa të rekomanduara në vlerën 11,207 mijë lekë, janë pranuar plotësisht 2 rekomandime ose 100% e tyre, të cilët rezultojnë të zbatuar pjesërisht.

- **Masa disiplinore:** Nga 11 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 10 rekomandime ose 90% dhe 1 rekomandim nuk është pranuar ose 10%. Nga masat e pranuar, 9 rekomandime ose 90% e tyre janë zbatuar plotësisht dhe 1 rekomandime nuk është zbatuar ose 10%.

1.1. Hyrje

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara gjatë vitit 2023, të subjekteve të cilësuara më poshtë, mbështetur në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1325/7 prot., datë 04.11.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrin elektronik institucional, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 13.06.2020, nga data 11.11.2024 deri më datë 13.12.2024. Auditimi “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e kryera në vitin 2023” u realizuar nga grupi i auditimit me përbërje:

- H.S, përgjegjës i grupit të auditimit
- R.G.
- R.Xh.
- Xh.N.
- K.N.
- E.B.

Auditimi filloi më 04.11.2024 dhe përfundoi më 13.12.2024.

Subjektet e audituara:

- Kontrata e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit (Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave).
- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.
- Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj.
- Licencimi dhe monitorimi i subjekteve me veprimtari në fushën minerare (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare Burimeve Natyrore).

1.2. Objektivat e auditimit

- Hartimi i programit (Planit të Veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi.
- Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ.
- Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik.
- Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomicitet të fondeve.
- Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative.
- Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

1.3. Qëllimi i auditimit

Dhënia e konkluzionit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH, të lëna nga auditimi i

mëparshëm, në lidhje me respektimin e afateve të raportimit në KLSH mbi, Plan veprimin dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve; statusin e zbatimit të rekomandimeve; koherencën e tyre si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, duke ju referuar Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP) të cilat përcaktojnë qartë rolet e përgjegjësitë e subjekteve të audituara dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), sipas të cilave: “..., përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve në kohë dhe në mënyrë efektive është e subjekteve të audituara dhe përgjegjësi e SAI-ve ndjekja e zbatimit të rekomandimeve pra të verifikojë veprimet e ndërmarra dhe nëse janë arritur rezultatet e pritshme”.

1.4. Metodologjia

Duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit dhe dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional dhe të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, u auditua niveli i zbatimit të secilit rekomandim në subjektet e përzgjedhura, vlerësuar sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së kryerjes së auditimit në terren.

1.5. Konkluzione

Për çështjet e shqyrtuara janë zhvilluar ballafaqime gjatë fazës së auditimit në terren dhe në përfundim të tij janë mbajtur Akt Verifikime për çdo subjekt të audituar, mbi rezultatet e të cilave është përgatitur ky Raport Auditimi.

2. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Në përfundim të auditimit të ushtruar në 6 subjekte, bazuar në ISSAI/IFPP 100 “Parimet themelore të auditimit në sektorin publik” dhe Manualin për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, miratuar nga Kryetari i KLSH me Vendimin nr. 67, datë 13.06.2020, për rekomandimet e lëna nga KLSH në auditimin e kryer gjatë vitit 2023, bazuar në Programin e Auditimit nr. 1325/7 prot., datë 04.11.2024, me objekt “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2023”, KLSH ka arritur në konkluzionin se, nga ana e subjekteve të audituara përgjithësisht është treguar përgjegjshmëri menaxheriale në shqyrtimin, pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e kryera gjatë vitit 2023. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të papranuara rezulton në nivel të konsiderueshëm, konkretisht nga nga 141 masa të rekomanduara gjithsej janë pranuar 138 masa ose 98%, si dhe nuk janë pranuar 3 masa ose 2%.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar për këto subjekte, rezulton sipas kësaj strukture: zbatuar plotësisht 40 masa ose 29%, zbatuar pjesërisht 55 masa ose 40%, në proces zbatimi 8 masa ose 6%, si dhe rezultojnë 35 masa të pazbatuara ose 25%.

3. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1325/7 prot., datë 04.11.2024 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023”, Grupi i auditimit ka ushtruar auditim, sipas njoftimeve për fillim auditimi:

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 1325, datë 04.11.2024;
2. Ministria e Financave, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 1325/1, datë 04.11.2024;
3. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 1325/2, datë 04.11.2024;
4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 1325/3, datë 04.11.2024;
5. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 1325/4, datë 04.11.2024;

6. Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 1325/5, datë 04.11.2024;
7. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, sipas Njoftimit për fillim auditimi nr. 1325/6, datë 04.11.2024.

Nga verifikimi i dokumentacionit lidhur me hapat e ndërmarra për realizimin e rekomandimeve të lëna, ka rezultuar si në vijim:

3.1 KONTRATA E KONCESIONIT PËR FINANCIMIN, NGRITJEN DHE OPERIMIN E SHËRBIMIT TË SKANIMIT TË KONTEJNERËVE E AUTOMJETEVE TË TJERA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE TARIFËS SË SHËRBIMIT TË SKANIMIT.

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditimin tematik në **Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave** (*këtu e në vazhdim MF dhe DPD*), me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në vitin 2023”, për auditimin e ushtruar mbi kontratën koncesionare për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit, përcjellë me shkresën nr. 1106/12 prot., datë 05.10.2023 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe me shkresën nr. 1106/13 prot., datë 05.10.2023 në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
Vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve;
Vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Regjistrin elektronik institucional të zbatimit të rekomandimeve.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 1325/7 prot., datë 04.11.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga grupi i audituesve i përbërë nga:

- H. S, përgjegjës i grupit të auditimit
- E. B, auditues
- Xh. N, auditues

Auditimi filloi më 04.11.2024 dhe përfundoi më 13.12.2024.

II/1. OBJEKTI I AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 1106/12 prot., datë 05.10.2023 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe shkresën nr. 1106/13 prot., datë 05.10.2023 në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, se bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së.

II/2. QËLLIMI I AUDITIMIT

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 të nenit 31 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II/3. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditimi i plotë i të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH për përmirësimin e gjendjes së subjekteve në të ardhmen.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III/1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti **Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave** në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 1106/12 prot., datë 05.10.2023 në MFE dhe shkresën nr. 1106/13 prot., datë 05.10.2023 në DPD rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 32 rekomandime si masa organizative, nga ku 9 rekomandime janë pranuar pjesërisht dhe 22 rekomandime janë pranuar plotësisht, të cilat kanë statusin e ecures së zbatimit si vijon: 2 zbatuar, 9 zbatuar pjesërisht, 2 në proces zbatimi dhe 18 pazbatuar;
- Për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit është lënë 1 Masë Disiplinore e cila është pranuar pjesërisht dhe nuk është zbatuar.

Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel 94%, konkretisht nga 33 rekomandime gjithsej, janë pranuar 31 rekomandime.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën 6.45%, niveli i zbatimit të rekomandimeve në proces zbatimi rezultoi 6.45%, niveli i rekomandimeve pa zbatuara rezultoi 58%, niveli i rekomandimeve zbatuara pjesërisht rezultoi 29%.

III/2. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në **MF** dhe **DPD** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “*Mbi auditimin e kontratës së koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit*” për periudhën nga identifikimi/propozimi i projektit deri në zbatimin e tij në 31.12.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së përcjellë me shkresën nr. 1106/12 prot., datë 05.10.2023 në MFE dhe shkresën nr. 1106/13 prot., datë 05.10.2023 në DPD, rezultoi si më poshtë vijon:

A. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi ka rezultuar:

Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, konstatohet se Ministria e Financave nuk ka zbatuar hapat mbi

raportimin e zbatimit të rekomandimeve të cilat janë të cilësuar në nenin 15 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, konkretisht:

-neni 15 gërma (j), ku cilësohet: “*të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*”;

-neni 30 pika 1 dhe 2, ku cilësohet: “*Në raportet e tij, Kontrolli i Lartë i Shtetit jep rekomandime në përputhje me nenin 15 të këtij ligji. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”.

Konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA, bazuar në Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, shkronja (j) ku cilësohet se: “*KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*”, ku DPD ka kthyer përgjigje pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit nëpërmjet shkresës nr. 1106/14 prot., datë 24.10.2023 “Urdhër” mbi hartimin e Plan Veprimi, brenda afatit 20 ditor nga marrja e RPA.

Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit” pika 2, ku cilësohet se: *Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1106/15 prot., datë 08.04.2024, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e RPA.

B. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në auditimin e mëparshëm, KLSH ka rekomanduar 32 masa me karakter organizativ, realizimi i të cilave paraqitet si më poshtë.

1.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të analizojë problematikat e këtij koncesioni duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrin masa për vijimin e procedurave për vlerësimin dhe miratimin e projekteve koncesionare me dokumentacion të plotësuar, me qëllim vlerësimin dhe miratimin e koncesioneve që janë në dobi dhe interes të ekonomisë kombëtare.

Përgjigja e subjektit:

Analizimi i problematikave të procedurës së dhënies me koncesion me anën e propozimit të pa kërkuar për skanimin në dogana dhe vendosja para përgjegjësive të nëpunësve përgjegjës që kanë marrë pjesë në këto procedura nuk mund të realizohet nga MF. Komisionet respektive të vlerësimit të ofertës të pa kërkuar dhe shpalljes së fituesit, kanë pasur tagrin ligjor për vlerësimin për dhënien me koncesion të këtij shërbimi sipas ligjit respektiv, për periudhën kohore të firmosjes së kontratës. Kjo pjesë e rekomandimit nuk pranohet për shkak të diferencës së kohës së kaluar kur është kryer dhe momentit të kryerjes së auditimit. Ministria e Financës pranon që për vijimin e procedurave për vlerësimin dhe miratimin paraprak të projekteve koncesionare, Drejtoria e Koncesioneve dhe strukturat drejtuese përgjegjëse do të marrin masa sipas rregullores së miratuar me urdhrin nr. 122, datë 15.04.2022 “Për miratimin e rregullores për vlerësimin e projekteve/kontratave/PPP, si dhe çdo ndryshim apo transferim të tyre” në vijimin e procedurave për vlerësimin dhe miratimin paraprak të projekteve

koncesionare me dokumentacion të plotësuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se referuar Planit të Masave për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH “Mbi përputhshmërinë e zbatimit të kontratës koncesionare për skanimin e kontenjerëve e automjeteve të tjera”, Ministria e Financave e ka pranuar pjesërisht këtë rekomandim. Për zbatimin e tij nuk janë paraqitur evidenca bazuar në gjetjen e auditimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar pjesërisht dhe i pa zbatuar.

2.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të analizojnë problematikat e këtij koncesioni duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, dhe të marrin masa për organizimin më të mirë të procedurave koncesionare që në fazat e hershme të propozimit, duke kryer analiza të thelluara përpara vendosjes së çmimeve, dhe të mos ndërmerren hapa të cilat mund të komprometojnë operatorët ose buxhetin e shtetit.

Përgjigjja e subjektit:

Ministria e Financave nuk mund të analizojë problematikat e këtij koncesioni dhe nxjerrjen e përgjegjësiave përkatëse për periudhën e mëparshme, për arsye se ndryshimet e evidentuara në marrëveshjen e koncesionit janë kryer në zbatim të ligjit respektiv të kohës. Për ndryshimet e evidentuara në ndryshimin e Marrëveshjes së Koncesionit, me projektligjin e miratuar, për ndryshimin e ligjit në vitin 2015, është zbatuar ligji respektiv në periudhën kohore të nënshkrimit të kontratës. Drejtoria e Koncesioneve dhe strukturat drejtuese përgjegjëse në zbatim të rregullores nr. 122, datë 15.04.2022, do të marrin masa në organizimin më të mirë të procedurave koncesionare që në fazat e hershme të propozimit duke kryer analiza të thelluara.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se referuar Planit të Masave për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH “Mbi përputhshmërinë e zbatimit të kontratës koncesionare për skanimin e kontenjerëve e automjeteve të tjera”, Ministria e Financave e ka pranuar pjesërisht këtë rekomandim. Për zbatimin e tij nuk janë paraqitur evidenca bazuar në gjetjen e auditimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar pjesërisht dhe i pa zbatuar.

3.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese pranë MFE të marrin masat për analizimin e problematikave të shkaktuara si pasojë e ndryshimeve në ligj, të cilat kanë ndryshuar ndër të tjera edhe skemën e financimit të kontratës koncesionare dhe tarifën e aplikuar për skanim, duke transferuar risqet e kontratës koncesionare tek buxheti i shtetit, me efekte negative financiare për buxhetin e shtetit në vlerën e mbështetjes buxhetore të alokuar çdo vit.

Përgjigjja e subjektit:

Ministria e Financave nuk mund të kryejë një analizë për arsye se çështja është ezauruar me miratimin e ligjeve respektive për miratimin e e ndryshimit të kontratës. Analizimi i mangësive procedurale të ndryshimit të kontratës deri në miratimin me ligj nuk mund të realizohet nga MF. Ndryshimi tarifor apo transferimi i risqeve nga buxheti i shtetit te partneri privat, është negociuar me koncesionarin dhe është miratuar me ligj. Për të rënë në dakordësi lidhur me ndryshimet e kontratës duhet pëlqimi i të dyja palëve.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se referuar Planit të Masave për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH “Mbi përputhshmërinë e zbatimit të kontratës koncesionare për skanimin e kontenjerëve e automjeteve të tjera”, Ministria e Financave nuk e ka pranuar këtë rekomandim.

Ky rekomandim rezulton i papranuar.

4.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrin masat për analizimin e situatës duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse në parregullsitë e evidentuara në kontratën e nënshkruar për këtë projekt koncesionar, duke ndërmarrë masa të

menjëhershme ligjore për eliminimin e tyre, si dhe shqyrtimin e mundësive reale për hartimin e dokumentacioneve sqaruese/plotësuese sipas rastit, me efekte deri në përfundim të afatit 15 vjeçar të projektit.

Strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Drejtësisë, Avokaturës së Shtetit, ATRAKO dhe Autoritetit të Konkurrencës, apo edhe institucione të tjera të angazhuara në dhënien e mendimeve gjatë fazës së hartimit të kontratave koncesionare, përpara miratimit të projekt ligjeve përkatëse, të marrin masat për shqyrtimin e problematikave të mësipërme, me qëllim garantimin e barazisë në të drejtat dhe detyrimet mes palëve.

Përgjigjja e subjektit:

Strukturat drejtuese nuk mund të kryejnë një analizë për arsye se çështja është ezauruar me miratimin e ligjeve respektive për miratimin e ndryshimit të kontratës. Për të ndërmarrë ndryshime ligjore me ndryshimet e kontratës duhet pëlqimi i të dyja palëve.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se referuar Planit të Masave për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH “Mbi përputhshmërinë e zbatimit të kontratës koncesionare për skanimin e kontenjerëve e automjeteve të tjera”, Ministria e Financave nuk e ka pranuar këtë rekomandim.

Ky rekomandim rezultoi i papranuar.

5.1.Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim vlerësimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës për mos përmbushjen e detyrimit nga ana e shoqërisë koncesionare, si dhe marrjen e masave për aplikimin e sanksioneve ndaj shoqërisë koncesionare për mos përmbushjen e detyrimit kontraktual të koncesionarit për të garantuar lidhjen me serverin ose shtëpinë lokale më të afërt të vendit të Autoritetit, për qëllimet e transferimit të imazheve dhe analizimin e të dhënave të tyre.

Përgjigjja e subjektit:

Ministria e Financave do të kërkojë nga DPD ngritjen e një grupi pune për analizimin e situatës që ka sjellë mospërmbushjen që ka të bëjë me lidhjen me serverin për transferin e imazheve, raportimin e grupit të punës në MF, si dhe do të mbahet korespondencë me AKSHI-n për të analizuar situatën. Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, Drejtoria e Koncesioneve në MF, i ka kërkuar Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave marrjen e masave për (i) ngritjen e grupit të punës për evidentimin e problematikave që kanë krijuar situatën e mospërmbushjes së lidhjes me serverin për qëllimet e transferimit të imazheve, si dhe propozimin e zgjidhjes së problematikës; (ii) një kopje e urdhrin të dërgohet në MF; (iii) grupi i punës të raportojë brenda muajit nëntor në DPD, z. I. M Menaxherit të Projektit, si dhe Drejtorisë së Koncesioneve në MF.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e këtij rekomandimi, rezultoi se Drejtoria e Koncesioneve në MF, ka dërguar pranë DPD shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024 me lëndë “Për kompetencë”, ku kërkon nga DPD në cilësinë e institucionit ekskluziv përgjegjës për ecurinë e zbatimit të kontratës koncesionare, raportimin për një sërë rekomandimesh të cituara. Rezultoi se vetë MF nuk janë marrë masa për aplikimin e sanksioneve ndaj shoqërisë koncesionare për mos përmbushjen e detyrimit kontraktual në rolin e Autoritetit Kontraktor, edhe pse rekomandimi i lënë nga KLSH i është drejtuar Ministrisë së Financave.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i pa zbatuar.

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet Menaxherit të Projektit, në cilësinë e pikës së kontaktit, të kërkojë nga shoqëria koncesionare zëvendësimin e pajisjeve, sipas detyrimit të përcaktuar në kontratën koncesionare.

Përgjigjja e subjektit:

Me shkresën nr. 7527 prot., datë 03.04.2024, z. I. M Menaxher i Projektit, i ka dërguar Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave planin e veprimit mbi realizimin e detyrave të për analizimin dhe vlerësimin e rekomandimit.

Me shkresën nr. 9065 prot., datë 28.06.2023, Drejtoria e Koncesioneve në MF, i ka kthyer përgjigje Shoqërisë Koncesionare “S A” SHPK, për dijeni DPD dhe Menaxherit të Projektit, për gjetjen e zgjidhjes teknike dhe operacionale të detyrimit kontraktual për kryerjen e investimit të zëvendësimit me pajisje të reja të skanimit, pa ndërprerjen e ofrimit të këtij shërbimi, lidhur me përmbushjen e detyrimeve të sigurisë kombëtare.

Me shkresën nr. 13599 protokoll në DPD, datë 18.08.2023, shoqëria “S A” SHPK, ka kërkuar bashkëpunimin e Menaxherit të Projektit, për bashkërendimin e procesit të zëvendësimit të skanerave në pikat doganore, duke i bashkëngjitur shkresës, Programin e procesit të punës.

Me shkresën nr. 9065/4 prot., datë 02.09.2024, Drejtoria e Koncesioneve i ka kërkuar Menaxherit të Projektit, hartimin e një Plan Veprimi, në bashkëpunim me DPD dhe shoqërinë “S A” SHPK, në përmbushje të detyrimit kontraktor, realizimin e procesit të zëvendësimit të pajisjeve dhe komponentëve ekzistues, me të reja.

Me shkresën nr. 9065/5 prot., datë 04.10.2024, Drejtoria e Koncesioneve i ka përcjellë informacion Ministrit të MF, mbi takimin e zhvilluar për zëvendësimin e skanerave në pikat kufitare, ku shoqëria “S A” SHPK ka informuar se mund të realizojë procesin e zëvendësimit brenda një afati kohor prej 3 javësh, pa ndërprerë shërbimin në atë pikë operimi, pasi do të vendosë një skaner të lëvizshëm. Menaxheri i Projektit ka bërë me dije se, referuar statistikave, koha më e përshtatshme për të filluar punë në Portin e Durrësit (pika doganore me fluksin më të madh të skanimeve) do të jetë 1-15 janar 2025, për të vijuar me pika të tjera doganore me një periudhë kohore 1 mujore nga njëra – tjetra.

Me shkresën nr. 15596 prot., datë 12.11.2024, Drejtoria e Koncesioneve i ka kërkuar DPD t'i vihet në dispozicion deri më datë 15.11.2024, Plan veprimi për zëvendësimin e skanerave, të rënë dakord në takimet e mëparshme.

Me shkresën nr. 24169/1 prot., datë 15.11.2024, Departamenti Operativ Hetimor në DPD ka dërguar në MFE, Plan veprimin për zëvendësimin e pjesëve, i cili do të fillojë më datë 6 janar 2025, sipas një renditjeje të degëve doganore, si dhe do të marrë masa të shtuara në mbikëqyrjen doganore dhe kontrollet në periudhat e përcaktuara, me pjesëmarrjen e strukturave kryesore të këtij departamenti.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se janë marrë masat dhe është vendosur data 6 janar 2025, për fillimin e zëvendësimit të pajisjeve sipas kontratës me koncesionarin.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces zbatimi.

7.1.Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga MFE dhe DPD, me qëllim (i) kryerjen e një vlerësimi të plotë të investimit, duke evidentuar devijimet e mundshme nga propozimi fillestar, (ii) evidentimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në përmbushjen e detyrimeve nga ana e shoqërisë koncesionare, si dhe (iii) përllogaritjen e impaktit financiar të këtyre mos përmbushjeve nga ana e shoqërisë koncesionare, në raport me propozimin.

Përgjigjja e subjektit:

Grupi i punës me përbërje nga MF dhe DPD do të marrë në konsideratë të gjitha vlerësimet e kryera dhe do të sjellë informacion lidhur me vlerësimin e investimit të kryer. Drejtoria e Koncesioneve do të hartojë urdhrin për ngritjen e grupit të punës me përfaqësues nga Drejtoria e Koncesioneve, Drejtoria e Aseteve dhe DPD me qëllim evidentimin e vlerës së realizuar të kontratës deri në vitin 2023, si dhe më pas do të hartojë një raport ku të analizojë ecurinë e këtij

koncensioni. Ky rekomandim pranohet pjesërisht.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua referuar Planit të Masave për Zbatimin e Rekomandimeve të KLSH “Mbi përputhshmërinë e zbatimit të kontratës koncesionare për skanimin e kontejnerëve e automjeteve të tjera”, ky rekomandim është pranuar pjesërisht, por për zbatimin e tij nuk janë paraqitur evidenca bazuar në gjetjen e auditimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar pjesërisht dhe i pazbatuar.

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Koncesioneve në MFE në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrin masat për (i) identifikimin e përgjegjësive për mos raportimin e parregullsive që kanë ekzistuar në mos përmbushjen e këtij detyrimi kontraktual të koncesionarit, për (ii) aplikimin e sanksioneve ndaj shoqërisë koncesionare për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, si dhe për (iii) hartimin dhe miratimin e planeve periodike mujore dhe vjetore për trajnimin e punonjësve të doganës (të tillë si doganier skanimi, punonjësit e Sektorit të Monitorimit dhe/ose punonjës të tjerë që gjykohen me rëndësi nga DPD) lidhur me analizimin e imazheve.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, Drejtoria e Koncesioneve në MF, i ka kërkuar Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të hartojë dhe miratojë planin periodik mujor dhe vjetor për trajnimin e punonjësve të doganës lidhur me analizimin e imazheve, si dhe raportimin periodik të kryerjes së trajnimeve në MF.

Drejtoria e Koncesioneve do të realizojë një verifikim që lidhet me mos përmbushjen nga ana e Koncesionarit.

Me shkresën nr. 2485/4 prot., datë 23.10.2023 të Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Për analizimin, vlerësimin dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”, është miratuar Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

(iii) Me shkresën nr. 17415/1 prot., datë 25.10.2023, Dega e Doganës Durrës i ka kërkuar Departamentit Administrativ në DPD mundësimin e trajnimeve të vazhdueshme për personelin doganor të Degës së Doganës Durrës, që në proces pune kanë edhe procedurat e skanimit të mjeteve me qëllim analizimin e imazheve të skanimit.

(iii) Me shkresën nr. 6768/3 prot., datë 21.03.2024, Menaxheri i Projektit, ka kërkuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në DPD, në planifikimin e trajnimeve për vitin 2024, të parashikohet trajnimi i doganierëve të skanimit në degë doganore, si dhe i specialistëve të monitorimit në Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit (DARM), nga kompania koncesionare.

(iii) Me shkresën nr. 7012 prot., datë 27.03.2024, Drejtoria DARM në DPD, raporton se i është drejtuar me email Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Menaxherit të Projektit për planifikimin e trajnimeve për vitin 2024, për specialistët e Sektorit të Monitorimit lidhur me analizimin e imazheve të skanimit.

(iii) Me shkresën nr. 378 prot., datë 26.03.2024, Dega e Doganës Qafë-Thanë ka informuar se nuk disponon dokumenta, plane periodike lidhur me trajnimet që duhet të kryejë shoqëria koncesionare.

Me shkresën nr. 801 prot., datë 26.03.2024, Dega e Doganës Kapshticë ka dhënë informacion se ka përcaktuar personat përgjegjës dhe ka marrë masat mbi (i) identifikimin e përgjegjësive për mos raportimin e parregullsive që kanë ekzistuar në mos përmbushjen e këtij detyrimi kontraktual të koncesionarit (ii) ka bërë propozime që në programin e trajnimeve nga DPD, të përfshihen edhe tema për procesin e skanimit të mjeteve, analizimin e imazheve që kanë lidhje me skanimin.

Komenti i grupit të auditimit: Nga verifikimi u konstatua se nuk janë paraqitur evidenca për (i) identifikimin e përgjegjësive për mos raportimin e parregullsive që kanë ekzistuar në mos

përmbushjen e këtij detyrimi kontraktual të koncesionarit, për (ii) aplikimin e sanksioneve ndaj shoqërisë koncesionare për mos përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

Ndërsa për (iii) hartimin dhe miratimin e planeve periodike mujore dhe vjetore për trajnimin e punonjësve të doganës janë kryer propozimet përkatëse nga Menaxheri i Projektit, drejtori e disa degë doganore referuar shkresave të sipërcituara.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

9.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë MFE të marrin masat për të dokumentuar analizat e kryera në kuadër të planifikimit të fondeve të nevojshme për këtë kontratë sipas faktorëve që ndikojnë në të, me qëllim paraqitjen e saktë të mbështetjes buxhetore të kësaj kontrate, që rezulton nga diferenca mes të ardhurave të gjeneruara nga tarifat e skanimit për çdo deklaratë doganore, dhe pagesave të dakortësuara në kontratë si detyrime ndaj koncesionarit për çdo vend skanimit, si dhe të garantohet përfshirja e të gjithë elementëve ekonomikë dhe financiarë të kontratës koncesionare gjatë planifikimit të tyre, për të shmangur miratimin e projekteve duke ndryshuar skemën e financimit të tyre, shoqëruar me kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

Përgjigja e subjektit:

Me shkresën nr. 10624 prot., datë 01.08.2024, Drejtoria e Konkencioneve i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, informacion mbi pagesat e tarifave të bëra nga operatorët ekonomikë për shërbimin e skanimit për vitin 2023.

Me shkresën nr. 10624/1 prot., datë 01.08.2024, Drejtoria e Konkencioneve i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit alokimet e bëra në Buxhetin e Shtetit për kontratën koncesionare të skanimit të automjeteve për periudhën kohore 2023.

Me shkresën nr. 10624/2 prot., datë 08.08.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit i ka kthyer përgjigje Drejtorisë së Konkencioneve, mbi alokimet e bëra në Buxhetin e shtetit për kontratën koncesionare “Për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë”, për periudhën kohore 2023. Sipas raportimeve zyrtare të Autoritetit Kontraktues si dhe databazës së pagesave në SIFQ, fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2023, sipas planit vjetor me ndryshime, janë 1,541,732 mijë lekë. Ndërkohë, totali i pagesave faktike buxhetore për vitin 2023, është 1,540,310 mijë lekë, i detajuar me pagesa mujore edhe në tabelë.

Me shkresën nr. 10624/3 port., datë 22.08.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka dhënë informacion mbi arkëtimet në vlerën 1,211,366,952 lekë, në favor të DPD, në llogarinë ekonomike 7110135 “Tarifa shërbimesh për skanimet gjatë procesit doganor”, gjatë vitit ushtrimor 2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se janë marrë masat në dhënin e informacionit mbi pagesat e tarifave të bëra nga operatorët ekonomik për shërbimin e skanimit, fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2023, si dhe arkëtimet në favor të DPD, por nuk janë vënë në dispozicion dokumente të analizave të kryera në kuadër të planifikimit të fondeve të nevojshme për këtë kontratë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

9.2.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë MFE dhe DPD të marrin masat për të garantuar kryerjen e kontroleve periodike dhe vjetore lidhur me realizimin e të ardhurave nga skanimit nëpërmjet kryqëzimit të informacioneve mbi deklaratat e përpunuara sipas tarifave përkatëse, si dhe zhvillimin e anketave apo verifikimeve të tjera për trafikun/përdoruesit e shërbimeve.

Përgjigja e subjektit: Strukturat përgjegjëse në Drejtorinë e Konkencioneve, Drejtoria e Thesarit, Drejtoria e Buxhetit dhe DPD do të ndjekin konstatimin e të ardhurave nga skanimit nëpërmjet kryqëzimit të informacioneve mbi dekaratat e përpunuara sipas tarifave përkatëse.

Ministria e Financave do të përfshijë treguesit e rekomandimit që prej vitit 2015.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se ky rekomandim është pranuar, por për zbatimin e tij nuk janë paraqitur evidenca bazuar në gjetjen e auditimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

10.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë MFE të marrin masat për të përlogaritur detyrimet kontraktuale dhe asetet e kësaj kontrate duke mundësuar raportimin e drejtë në pasqyrat financiare, me qëllim paraqitjen e informacionit sa më të plotë nga përdoruesit e PF.

Përgjigjja e subjektit:

Me urdhër të Titullarit të Ministrisë së Financave, do të ngrihet një grup pune për pjesën e asetëve, me përfaqësues nga Drejtoria e Konkencioneve, Drejtoria e Thesarit, Drejtoria e Buxhetit, DPD dhe Menaxheri i Projektit.

Për pjesën e Pasqyrave Financiare, Drejtoria e Konkencioneve do të përfshijë në planet e monitorimit të DPD dhe Menaxherit të Projektit, për raportimin eficient dhe në kohë të Pasqyrave Financiare, si dhe do t'i rakordojë këto me Drejtorinë e Thesarit, Drejtorinë e Buxhetit dhe të Tatimeve.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se ky rekomandim është pranuar, por për zbatimin e tij nuk janë paraqitur evidenca bazuar në gjetjen e auditimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

11.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë MFE dhe DPD të marrin masat për vlerësimin e situatës së trajtuar më sipër, dhe marrjen e masave përkatëse ndaj shoqërisë koncesionare për mos zbatimin e këtij detyrimi kontraktual, sipas specifikave të parashikuara në dokumentacionin pjesë e këtij projekti, si dhe ndaj strukturave përgjegjëse për identifikimin dhe raportimin e mos realizimit të detyrimeve kontraktuale të shoqërisë.

Përgjigjja e subjektit:

Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, Drejtoria e Konkencioneve në MF, i ka kërkuar Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Menaxherit të Projektit, marrjen e masave për (i) analizimin dhe verifikimin e planit të mirëmbajtjes si dhe përditësimin e pajisjeve software; (ii) gjetjet e analizës të kryer të raportohen periodikisht te Drejtoria e Konkencioneve në MF.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se ky rekomandim është pranuar, por për zbatimin e tij nuk janë paraqitur evidenca bazuar në gjetjen e auditimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

12.1.Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës që kanë sjellë (i) operimin e ekspozuar ndaj risqeve të skanerit në Portin e Durrësit dhe (ii) moszbatimin nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të përcaktimeve të Marrëveshjes nr. 14980 Prot., datë 06.09.2013 “Për dhënie në përdorim të vendit ku do të instalohet skaneri në Degën Doganore Durrës”, si dhe (iii) të ndër marrë hapat e nevojshëm për përshpejtimin e këtij procesi, me qëllim garantimin e efektivitetit të shërbimit të skanerit në Portin e Durrësit.

Përgjigjja e subjektit:

Nga Ministria e Financave ky rekomandim është pranuar pjesërisht. Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, Drejtoria e Konkencioneve në MF, i ka kërkuar Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave marrjen e masave për (i) ngritjen e grupit të punës për gjetjen e një zgjidhje për operimin maksimal të skanerit në Portin e Durrësit, me qëllim garantimin e

efektivitetit të këtij shërbimi; (ii) një kopje e urdhrin të dërgohet në MF; (iii) grupi i punës të raportojë brenda muajit nëntor në DPD, Menaxherit të Projektit, si dhe Drejtorisë së Konkencioneve në MF.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se ky rekomandim është pranuar pjesërisht, por për zbatimin e tij nuk janë paraqitur evidenca bazuar në gjetjen e auditimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar pjesërisht dhe i pa zbatuar.

13.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë MFE dhe DPD të marrin masat për identifikimin dhe marrjen e masave ndaj njërive përgjegjëse të cilat nuk kanë analizuar mundësitë reale për realizimin e shërbimit të skanimit në masën 100% të deklaratave doganore në momentin e paraqitjes së ofertës së pa kërkuar dhe të relacionit të projekt ligjit.

Gjithashtu, këto struktura të marrin masat për të implementuar procedura që maksimizojnë skanimin e mjeteve me risk në pikat doganore të pajisura me skanera.

Përgjigjja e subjektit:

Rekomandimi është pranuar pjesërisht, pasi lidhur me angazhimin e strukturave drejtuese në MF, rolin zbatues e ka DPD.

Me shkresën nr. 7012 prot., datë 27.03.2024, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit (DARM), ka relatuar te Titullari i DPD, se i është drejtuar degëve doganore të pajisuara me skaner, ku i është kërkuar të marrin masa për të implementuar procedura që maksimizojnë skanimin e mjeteve me risk në pikat doganore të pajisura me skanera, duke u bazuar në eksperiencën dhe përvojën e kontrolleve faktike që kryhen në secilën degë doganore, si dhe janë kërkuar sugjerimet e tyre. Informacioni vazhdon në proces grumbullimi, për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave me qëllim zbatimin e rekomandimit.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se ky rekomandim është pranuar pjesërisht. Nga auditimi mbi verifikimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion, vlerësohet se janë ndërmarrë veprime për të implementuar procedura që maksimizojnë skanimin e mjeteve me risk në pikat doganore të pajisura me skanera.

Ky rekomandim rezulton i pranuar pjesërisht dhe i zbatuar pjesërisht.

14.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DPD të marrin masat për ngritjen e një grupi pune, i cili pas hartimit të një baze të dhënash mbi mbulimin me skanim në nivel deklaratash dhe mjeteve doganore sipas përzgjedhjes së automatizuar apo manual, të shqyrtojë këtë informacion për të analizuar nivelin e mbulimit duke e vlerësuar në krahasim me angazhimet e pretenduara për t'u realizuar nga ky shërbim gjatë propozimit të projektit koncesionar, si dhe impaktin që ky mbulim sjell për të garantuar realizimin e objektivave të parashikuara nga dhënia me koncesion e këtij shërbimi.

Përgjigjja e subjektit:

Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, Drejtoria e Konkencioneve në MF, i ka kërkuar Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave marrjen e masave për (i) ngritjen e grupit të punës për të analizuar nivelin e mbulimit duke vlerësuar në krahasim me anagazhimet e shoqërisë koncesionare gjatë propozimit të projektit koncesionar, si dhe impaktin që ky mbulim sjell; (ii) grupi i punës të raportojë brenda muajit nëntor në DPD, Menaxherit të Projektit, si dhe Drejtorisë së Konkencioneve në MF.

Me shkresën nr. 7012 prot., datë 27.03.2024, Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit relaton tek titullari i DPD, se është ngritur grupi i punës, si dhe janë përgatitur bazat e të dhënave. Grupi është duke shqyrtuar të dhënat e disponueshme deri në përfundim të një vendim për zbatimin e këtij rekomandimi. Me shkresën nr. 11604/153 prot., datë 28.03.2024, është ngritur grupi i punës i përbërë nga anëtarë të Drejtorisë Antitrafik, anëtarë të degëve doganore

të pajisura me skaner Durrës, Qafë Thanë, Kapshticë, Morinë dhe Kakavijë. Grupi i punës ka analizuar bazën e të dhënave në nivel deklarate nga ka rezultuar se: Në doganën e Durrësit përqindja e skanimit është 13.9%, në doganën e Kakavijës skanimi është 43.97%, në doganën e Kapshticës është 69.38% në doganën e Morinës është 68,48% dhe në doganën e Qafë Thanës është 82.39%.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se me shkresën nr. 11604/153 prot., datë 28.03.2024, është ngritur grupi i punës i përbërë nga anëtarë të Drejtorisë Antitrafik, anëtarë të degëve doganore të pajisura me skaner Durrës, Qafë Thanë, Kapshticë, Morinë dhe Kakavijë. Grupi i punës ka analizuar bazën e të dhënave në nivel deklarate dhe në përfundim ka dalë edhe me konkluzione. Për sa më sipër, ky rekomandim vlerësohet i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar.

15.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë MFE të marrin masat për ngritjen e një grupi pune me përfaqësues nga DPD dhe MFE, me qëllim hartimin e kontrolleve që duhet të implementohen në pikat doganore të pajisura me skaner për verifikimin e saktësisë së skanimit, dhe identifikimin e mundshëm të gabimeve në skanim, duke parashikuar një marzh për kryerjen e kontrolleve fizike të mjeteve të identifikuar nga skaneri si të rregullta (pa ngjyrë), të cilat deri tani janë jashtë fushës së kontrollit të autoriteteve doganore dhe si rezultat, ky nivel monitorimi nuk ka mundur verifikimin e saktësisë së skanimit.

Përgjigja e subjektit:

Ministria e Financave nuk mund të krijojë një grup pune, pasi janë procedura dhe kontrolle teknike që i përkasin zbatimit të kontratës dhe janë përgjegjësi e DPD. Ky rekomandim pranohet pjesërisht.

Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, Drejtoria e Koncesioneve në MF, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave marrjen e masave për (i) hartimin dhe miratimin e planeve periodike mujore dhe vjetore të kontrolleve në pikat doganore të pajisura me skaner për verifikimin e saktësisë së skanimit si dhe identifikimin e mundshëm të gabimeve në skanim; (ii) të parashikojë një marzh për kryerjen e kontrolleve fizike të mjeteve të identifikuar nga skaneri si të rregullta (pa ngjyrë), të cilat deri tani janë jashtë fushës së kontrollit të autoriteteve doganore; (iii) të raportohet periodikisht te Drejtoria e Koncesioneve në MF.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se ky rekomandim është pranuar pjesërisht, por për zbatimin e tij nga ana e Ministrisë së Financave nuk janë paraqitur evidenca bazuar në gjetjen e auditimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar pjesërisht dhe i pa zbatuar.

16.1.Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga MFE dhe DPD, me qëllim hartimin e Regjistrit të Riskut për aktivitete që lidhen me shërbimin e skanimit në pikat doganore, me qëllim identifikimin, vlerësimin dhe minimizimin e risqeve përkatëse.

Përgjigja e subjektit:

Referuar Planit të Masave të përgatitur nga MF, ky rekomandim është pranuar pjesërisht me pretendimin se MF nuk mund të jetë pjesë e një grupi pune për këtë çështje, si dhe rekomandimi do t'i përcillet DPD si autoritet ekskluziv përfaqësues dhe zbatues i kontratës. Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, Drejtoria e Koncesioneve pranë MF ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave marrjen e masave për hartimin e Regjistrit të Riskut për aktivitete që lidhen me shërbimin e skanimit në pikat doganore, me qëllim identifikimin, vlerësimin dhe minimizimin e risqeve përkatëse si dhe raportimin e tij pranë Drejtorisë së Koncesioneve pranë MF.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se rekomandimi është pranuar pjesërisht nga MF dhe nuk janë marrë masa konkrete për hartimin e këtij Regjistri, ku Drejtoria e Koncesioneve i kërkuar raportim DPD për këtë rekomandim përmes shkresës nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, pavarësisht se rekomandimi i është drejtuar MF.

Ky rekomandim rezulton i pranuar pjesërisht dhe i pa zbatuar.

17.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të marrë masa për hartimin dhe miratimin e hartës së procesit të punës, gjurmën e auditimit dhe planin e kontrollit të brendshëm sa i përket procesit të kryerjes së skanimit; kontrolleve pas skanimit; njësitë përgjegjëse për procesin sipas hallkave përkatëse, etj, në një formë të tillë që t'i shërbejë monitorimit të kontratës së koncesionit dhe garantimin e informacionit të plotë lidhur me gjetjet që kanë të bëjnë me këtë proces pune.

Përgjigja e subjektit:

Referuar shkresës nr. 2485/4 prot., datë 23.10.2023 të Planit të Veprimit të përgatitur nga DPD, ky rekomandim është pranuar dhe janë ngarkuar Departamenti Operativ Hetimor, Departamenti Administrativ dhe Degët doganore për realizimin dhe përmbushjen e këtij rekomandimi.

Me shkresën nr. 7012 prot., datë 27.03.2024, Departamenti Operativo-Hetimor ka paraqitur pranë DPD Relacionin mbi Zbatimin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, ku për këtë rekomandim përcaktohet se Drejtoria e Antikontrabandës kryen kontrolle fizike në terren, ndaj ky rekomandim i është përcjellë kësaj drejtorie për udhëheqje dhe DARM si mbështetëse për zbatim.

Dega Doganore Qafë-Thanë ka përcjellë pranë DPD shkresën nr. 378 prot., datë 26.03.2024, ku sqaron se ka hartuar hartën e procesit të punës, ku janë përcaktuar disa detyra të doganierit të skanerit.

Dega Doganore Kapshticë përmes shkresës nr. 801 prot., datë 26.03.2024 ka përcjellë pranë DPD informacionin se ka dhënë propozimet përkatëse për Rregulloren e re e cila pritet të miratohet dhe pas miratimit të këtij akti do të vijojë me hartimin e hapave të procesit të punës, të cilat do të bazohen në ligjin nr. 123/2013, i ndryshuar dhe në Urdhrin nr. 18378, datë 08.08.2017 “Mbi miratimin e manualit që përcakton Procedurat Standarde të Punës (PSP)”, si dhe akte të tjera të nxjerra nga dega për mënyrën e qarkullimit, regjistrimit, administrimit të urdhrit të skanimit, etj.

Dega Doganore Durrës, në vijim të këtij rekomandimi, ka dërguar pranë DPD shkresën nr. 17415/2 prot., datë 25.10.2023, ku kërkon nga kjo e fundit bashkëpunim për realizimin e këtij rekomandimi.

Dega Doganore Morinë, me shkresën nr. 3482/3 prot., datë 26.03.2024, ka dërguar pranë DPD informacion ku përcakton se në bashkëpunim me njësitë përgjegjëse pranë DPD do të kenë një standard të unifikuar për të gjithë degët doganore në raportim.

Dega Doganore Vlorë, me shkresën nr. 879/1 prot., datë 27.03.2024, bën me dije DPD se në vijim të shkresës nr. 2485/4 prot., datë 23.10.2023, kjo degë doganore nuk ka të instaluar një skaner të tillë.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se rekomandimi është pranuar nga DPD dhe është shpërndarë pranë DOH, DA dhe Degëve Doganore, ku nga Drejtoria e Antikontrabandës është hartuar dhe miratuar harta e procesit të punës. Megjithatë, nuk evidentohen të jenë marrë veprime lidhur me miratimin e gjurmës së auditimit apo planit të kontrollit të brendshëm, përpos Urdhrit të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të DPD me nr. 11604/57 prot., datë 11.10.2023, i cili urdhëron ndjekjen e zbatimit në praktikë të planeve operationale dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së kryer. Gjithashtu, evidentohen korrespondenca mes palëve në kuadër të shkëmbimit të

informacionit/kërkimit të bashkëpunimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

18.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të marrë masa për hartimin e një akti ose përfshirjen në një akt ekzistues të procedurës ku të përfshihet mënyra dhe njësia përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit që do të gjenerohet përgjatë zbatimit të kontratës, monitorimit të kryer, korrespondencave vijuese mbi procesin e skanimit dhe dokumentacione të tjera të lidhura me çështjen.

Përgjigjja e subjektit:

Referuar shkresës nr. 2485/4 prot., datë 23.10.2023 të Planit të Veprimit të përgatitur nga DPD, ky rekomandim është pranuar dhe është ngarkuar Menaxheri i Projektit për realizimin dhe përmbushjen e këtij rekomandimi. Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, MF ka dërguar pranë DPD për kompetencë përmbushjen e këtij rekomandimi nga DPD dhe raportimin pranë MF për ecurinë. Menaxheri i Projektit ka dërguar drejt Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave shkresën nr. 7527 prot., datë 03.04.2024, ku përcaktohet faza e realizimit të detyrave të caktuara në Planin e Veprimit. Referuar këtij informacioni dhe dokumentacioni, rezulton se me shkresën nr. 6768 prot., datë 21.03.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i është drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Drejtorisë AntiTrafik, Menaxherit të Projektit, Degëve Doganore në Durrës, Kakavijë, Morinë, Kapshticë e Qafë-Thanë, ku përcaktohet se këto struktura duhet të marrin masa në administrimin e dokumentacionit që ka lidhje me procesin e skanimit, duke filluar nga urdhri i skanimit, kërkesat nga institucionet jashtë DPD-së, për nevojën e kryerjes së skanimit, procesverbalet e mbajtura, praktikat që i kanë shoqëruar ato, evidencat ditore/mujore/vjetore, informacionet mbi procedurat e skanimit, korrespondenca me shoqërinë koncesionare dhe MF, informacion të sjellë nga degët doganore, si dhe çdo dokument tjetër që ka lidhje me procesin e skanimit, të arkivohet detyrimisht pranë arkivës përkatëse, duke e evidentuar qartësisht nga dokumentacioni tjetër që arkivohet pranë tyre.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se pavarësisht këtyre korrespondencave, është kryer vetëm njoftimi i strukturave përkatëse për detyrimin që ato kanë lidhur me rekomandimin, por nuk ka informacion/dokumentacion të mëtjeshëm që të evidentojë përmbushjen e rekomandimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

19.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për kryerjen e një analize fluksi dhe risku mbi pikat doganore, duke mbajtur në konsideratë edhe vlerësimet e autoriteteve të tjera publike, dhe ta paraqesë raportin pranë MFE.

Përgjigjja e subjektit:

Referuar shkresës nr. 2485/4 prot., datë 23.10.2023 të Planit të Veprimit të përgatitur nga DPD, ky rekomandim është pranuar dhe është ngarkuar Departamenti Operativo-Hetimor për realizimin dhe përmbushjen e këtij rekomandimi. Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, MF ka dërguar pranë DPD për kompetencë përmbushjen e këtij rekomandimi nga DPD dhe raportimin pranë MF për ecurinë. Me shkresën nr. 7012 prot., datë 27.03.2024, DOH ka paraqitur pranë DPD Relacionin për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, ku përcakton se është ngritur grupi i punës janë përgatitur bazat e të dhënave dhe është duke u përgatitur raporti përfundimtar për MF. Me shkresën nr. 11604/153 prot., datë 28.03.2024, zv. Drejtori i Përgjithshëm i DPD ka paraqitur informacionin lidhur me rekomandimin 19.1, ku përcaktohet se Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit në bashkëpunim me strukturat e tjera në DPD ka ngritur grupin e punës përbërë nga 8 përfaqësues: znj. M. B – DARM, znj. A. E– Drejtoria e Antikontrabandës, z. Sh. K – Drejtoria e Informacionit, z. A. K – DD Morinë, z. D. M – DD Kapshticë, z. I. C – DD Durrës, z. V. P – DD Qafë-Thanë, z. I. A – DD Kakavijë. Ky grup ka kërkuar informacion nga DPPSH me shkresën nr. 1187 prot., datë 19.01.2024 dhe nga

AKU me shkresën nr. 1188 prot., datë 19.01.2024 lidhur me mallrat me risk të lartë për fshehje/kontrabandim të mallrave të ndaluar, si narkotikë, armë, etj, në rastet e kapjeve si dhe çdo informacion tjetër apo problematikë të hasur në funksion të kësaj analize. Strukturat kanë sjellë informacionet e kërkuara, përveç DD Durrës dhe DD Kakavijë. Pas marrjes së të dhënave, analiza është kryer me të dhënat e vitit 2023 dhe u përgatit materiali për Ministrinë e Financave.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se në vijim të përmbushjes së plotë të rekomandimit, pas marrjes së masave për ngritjen e grupit të punës dhe kryerjen e analizës, rezultoi se nuk ka informacion apo dokumentacion të vënë në dispozicion të grupit të auditimit për analizën finale. Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi, për sa kohë ende nuk ka një material final të konkluduar për këtë analizë.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe në proces zbatimi.

19.2.Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga MFE dhe DPD, për të analizuar rezultatet e raportit dhe për të kërkuar negociimin me shoqërinë koncesionare, për shtimin e pikave doganore ku ofrohet shërbim, pa ndryshuar kushtet e tjera, duke përfshirë pikat doganore në të cilat paraqitet fluksi/risku më i lartë.

Përgjigja e subjektit:

Referuar Planit të Masave të përgatitur nga MF, ky rekomandim është pranuar dhe përcaktohet se MF në bashkëpunim me DPD do të analizojë të dhënat e raportit dhe do të konsiderojë rekomandimin për negociimin e kontratës në përputhje me procedurat e legjislacionit për koncesionet. Për përmbushjen e këtij rekomandimi është ngarkuar grupi i punës me përfaqësues nga MF dhe DPD.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se sa i takon përmbushjes së këtij rekomandimi, nuk janë paraqitur informacione apo dokumentacione për realizimin e tij me qëllim analizimin e rezultateve të raportit dhe inicimin e negociimit për shtimin e pikave doganore ku ofrohet shërbim, pa ndryshuar kushtet e tjera të kontratës.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i pazbatuar.

20.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të kërkojë nga Kryetarët e Degëve Doganore përkatëse krijimin e Regjistrit e Skanimit, ku të specifikohen elementët që më pas do të përbëjnë raportimet dhe analizat mujore, si: numri i skanimeve të kryer për çdo vendndodhje skaneri; origjina e kërkesës referuese (profil risku Asycuda apo përzgjedhje); numri i anomalive të evidentuara; rezultati i analizës së imazhit dhe rezultati i kontrollit fizik etj.; ku të vlerësohet efektshmëria e vazhdueshme e procesit të analizimit të imazheve, dhe garantimi më pas i shqyrtimit të këtij informacioni nga ana e menaxherit të projektit, apo edhe strukturave të tjera drejtuese pranë DPD, për efekt të vlerësimit të procedurave të implementuara për monitorimin dhe vlerësimin e procesit të skanimit.

Përgjigja e subjektit:

Referuar shkresës nr. 2485/4 prot., datë 23.10.2023 të Planit të Veprimit të përgatitur nga DPD, ky rekomandim është pranuar dhe është ngarkuar Menaxheri i Projekt për realizimin dhe përmbushjen e këtij rekomandimi. Me shkresën nr. 6768/1 prot., datë 21.03.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i është drejtuar Degëve Doganore në Durrës, Kakavijë, Morinë, Kapshticë e Qafë-Thanë për marrjen e masave mbi krijimin e regjistrit të skanimit në degët doganore ku nuk është krijuar dhe plotësimin e tij në të gjitha rubrikat e parashikuara., ku të specifikohen elementët që më pas do të përbëjnë raportimet dhe analizat mujore. Në bazë të tij, edhe plotësimi i “formular tip”, i cili duhet të dërgohet pranë Koordinatorit të Skanimit në Drejtorinë e AntiTrafikut.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe zbatuar pjesërisht, pasi nuk ka përgjigje nga të gjithë Degët Doganore apo për më tepër të jetë evidentuar krijimi i Regjistrimit të Riskut, dhe garantimi më pas i shqyrtimit të këtij informacioni nga ana e menaxherit të projektit, apo edhe strukturave të tjera drejtuese pranë DPD, për efekt të vlerësimit të procedurave të implementuara për monitorimin dhe vlerësimin e procesit të skanimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

20.2.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Doganave në bashkëpunim me menaxherin e projektit të hartojnë formate tip të cilat të përcillen pranë degëve doganore të pajisura me skaner duke kërkuar nga ana e personelit respektiv përcjelljen e informacioneve periodike lidhur me funksionimin e skanerit, apo dokumentimin e përgjigjeve edhe për rastet kur nuk ka patur problematika.

Përgjigja e subjektit:

Referuar shkresës nr. 2485/4 prot., datë 23.10.2023 të Planit të Veprimit të përgatitur nga DPD, ky rekomandim është pranuar dhe është ngarkuar Menaxheri i Projekt për realizimin dhe përmbushjen e këtij rekomandimi. Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, MF ka dërguar pranë DPD për kompetencë përmbushjen e këtij rekomandimi nga DPD dhe raportimin pranë MF për ecurinë. Me shkresën nr. 6768/2 prot., datë 21.03.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i është drejtuar Degëve Doganore në Durrës, Kakavijë, Morinë, Kapshticë e Qafë-Thanë për marrjen e masave në plotësimin e “formatit tip”, bashkëngjitur shkresës, mbi rezultatet mujore të shërbimit të skanimit dhe dërgimin e saj pranë Koordinatorit të Skanimit në Drejtorinë e AntiTrafikut, brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe zbatuar pjesërisht, pasi nuk ka përgjigje nga të gjithë Degët Doganore.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

21.1.Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me përbërje nga MFE dhe DPD me qëllim hartimin e objektivave SMART së bashku me indikatorët përkatës ku të reflektohen edhe qëllimet fillestare të inicimit këtij Partneriteti Publik-Privat.

Përgjigja e subjektit:

Referuar Planit të Masave të përgatitur nga MF, ky rekomandim është pranuar dhe përcaktohet se MF do të hartojë procedurat për monitorimin e performancës së kësaj kontrate që do të përfshijë indikatorët sipas rekomandimit 8, 10, 11, 15, 16, 21.1, 23.1, 25.1 dhe 25.2. Drejtoria e Koncesioneve do të ndjekë raportimin periodik nga DPD dhe Menaxheri i Projektit mbi ecurinë e performancës së kontratës sipas treguesve të sipërpërmendur. Për përmbushjen e këtij rekomandimi është ngarkuar Menaxheri i Projektit, DPD dhe Drejtoria e Koncesioneve.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se nuk evidentohet dokumentacion lidhur me ngritjen e këtij grupi pune dhe për rezultatet mbi hartimin e objektivave/indikatorëve përkatës.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pazbatuar.

21.2. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të marrë masa për (i) ngritjen e një grupi pune (të përhershëm për afatin e kontratës) për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate me specialistë të fushës, ku të përfshihen së paku një ekonomist, një jurist dhe një inxhinier i fushës, me ndarje të qartë të detyrave, për monitorimin periodik të përmbushjes së objektivave dhe indikatorëve që do të vendosen bazuar në rekomandimin më sipër, dhe (ii) hartimin e

procedurave të detajuara të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së këtij PPP, duke përfshirë mënyrën si do të kryhet, detyrat dhe përgjegjësitë specifike të personave përgjegjës.

Përgjigja e subjektit:

Referuar shkresës nr. 2485/4 prot., datë 23.10.2023 të Planit të Veprimit të përgatitur nga DPD, ky rekomandim është pranuar dhe është ngarkuar Departamenti Administrativ për realizimin dhe përmbushjen e këtij rekomandimi. Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, MF ka dërguar pranë DPD për kompetencë përmbushjen e këtij rekomandimi nga DPD dhe raportimin pranë MF për ecurinë.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se nuk evidentohet marrja e masave për ngritjen e një grupi të tillë pune referuar rekomandimit të lënë nga KLSH dhe më tej për hartimin e procedurave të detajuara të monitorimit/ vlerësimit të performancës.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pazbatuar.

22.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë MFE dhe DPD të marrin masat për krijimin e një sistemi që monitoron nivelet e kënaqësisë/ankesat e konsumatorëve, me qëllim mbrojtjen e interesit të konsumatorëve lidhur me sasinë, cilësinë dhe nivelin e tarifës të aplikuar për këtë shërbim, duke gjeneruar kështu informacion të vlefshëm në kuadër të vlerësimit për ofrimin e këtij shërbimi dhe rekomandimin e përmirësimeve të mundshme në këtë drejtim.

Përgjigja e subjektit:

Referuar Planit të Veprimit të përgatitur nga MF, ky rekomandim është pranuar pjesërisht dhe përcaktohet se DPD-së do t'i kërkohet që të bëjë pjesë të raportimit periodik vendosjen e procedurave dhe raportimin e të dhënave për vlerësimin e nivelit të kënaqësisë/ ankesave të konsumatorëve. Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, MF ka dërguar pranë DPD për kompetencë përmbushjen e këtij rekomandimi nga DPD dhe raportimin pranë MF për ecurinë. Nga ana e DPD-së në Planin e Masave përmes shkresës nr. 2485/4 prot., datë 23.10.2023, ky rekomandim është pranuar dhe është ngarkuar Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënive me Jashtë për përmbushjen e rekomandimit.

Bazuar në korrespondencën e shkëmbyer brenda përbrenda DPD-së, rezulton se në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, përveç ankesave zyrtare që mund të depozitohet çdo subjekt, institucioni ka vlerësuar ngritjen, mbikqyrjen e sistemit nëpërmjet numrit jeshil **0800 22 22** (<https://www.dogana.gov.al/>) i cili ka akses të pakufizuar për çdo përdorues. Ky numër (pa pagesë) ndodhet i publikuar në faqen zyrtare edhe është i afishuar në të gjithat degët doganore përfshirë dhe ato që ofrojnë shërbimin e skanimit. Administrata Doganore e ka vlerësuar si sistemin më të lehtë, të aksesueshëm për operatorët ekonomik duke e bërë këtë efektiv dhe funksional bazuar dhe në praktikën ndërkombëtare.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se nga ana e DPD-së është vlerësuar përdorimi i këtij sistemi për monitorimin e nivelit të kënaqësisë/ ankesave të konsumatorëve, përfshirë edhe mundësinë për raportim lidhur me shërbimin e skanimit të ofruar për bizneset dhe qytetarët.

Ky rekomandim rezulton i pranuar pjesërisht dhe i zbatuar.

23.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DPD dhe MFE të marrin masat për parashikimin e procedurave të monitorimit lidhur me realizimin e detyrimit kontraktual mbi kompetencat e personelit të punësuar për ofrimin e shërbimit të skanimit nga ana e shoqërisë koncesionare për të garantuar realizimin me cilësi të lartë të interpretimit të imazheve.

Përgjigja e subjektit:

Referuar Planit të Veprimit të përgatitur nga MF, ky rekomandim është pranuar dhe përcaktohet se trajtimi i këtij rekomandimi do t'i kërkohet DPD-së. Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, MF ka dërguar pranë DPD për kompetencë përmbushjen e këtij rekomandimi nga DPD dhe raportimin pranë MF për ecurinë. Nga ana e DPD-së në Planin e

Masave përmes shkresës nr. 2485/4 prot., datë 23.10.2023, ky rekomandim është pranuar dhe është ngarkuar Menaxheri i Projektit për përmbushjen e rekomandimit.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se nuk ka patur informacion apo dokumentacion në dispozicion të grupit të auditimit për të vërtetuar marrjen e masave dhe përmbushjen e këtij rekomandimi.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i pazbatuar.

24.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DPD të marrin masat për parashikimin e kontrolleve lidhur me kohëzgjatjen e një skanimit, duke mos u kufizuar në vetëdeklarimin e koncesionarit, informacion ky që lidhet ngushtë me kapacitetin e skanerit për skanim, me qëllim vlerësimin e informacioneve statistikore të paraqitura për numrin e skanimeve të kryera, krahasimisht me angazhimin në kohë që kërkohet për çdo skanim, në kuadër të monitorimit të performancës së skanerit.

Përgjigja e subjektit:

Nga ana e DPD-së në Planin e Masave përmes shkresës nr. 2485/4 prot., datë 23.10.2023, ky rekomandim është pranuar dhe është ngarkuar Menaxheri i Projektit për përmbushjen e rekomandimit. Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, MF ka dërguar pranë DPD për kompetencë përmbushjen e këtij rekomandimi nga DPD dhe raportimin pranë MF për ecurinë. Me shkresën nr. 17415/3 prot., datë 25.10.2023, Dega e Doganës Durrës i është drejtuar Sektorit të Operacioneve Doganore, Zyrës së Aposteriorit dhe Riskut në DD Durrës, që të marrin masa për kryerjen e kontrolleve dhe përgatitjen e informacioneve periodike, duke bashkëpunuar me strukturat përgjegjëse në DPD, lidhur me rekomandimin e KLSH.

Me shkresën nr. 2459/1 prot., datë 28.12.2023, Dega e Doganës Kapshticë ka dërguar në DPD, Urdhrin nr. 1, “Për miratimin e planit të veprimit për analizimin, vlerësimin dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH”. Gjithashtu, kjo Degë Doganore ka dërguar pranë DPD shkresën nr. 801 prot., datë 26.03.2024, ku argumenton se ka marrë masa në vijimësi për kryerjen herë pas here të kontrolleve lidhur me kohëzgjatjen e një skanimit në disa raste duke përfshirë edhe kohën e shpenzuar për mbërritje deri në vendin e skanimit, me qëllim vlerësimin e informacioneve statistikore të paraqitura për numrin e skanimeve të kryera krahasimisht me angazhimin në kohë që kërkohet për çdo skanim në kuadër të monitorimit me njëra-tjetrën të strukturave të ngarkuara për lëshimin e urdhrave të skanimit, pikë hyrje, pikë dalje dhe kontrolli fizik dhe strukturave të tjera monitoruese dhe kontrolluese të degës doganore.

Dega Doganore Morinë ka dërguar shkresën nr. 3482/3 prot., datë 26.03.2024 pranë DPD ku përcakton se do të kryejë në vijim kontrolle lidhur me kohëzgjatjen e një skanimit në disa raste duke përfshirë edhe kohën e shpenzuar për mbërritje deri në vendskanim.

Nga Dega Doganore Pogradec (Qafë-Thanë) është dërguar shkresa nr. 378 prot., datë 26.03.2024, ka dërguar tabelën e detajuar për skanimet e vitit 2023, ku rezultoi se janë skanuar 6 mjete/orë, ndërkohë që sipas raportit pika 24. kjo shifër duhet të ishte 20 mjete/orë.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se rekomandimi është pranuar dhe zbatuar pjesërisht, pasi nuk ka informacion dhe dokumentacion mbështetës që të evidentojë përmbushjen e plotë të rekomandimit të lënë nga KLSH.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

25.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese pranë DPD, të marrin masat për vlerësimin e impaktit që ka patur në performancën e koncesionarit, konkludimi në rezultate skanimit me ngjyrë të ndërmjetme, parregullsi që përbëjnë rreth 50% të numrit total të skanimeve, duke përfshirë në këtë analizë dhe efektet në drejtim të angazhimit të personelit doganor për kryerjen e kontrolleve pas skanimit, krahasimisht me gjetjet kryesore të konstatuara nga total procesi.

Përgjigja e subjektit:

Referuar shkresës nr. 2485/4 prot., datë 23.10.2023 të Planit të Veprimit të përgatitur nga DPD, ky rekomandim është pranuar dhe është ngarkuar Departamenti Operativo-Hetimor për realizimin dhe përmbushjen e këtij rekomandimi.

Me shkresën nr. 7012 prot., datë 27.03.2024, DOH ka paraqitur pranë DPD Relacionin për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, ku përcakton se është duke u punuar për mbledhjen e të dhënave statistikore mbi të cilat do të kryhet vlerësimi i impaktit që ka pasur performanca e koncesionarit, si dhe angazhimin e personelit doganor. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD, është duke analizuar të dhëna të detajuara për të vlerësuar ndikimin e rezultateve të skanimit me ngjyrë të ndërmjetme në performancën e koncesionarit. Kjo analizë ka përfshirë: **Monitorimin e Performancës:** Përcaktimin e numrit të skanimeve me ngjyrë të ndërmjetme dhe krahasimin e tyre me skanimet me ngjyrë të kuqe dhe të verdhë, për të identifikuar tendencat dhe përqindjet e parregullsive.

Vlerësimin e Efektivitetit: Analizimin e efektivitetit të analizës së imazheve të "R. S." dhe ndikimin e saj në identifikimin e parregullsive.

Analizën e Ngarkesës së Punës: Përcaktimin e kohës dhe burimeve të nevojshme për kryerjen e kontrolleve pas skanimit, në varësi të rezultateve të skanimit dhe nivelit të parregullsive të evidentuara.

Krahasimin me Gjetjet Kryesore: Analizimin e efektivitetit të kontrolleve pas skanimit dhe krahasimin e tyre me gjetjet kryesore të konstatuara nga i gjithë procesi, për të identifikuar mundësitë për përmirësim.

DPD është duke shqyrtuar këto materiale të disponueshme dhe ka kërkuar të dhëna shtesë nga degët doganore me synimin e realizimit të një analizë të thelluar të problematikës lidhur me impaktin e rezultateve të skanimit me ngjyrë të ndërmjetme në performancën e koncesionarit dhe angazhimin e personelit doganor për kryerjen e kontrolleve pas skanimit.

Si përfundim: DPD vlerëson rekomandimin e lënë nga KLSH por kjo analizë është një proces kompleks që kërkon kohë dhe burime të konsiderueshme për të realizuar një analizë të plotë dhe të saktë. Për të përmirësuar këtë proces DPD është duke punuar në mënyrë që të marrë disa hapa që do të lehtësonin në përgatitjen e këtyre të dhënave me qëllimin e ruajtjes së kësaj praktike pune edhe në vijimësi.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se janë ndërmarrë masa për përmbushjen e rekomandimit, megjithatë ai nuk është ezauruar plotësisht nga strukturat përkatëse.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

25.2.Rekomandimi: Strukturat përkatëse pranë MFE të shqyrtojë analizën e mësipërme, duke përcaktuar edhe efektet që ka patur ky ndryshim në aspekt të detyrimeve kontraktuale të shoqërisë aksionare.

Përgjigja e subjektit:

Referuar Planit të Masave të përgatitur nga MF, ky rekomandim është pranuar pjesërisht pasi prek aspekte teknike të cilat i përkasin DPD si autoriteti ekskluziv përfaqësues dhe zbatues i kontratës dhe për këtë arsye argumentohet se i është referuar DPD në trajtim të bashku me rekomandimin nr. 15. Me shkresën nr. 10426 prot., datë 26.07.2024, MF ka dërguar pranë DPD për kompetencë përmbushjen e këtij rekomandimi nga DPD dhe raportimin pranë MF për ecurinë

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se nuk ka informacion apo dokumentacion mbështetës për të evidentuar përmbushjen e këtij rekomandimi nga ana e MF, së cilës i është drejtuar rekomandimi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pazbatuar.

26.1.Rekomandimi: Nga ana e strukturave përgjegjëse pranë DPD dhe MFE të kërkohet përmbushja e detyrimit kontraktual nga ana e koncesionarit në drejtim të paraqitjes së raporteve mujore, duke përshkruar gjendjen e shërbimeve, si dhe garantimin e saktësisë së informacionit në këto raporte duke kufizuar mundësinë e deformimit të këtyre informacioneve.

Përgjigja e subjektit:

Referuar Planit të Masave të përgatitur nga MF, ky rekomandim është pranuar dhe argumentohet se në vijimësi do t'i kërkohet shoqërisë koncesionare që të realizojë një raportim më të gjerë duke përfshirë raporte për performancën, ankesat si dhe rubrika të tjera. Referuar shkresës nr. 2485/4 prot., datë 23.10.2023 të Planit të Veprimit të përgatitur nga DPD, ky rekomandim është pranuar dhe është ngarkuar Menaxheri i Projektit për realizimin dhe përmbushjen e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se nga subjekti nuk është paraqitur informacion apo dokumentacion mbështetës për të evidentuar përmbushjen e këtij rekomandimi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pazbatuar.

27.1.Rekomandimi: Nga ana e strukturave përgjegjëse pranë MFE të merren masat për të analizuar efektet e problematikave të identifikuara më sipër me qëllim identifikimin e përgjegjësive sipas rastit, dhe shmangien e situatave të ngjashme, me risk të shtuar për krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe kostove shtesë në buxhetin e shtetit, si rezultat i aplikimit të penaliteteve për mos likuidim të pagesave për shkak të mungesës së fondeve në dispozicion.

Përgjigja e subjektit:

Referuar Planit të Masave të përgatitur nga MF, ky rekomandim është pranuar dhe përcaktohet se nuk konstatohet të jenë aplikuar penalitete në dëm të AK si shkak i vonesave në pagesa ndaj shoqërisë koncesionare. Në lidhje me vonesat e shkaktuara si pasojë e forcave madhore, MF sqaron se janë paguar dhe pranuar në prani të plotë nga Drejtoria e Koncesionave pa aplikuar penalitete. Megjithatë MF përcakton se do të kujdeset që në të ardhmen të shmangë pagesa të vonuara ndaj AK.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se nuk është paraqitur informacion apo dokumentacion mbështetës për të evidentuar përmbushjen e këtij rekomandimi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pazbatuar.

3. Mbi zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Në auditimin e mëparshëm KLSH, ka rekomanduar 1 masë disiplinore, në kompetencë të titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, realizimi i së cilës paraqitet si më poshtë.

MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germat “b”, “c” dhe “ç”; bazuar në nenin 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe në VKM Nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i kërkojmë Ministrin të Ekonomisë dhe Financave, të fillojë procedurat e për vlerësimin dhe dhënien e masave disiplinore në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil” sipas përgjegjësisë individuale për:

- Anëtarët e Grupit për Identifikimin e Propozimit (GIP) për dhënien me koncesion të projektit të Skanimit të Kontejnerëve dhe Automjeteve në Republikën e Shqipërisë për problematikat e rezultuara në veprimtarinë e tij për vlerësimin e propozimit të pa kërkuar të skanimit në dogana;
- Anëtarët e Njësisë së Hartimit të Dokumenteve të procedurës për dhënien me koncesion të projektit të Skanimit të Kontejnerëve dhe Automjeteve në Republikën e Shqipërisë për mangësitë e rezultuara gjatë procedurës për përzgjedhjen e shoqërisë për dhënien me koncesion të shërbimit të skanimit;
- Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertës së pa kërkuar të koncesionit të Skanimit të Kontejnerëve dhe Automjeteve në Republikën e Shqipërisë për problematikat e konstatuara gjatë procedurës për përzgjedhjen e shoqërisë koncesionare;
- Anëtarët e Grupit të punës të ngritur për negocimin e kontratës së koncesionit së miratuar me Ligjin 123/2013 dhe të rishikuar më pas për termat financiar të saj me ligjin nr. 74/2015 dhe Ligjin nr. 118/2015;
- Zyrtarët përgjegjës për monitorimin e kontratës koncesionare përgjatë periudhës së zbatimit të saj, të cilët nuk kanë identifikuar dhe nuk kanë marrë masat për zgjidhjen e problematikave të konstatuara në Raportin përfundimtar të Auditimit dhe për çështje të trajtuara në Raport gjatë fazës së investimit dhe zbatimit të kontratës, si: vlerësimi i investimit, përcaktimi i vendndodhjes së skanerëve, etj.

Përgjigjja e subjektit:

Referuar Planit të Veprimit të përgatitur nga MF, ky rekomandim është pranuar pjesërisht, me arsyetimin se referuar ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në nenin 59, pika 8, përcaktohet se “*Procedimi disiplinor fillon pa vonesë, me marrjen dajeni për një shkelje disiplinore, por jo më vonë se brenda një afati 2-vjeçar nga data e kryerjes së shkeljes. Në rastin e shkeljeve të rënda, që mund të rezultojnë në marrjen e masës disiplinore të largimit nga shërbimi civil, afati është 8 vjet*”. Në bazë të kësaj dispozite, MF argumenton se procedimi disiplinor për këta individë nuk mund të fillojë për shkak të kalimit të afatit 8 vjeçar nga data kur është konstatuar shkelja. Në këtë kuadër, nga MF gjykohet se sa i takon rolit si AK, bazuar në përshkrimin e punës, specifikisht është parashikuar se nga strukturat, njësitë e zbatimit të projektit, në këtë rast Menaxheri i Projektit, MF duhet të marrë periodikisht raportim në lidhje me ecurinë e zbatimit të kontratës, edhe pse ka dërguar në vijimësi shkresa për këtë gjë. MF argumenton se është struktura që proceson dhe adreson shqetësimet që mund të dalin nga raportimet që mund të dalin nga këto struktura. MF dhe Drejtoria e Koncesioneve merr informacionin bazuar në përshkrimin e punës nga të gjitha strukturat përgjegjëse dhe adreson problematikat që janë shfaqur bazuar mbi to. MF arsyeton se në të gjitha raportimet që janë dorëzuar, edhe pse raportimi ndonjëherë nuk ka qenë periodik, por edhe raportimet e iniciuara nga vetë MF në periudhë vjetore, nuk janë evidentuar këto problematika. Ndaj, gjykohet që gjetja e KLSH mund të pranohet vetëm përse i përket detyrave që ka menaxheri i kontratës pranë DPD-së. Për pjesën tjetër, nuk mund të pranohet, pasi nga MF nuk rezulton që duhet të ngarkojë me përgjegjësi punonjësit e MF, ndërkohë që raportimi vjetor, nga raportimet periodike dhe nga raportimet që ka bërë vetë koncesionari pranë MF si AK, nuk ka raportime që të kenë përcjellë këtë ankesë në mënyrë që të ushtrojë kompetencën në zgjidhjen e tyre. Në përfundim, MF argumenton nuk mund të nisë procedim disiplinor për zyrtarët përgjegjës për monitorimin e kontratës në Drejtorinë e Koncesioneve, pasi monitorimi kryhet mbi bazën e raportimit të dërguar nga DPD si autoritet ekskluziv për monitorimin dhe zbatimin e kontratës koncesionare, por do t’i dërgohet shkresë DPD për marrjen e masave dhe nxjerrjen e personave përgjegjës në strukturat e saj të ngarkuara për monitorimin e kontratës.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se grupit të auditimit nuk i janë vënë në dispozicion informacione apo dokumentacione që të vërtetojnë marrjen e masave për vlerësimin dhe dhënien e masave

disiplinore të sipërcituara, lidhur me pjesën e pranuar të rekomandimit (zyrtarët përgjegjës për monitorimin e kontratës koncesionare).

Ky rekomandim rezulton i pranuar pjesërisht dhe i pazbatuar.

NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Përgjigja e subjektit:

Referuar Planit të Veprimit të përgatitur nga MF, ky rekomandim është pranuar pjesërisht, me argumentimin se bazuar në ligjin nr. 152/2013, neni 59, pika 8 përcaktohet se nuk mund të nisë procedim disiplinor për individët për të cilët janë konstatuar shkelje në tejkalim të afatit 8 vjeçar. Megjithatë, për personat përgjegjës për monitorimin e kontratës koncesionare MF do t’i drejtohet me shkresë DPD për marrjen e masave për personat përgjegjës.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se pavarësisht se rekomandimi është i pranuar pjesërisht, përgjatë auditimit në terren, grupit të auditimit nuk i janë vënë në dispozicion informacione apo dokumentacione që të vërtetojnë marrjen e masave për pjesën e pranuar të rekomandimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar pjesërisht dhe i pazbatuar.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 1106/12 prot., datë 05.10.2023 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe me shkresën nr. 1106/13 prot., datë 05.10.2023 në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **32** rekomandime si masa organizative, nga ku janë pranuar **30** të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **2** zbatuar plotësisht, **2** në proces zbatimi, **17** pa zbatuar, **9** zbatuar pjesërisht.

b. Për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, është lënë **1** rekomandim i cili është pranuar pjesërisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit **pazbatuar**.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për sa më sipër, ri kërkojmë që, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar, si dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025.

MASA ORGANIZATIVE

1.1.Rekomandimi: Ministria e Financave të analizojë problematikën e këtij koncesioni duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrin masa për vijimin e procedurave për vlerësimin dhe miratimin e projekteve koncesionare me dokumentacion të plotësuar, me qëllim vlerësimin dhe miratimin e koncesioneve që janë në dobi dhe interes të ekonomisë kombëtare.

2.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese pranë Ministrisë së Financave të analizojnë problematikat e këtij koncesioni duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, dhe të marrin masa për organizimin më të mirë të procedurave koncesionare që në fazat e hershme të propozimit, duke kryer analiza të thelluara përpara vendosjes së çmimeve, dhe të mos ndërmerren hapa të cilat mund të komprometojnë operatorët ose buxhetin e shtetit.

5.1.Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim vlerësimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës për mos përmbushjen e detyrimit nga ana e shoqërisë koncesionare, si dhe marrjen e masave për aplikimin e sanksioneve ndaj shoqërisë koncesionare për mos përmbushjen e detyrimit kontraktual të koncesionarit për të garantuar lidhjen me serverin ose sëitchin lokal më të afërt të vendit të Autoritetit, për qëllimet e transferimit të imazheve dhe analizimin e të dhënave të tyre.

7.1.Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga MFE dhe DPD, me qëllim (i) kryerjen e një vlerësimi të plotë të investimit, duke evidentuar devijimet e mundshme nga propozimi fillestar, (ii) evidentimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës për parregullsitë e konstatuara në përmbushjen e detyrimeve nga ana e shoqërisë koncesionare, si dhe (iii) përlllogaritjen e impaktit financiar të këtyre mos përmbushjeve nga ana e shoqërisë koncesionare, në raport me propozimin.

9.2.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë MF dhe DPD të marrin masat për të garantuar kryerjen e kontrolleve periodike dhe vjetore lidhur me realizimin e të ardhurave nga skanimi nëpërmjet kryqëzimit të informacioneve mbi deklaratat e përpunuara sipas tarifave përkatëse, si dhe zhvillimin e anketave apo verifikimeve të tjera për trafikun/përdoruesit e shërbimeve.

10.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë MF të marrin masat për të përlllogaritur detyrimet kontraktuale dhe asetet e kësaj kontrate duke mundësuar raportimin e drejtë në pasqyrat financiare, me qëllim paraqitjen e informacionit sa më të plotë nga përdoruesit e PF.

11.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë MF dhe DPD të marrin masat për vlerësimin e situatës së trajtuar më sipër, dhe marrjen e masave përkatëse ndaj shoqërisë koncesionare për mos zbatimin e këtij detyrimi kontraktual, sipas specifikave të parashikuara në dokumentacionin pjesë e këtij projekti, si dhe ndaj strukturave përgjegjëse për identifikimin dhe raportimin e mos realizimit të detyrimeve kontraktuale të shoqërisë.

12.1.Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e shkaqeve dhe personave përgjegjës që kanë sjellë (i) operimin e ekspozuar ndaj risqeve të skanerit në Portin e Durrësit dhe (ii) moszbatimin nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të përcaktimeve të Marrëveshjes nr. 14980 Prot., datë 06.09.2013 “Për dhënie në përdorim të vendit ku do të instalohet skaneri në Degën Doganore Durrës”, si dhe (iii) të ndërmarrë hapat e nevojshëm për përsheptimin e këtij procesi, me qëllim garantimin e efektivitetit të shërbimit të skanerit në Portin e Durrësit.

15.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë MF të marrin masat për ngritjen e një grupi pune me përfaqësues nga DPD dhe MF, me qëllim hartimin e kontrolleve që duhet të implementohen në pikat doganore të pajisura me skaner për verifikimin e saktësisë së skanimit, dhe identifikimin e mundshëm të gabimeve në skanim, duke parashikuar një marzh për kryerjen e kontrolleve fizike të mjeteve të identifikuar nga skaneri si të rregullta (pa ngjyrë), të cilat deri tani janë jashtë fushës së kontrollit të autoriteteve doganore dhe si rezultat, ky nivel monitorimi nuk ka mundësuar verifikimin e saktësisë së skanimit.

16.1.Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga MF dhe DPD, me qëllim hartimin e Regjistrit të Riskut për aktivitete që lidhen me shërbimin e skanimit në pikat doganore, me qëllim identifikimin, vlerësimin dhe minimizimin e risqeve përkatëse.

19.2.Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me përbërje nga MF dhe DPD, për të analizuar rezultatet e raportit dhe për të kërkuar negocimin me shoqërinë koncesionare, për shtimin e pikave doganore ku ofrohet shërbim, pa ndryshuar kushtet e tjera, duke përfshirë pikat doganore në të cilat paraqitet fluksi/risku më i lartë.

21.1.Rekomandimi: Titullari i Ministrisë së Financave të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me përbërje nga MF dhe DPD me qëllim hartimin e objektivave SMART së bashku me indikatorët përkatës ku të reflektohen edhe qëllimet fillestare të inicimit këtij Partneriteti Publik-Privat.

21.2. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të marrë masa për (i) ngritjen e një grupi pune (të përhershëm për afatin e kontratës) për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate me specialistë të fushës, ku të përfshihen së paku një ekonomist, një jurist dhe një inxhinier i fushës, me ndarje të qartë të detyrave, për monitorimin periodik të përmbushjes së objektivave dhe indikatorëve që do të vendosen bazuar në rekomandimin më sipër, dhe (ii) hartimin e procedurave të detajuara të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së këtij PPP, duke përfshirë mënyrën si do të kryhet, detyrat dhe përgjegjësitë specifike të personave përgjegjës.

23.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DPD dhe MF të marrin masat për parashikimin e procedurave të monitorimit lidhur me realizimin e detyrimit kontraktual mbi kompetencat e personelit të punësuar për ofrimin e shërbimit të skanimit nga ana e shoqërisë koncesionare për të garantuar realizimin me cilësi të lartë të interpretimit të imazheve.

25.2.Rekomandimi: Strukturat përkatëse pranë MF të shqyrtojnë analizën e mësipërme, duke përcaktuar edhe efektet që ka patur ky ndryshim në aspekt të detyrimeve kontraktuale të shoqërisë aksionare.

26.1.Rekomandimi: Nga ana e strukturave përgjegjëse pranë DPD dhe MF të kërkohej përmbushja e detyrimit kontraktual nga ana e koncesionarit në drejtim të paraqitjes së raporteve mujore, duke përshkruar gjendjen e shërbimeve, si dhe garantimin e saktësisë së informacionit në këto raporte duke kufizuar mundësinë e deformimit të këtyre informacioneve.

27.1.Rekomandimi: Nga ana e strukturave përgjegjëse pranë MF të merren masat për të analizuar efektet e problematikave të identifikuara më sipër me qëllim identifikimin e përgjegjësive sipas rastit, dhe shmangien e situatave të ngjashme, me risk të shtuar për krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe kostove shtesë në buxhetin e shtetit, si rezultat i aplikimit të penaliteteve për mos likuidim të pagesave për shkak të mungesës së fondeve në dispozicion.

MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germat “b”, “c” dhe “ç”; bazuar në nenin 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe në VKM Nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i kërkojmë Ministrit të Financave, të fillojë procedurat e për

vlerësimin dhe dhënien e masave disiplinore në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil” sipas përgjegjësisë individuale për:

- Anëtarët e Grupit për Identifikimin e Propozimit (GIP) për dhënien me koncesion të projektit të Skanimit të Kontejnerëve dhe Automjeteve në Republikën e Shqipërisë për problematikat e rezultuara në veprimtarinë e tij për vlerësimin e propozimit të pa kërkuar të skanimit në dogana;
- Anëtarët e Njësisë së Hartimit të Dokumenteve të procedurës për dhënien me koncesion të projektit të Skanimit të Kontejnerëve dhe Automjeteve në Republikën e Shqipërisë për mangësitë e rezultuara gjatë procedurës për përzgjedhjen e shoqërisë për dhënien me koncesion të shërbimit të skanimit;
- Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertës së pa kërkuar të koncesionit të Skanimit të Kontejnerëve dhe Automjeteve në Republikën e Shqipërisë për problematikat e konstatuara gjatë procedurës për përzgjedhjen e shoqërisë koncesionare;
- Anëtarët e Grupit të punës të ngritur për negocimin e kontratës së koncesionit së miratuar me Ligjin 123/2013 dhe të rishikuar më pas për termat financiar të saj me ligjin nr. 74/2015 dhe Ligjin nr. 118/2015;
- Zyrtarët përgjegjës për monitorimin e kontratës koncesionare përgjatë periudhës së zbatimit të saj, të cilët nuk kanë identifikuar dhe nuk kanë marrë masat për zgjidhjen e problematikave të konstatuara në Raportin përfundimtar të Auditimit dhe për çështje të trajtuara në Raport gjatë fazës së investimit dhe zbatimit të kontratës, si: vlerësimi i investimit, përcaktimi i vendndodhjes së skanerëve, etj.

NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, Ministri i Financave, pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, ***të ndërmarrë veprimet si më poshtë:***

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

3.2 AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditimin tematik në **Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara** (*këtu e në vazhdim AAPSK*), me objekt “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në vitin 2023*”, për auditimin e përputhshmërisë, përcjellë me shkresën 17/13 prot., datë 04.10.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

Vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve;

Vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Regjistrin elektronik institucional të zbatimit të rekomandimeve.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 1325/7 prot., datë 04.11.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga grupi i audituesve i përbërë nga:

- H. S, përgjegjës i grupit të auditimit
- K. N, auditues.

Auditimi filloi më datë 04.11.2024 dhe përfundoi më datë 13.12.2024.

II/1. OBJEKTI I AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 17/13 prot., datë 04.10.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së.

II/2. QËLLIMI I AUDITIMIT

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 të nenit 31 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II/3. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditimi i plotë i të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH për përmirësimin e gjendjes së subjekteve në të ardhmen.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III/1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti **Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara** në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 17/13 prot., datë 04.10.2023 rezultoi se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 rekomandim për përmirësimin e legjislacionit, i cili është pranuar dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit i pazbatuar.
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 20 rekomandime si masa organizative, nga ku janë pranuar 19 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 6 rekomandime të zbatuara, 7 zbatuar pjesërisht dhe 6 të pazbatuara.
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 2 rekomandime për shpërblim dëmi nga ku 2 rekomandime të pranuar, dhe 2 kanë statusin e ecurisë zbatuar pjesërisht.
- Për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, janë lënë 8 rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit zbatuar plotësisht.

Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezultoi në nivel 97%, konkretisht nga 31 rekomandime gjithsej, janë pranuar 30 rekomandime.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën 47%, niveli i rekomandimeve pa zbatuara rezultoi 23%, niveli i rekomandimeve zbatuara pjesërisht rezultoi 30% nivele.

III/2. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në **Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*” për periudhën nga 01.10.2017 deri në 31.12.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së, përcjellë me shkresën nr. 17/13 prot., datë 04.10.2023, rezultoi si më poshtë vijon:

A. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën e KLSH nr. 17/13 prot., datë 04.10.2023, protokolluar në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë të ushtruar në AAPSK, sipas Programit të Auditimit me nr. 17/1 prot., datë 31.10.2022.

-AAPSK ka kthyer përgjigje në tejkalim të afatit ligjor prej 20 ditëve, me shkresën nr. 27/49 prot., datë 26.10.2023, ku gjithashtu, nga institucioni nuk ka patur kundërshtime për rekomandimet e KLSH, për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse, nuk ka pranuar vetëm një rekomandim. Kryeadministratori ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim.

-Në zbatim të afatit ligjor të përcaktuar në pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, e cila citon: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna” rezultoi se:

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara nuk ka përcjellë informacion mbi raportin për realizimin e zbatimit të rekomandimeve i cili duhet të dërgohej brenda afatit 6-mujor për statusin e zbatimit të tyre.

B. Zbatimi i rekomandimeve për masat për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në mënyrë më të detajuar, auditimi i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve për secilin rekomandim të përcjellë në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara paraqitet:

1.1 Rekomandimi: Kryeadministratori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, të marrin masa për të paraqitur pranë Këshillit të Ministrave propozimet për përmirësim ligjor me qëllim harmonizimin e kuadrit ligjor në fuqi në lidhje me afatet e revokimit dhe marrjes në dorëzim të provave materiale.

Përgjigja e subjektit:

“Është ngritur një grup pune me specialistë të MB dhe DPPSH për përmirësimet në ligjin nr. 34/2019, të ndryshuar. Janë përcjellë propozimet tona, të gjithë anëtarëve. Priten veprimet e mëtejshme nga D/Juridike të MB.”

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezultoi se, Kryeadministratori ka nxjerrë urdhrin nr. 353, datë 16.05.2023 (nr. 1531/1 prot., datë 16.05.2023) “Për ngritjen e grupit të punës të përgatitjes së projekt -akteve ligjore në përmirësim të ligjit nr. 10192/2009, të ndryshuar, ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre”. Grupi ka përcjellë në Ministrinë e Brendshme propozimet për ndryshime ligjore. Pas dërgimit të propozimeve, nuk rezulton të kenë vazhduar procedurat për ndryshim ligjor.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

1.1 Rekomandimi: Kryeadministratori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me mungesën e aksesimit të regjistrimit elektronik, si dhe të komunikojë me strukturat drejtuese të Ministrisë së Brendshme dhe AKSHI-t, me qëllim vënien në përdorim dhe përditësimin e regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

Përgjigja e subjektit:

Vazhdojnë të hidhen te dhënat ne sistem nga administratorët. Sistemi aktual nuk zgjidh të gjitha problemet teknike në lidhje me hedhjen dhe ruajtjen e të dhënave të pasurive nga administratorët. Siç edhe kemi theksuar AAPSK nuk ka disponuar asnjëherë kontratën me kompaninë e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të projektit. Kontrata e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të projektit sipas kompanisë fituese të tenderit(nga AKSHI) ka mbaruar ka qenë 4 vite mirëmbajtje.”

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se Kryeadministratori nuk ka marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me mungesën e aksesimit të regjistrimit elektronik. Sipas pretendimeve të AAPSK-së, sistemi aktual nuk zgjidh të gjitha problemet teknike në lidhje me hedhjen dhe ruajtjen e të dhënave të pasurive nga administratorët. Kontratat e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të projektit, e lidhur nga AAPSK me afat 4 vjeçar ka përfunduar. AAPSK ka njoftuar AKSHI-n dhe Ministrinë e Brendshme në lidhje me problematikat. Pavarësisht vënies në dijeni të AKSHI-t dhe Ministrisë së Brendshme, situata vazhdon të ngelet e njëjtë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

2.1 Rekomandimi: Kryeadministratori të shqyrtojë situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për problematikat e konstatuara në administrimin e pasurive. Administratorët, të marrin masa për plotësimin e deklaratës me shkrim para lidhjes së kontratës së qirasë; marrjen në administrim në afatet përkatëse; njoftimin e menjëhershëm të masës së sekuestrimit, në organet dhe subjektet ku mbahen këta regjistra; për paraqitjen në afat të pasurive të konfiskuara me vendim gjykatë të formës së prerë pranë Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar; për paraqitjen e raporteve dhe kërkesave në afatet respektive, si dhe sigurimin e pasurisë për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë.

Përgjigja e subjektit:

“Nga AAPSK do të merren masa që në të ardhmen për të gjitha pasuritë e dhëna me qira të merret deklarata me shkrim nga qiramarrësi për konfliktin e interesit, kjo mbështetur në Rregulloren nr. 1371, datë 07.06.2022.

-Pasuria e subjektit “T T B” është marrë në administrim dhe për këtë është njoftuar Gjykata dhe prokuroria.

-Në lidhje me gjetjen 2.1/c pranohet, është lidhur kontrata e qirasë me F. H me nr. kontrate 1..., datë 05.05.2023, ku është bërë deklarata e konfliktit të interesit.

Në lidhje me përgjegjësinë nuk mund të bëjmë përgjegjës asnjë njeri, pasi stafi aktual i AAPSK nuk ka qenë në marrëdhënie pune në kohën kur ka ardhur vendimi i AASPK, përkundrazi vendimi është zbuluar nga stafi i sotëm i AASPK. Në lidhje me këtë pasuri u bëjmë me dije se ka kaluar në komitet për marrjen e vendimit për de stinimin e pasurisë. 2/2 (F) pasuria e markës “A” A6 me targë A.Y nuk është marrë në dorëzim nga administratori..

2/2 G) Në zbatim të rekomandimit të KLSH-së dhe VKM nr. 687, datë 05.10.2011, neni 18, Udhëzimin nr.324, datë 02.10.2020 për përcaktimin e rregullave...janë marrë masa për sigurimin e pasurive tërmeti dhe përmytje (ZTE).”

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se nuk janë nxjerrë përgjegjësitë për problematikat e konstatuara, në administrimin e pasurive.

Konstatohet se Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin nr. 213, datë 16.04.2024 (nr. 1334 prot., datë 16.04.2024) “Për unifikimin e kërkesës për qiramarrjen të pasurive në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, ku është miratuar formati i modelit të kërkesës për qiramarrje të pasurive, në të cilin është vendosur edhe një paragraf në lidhje me deklarinimin e konfliktit të interesit.

- Pasuria “T T B” është marrë në administrim dhe është njoftuar gjykata edhe prokuroria. Sipas shkresës nr. 19950/1, datë 18.10.2023 administratori i pasurisë është caktuar E. B.

-Në lidhje me gjetjen 2.1.c është lidhur kontrata e qirasë nr. 1, datë 05.05.2023 me z. F.H, ku është nënshkruar edhe deklarata e konfliktit të interesit.

- Në lidhjen me gjetjen 2.1.d, sipas procesverbalit të datës 05.10.2023, pasuritë kanë kaluar në Komitetin Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar për marrjen e vendimit për destinimin e pasurisë. Komiteti ka orientuar AAPSK-në që këtë pasuri ta vlerësojë Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëse është e përshtatshme për ta kaluar në fondin e investimeve strategjike.

-Pasuria automjeti me targë A.Y, i markës “A” model A6, vazhdon të mos jetë marrë në dorëzim. Në lidhje me këtë pasuri i janë bërë disa shkresa Drejtorisë së Transportit Rrugor dhe Drejtorisë së Policisë për bllokim.

-Pasuritë me nr. 211/14, 102/5, 119/2, 119/3 janë dërguar për shitje në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresat nr. 3406, datë 17.10.2023, 3407, datë 17.10.2023, nr. 3408, datë 17.10.2023 dhe 3410, datë 17.10.2023,

-Në lidhje me sigurimin e pasurive nga zjarri, tërmeti dhe eksplozioni kanë dalë urdhrat e prokurimeve për blerje te vogla nr. 22, datë 29.06.2023 dhe urdhri nr. 11, datë 22.07.2024.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

3.1 Rekomandimi: Kryeadministratori të shqyrtojë situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe nga ana e administratorit përkatës dhe ndihmësit të tij, të merren masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurat e sipërcituara, duke cilësuar të gjithë procesin apo veprimtarinë administrative në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor.

Përgjigja e subjektit:

Ka dalë urdhri për inventarizimin e dosjeve.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhrin nr. 628, darë 24.10.2023 (nr. 3493 prot., datë 24.10.2023) “Për inventarizimin e dosjeve të pasurisë”. Duke qenë se pas këtij urdhri nuk u inventarizuan të gjithë dosjet, Kryeadministratori ka nxjerrë urdhrin nr. 249, datë 29.04.2024 (nr. 1591 prot., datë 29.04.2024) “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”, ku objekt i inventarizimit do të jenë 251 pasuri, të 10 administratorëve. Konstatohet se nuk janë nxjerrë përgjegjësitë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

4.1 Rekomandimi: Kryeadministratori të shqyrtojë situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë, si dhe nga ana e administratorit përkatës, në lidhje me mjetet motorike, të cilat ende nuk janë marrë në administrim (dorëzim), të merren masa, për njoftimin e DPSHTRR-së si dhe për vendosjen e RBS-së.

Përgjigja e subjektit:

Në ligjin nr. 34/2019 nuk parashikohet se duhet të bëhet regjistrimin në RBS. Në të gjithë rastet e sekuestrimi dhe konfiskimit është njoftuar DPSHTR me shkresë zyrtare.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi u konstatua se nga AAPSK në rastet e sekuestrimit/konfiskimit të mjeteve motorike është njoftuar DSHTR, por nuk janë marrë masa për vendosjen e RBS-së.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, administratorët përkatës, në lidhje me shoqëritë tregtare të administruara në mënyrë të drejtpërdrejtë, të merren masa që:

- Vendimmarrja për administrimin e tyre të jetë e pavarur dhe e pandikuar nga subjekti mbi të cilin rëndon masa e sekuestrimit apo konfiskimit;
- Regjistrimi i bilancit vjetor kontabël pranë QKB-së, të kryhet brenda afateve ligjore.

Përgjigja e subjektit:

Në zbatim të rekomandimit nr. 5/1 AAPSK, Administratorët që administrojnë shoqëri tregtare në administrim të drejtpërdrejtë të respektojnë afatet e dorëzimit të pasqyrave financiare në QKB, vendimmarrja e tyre të jetë e pavarur dhe ndikuar nga subjekti. E gjithë veprimtari financiare e shoqërive të kryhet mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi rezultoi se:

- Për shoqërinë “A. E. F”, me NUIS: L....Q, që ka kaluar nën administrimin e AAPSK-së më datë 14.10.2021, janë depozituar pranë QKB-së pasqyrat financiare të vitit 2022, në datë 31.07.2023, por pasqyrat financiare të vitit 2021, nuk janë depozituar;
- Për shoqërinë “A. E”, me NUIS: L....H, pasqyrat financiarë të vitit 2021 janë depozituar në QKB, në tejkalim të afatit, konkretisht më 28.07.2023 dhe është paguar sanksioni për depozitim me vonesë të pasqyrave financiare, ndërsa pasqyrat financiare të vitit 2022 dhe 2023 janë depozituar brenda datës 31 korrik, të vitit pasardhës.
- Për shoqërinë “I T S” me NUIS: L....C, nga verifikimi rezultoi se nuk ka pasqyra financiare të depozituara pranë QKB-së, kur ka kaluar nën administrim të AAPSK. Pavarësisht masave të marra ende rezultojnë subjekte të cilët nuk kanë depozituar pasqyrat financiarë në QKB.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

6.1 Rekomandimi: Nga ana e Kryeadministratorit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa: që punësimi i administratorëve të kryhet me një procedurë konkurrimi të hapur dhe në përputhje me të gjitha kriteret e përcaktuara për pozicionin e punës; që gjatë dhënies së masave disiplinore, të respektohet procedura administrative duke i garantuar të drejtën e subjektit për t’u informuar, për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për t’u ankuar; që administratorët dhe ndihmës administratorët, të njihen me formularin përkatës të vlerësimit të performancës dhe ky i fundit të jetë pjesë e dosjeve të personelit. Gjithashtu, të merren masa për plotësimin e përditësimin e librezave të punës, si dhe për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me punonjësit që arrijnë moshën për dalje në pension pleqërie.

Përgjigja e subjektit:

Procesi i rekrutimit është bërë me procedurë konkurrimi të rregullt. Pas periudhës së kontrollit

nuk kemi dhënë masa disiplinore. Punonjësit janë njohur me performancat e tyre dhe kanë nënshkruar formularët e vlerësimit. Dy punonjësit që kanë mbushu moshën e pleqërisë kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me AAPSK-në. Librezat e punës janë përditësuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga verifikimi mbi zbatimin e këtij rekomandimi nga grupi i auditimit u përzgjedhën 5 praktika të rekrutimeve të bëra gjatë vitit 2024, nga ku rezultoi se janë ndjekur procedurat e rekrutimit. Ndërsa për dosjet e personelit ekzistues janë verifikuar dosjet e personelit, në mënyrë rastësore janë parë sërish 5 dosje nga ku rezultoi se mungojnë fletët prezantuese të dosjeve. Ndërsa personat të cilët kanë mbushur moshën e pensionit, të evidentuar nga grupi i auditimit të KLSH-së, i kanë shkëputur marrëdhënie e punësimit, por aktualisht në strukturë rezultojnë një punonjës tjetër i cili ka mbushur moshën e pensionit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

7.1 Rekomandimi: Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa:

-për shitjen e pasurive të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme, ose dalin jashtë përdorimit, duke respektuar parimin e mirëadministrimit, si edhe shmangien e shpërdorimit të tyre.

-për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurive të luajtshme dhe provave materiale në administrim me qëllim shmangien e humbjes apo tjetërsimit të tyre.

-dorëzimin e pasurive të luajtshme në mjediset e caktuara magazinuese.

-nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me mosdorëzimin e automjeteve në ambientet magazinuese.

Përgjigja e subjektit:

“AAPSK do të marrë masat e duhura për fillimin e shitjeve të pasurive të cilave u bie vlera në mënyrë të ndjeshme. Ka dalë Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 5, datë 55, datë 27.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe proceduarve të shitjes dhe depozitimin e të ardhurave nga shitja e pasurisë së sekuestruar të cilat dëmtohen dhe u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose dalin jashtë përdorimit.

-AAPSK do të marrë masat e duhura për fillimin e inventarëve të pasurive të luajtshme dhe Pronave materiale, ka dalë Urdhri nr. 614, datë 19.10.2023 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të pasurive të paluajtshme në administrim të AAPKS-së”

-Pasuritë (automjetet) janë marrë në administrim nga administratorët e pasurive, janë bllokuar me shkresa në DPSHTR, por kanë qenë të bllokuara në Rezervat e Shtetit dhe në Komisariate të policisë të bllokuara, nuk janë tërhequr në magazinë për arsye transporti dhe mungesa në hapësirë në magazinën e AAPSK-së (nuk kanë humbur, siç thuhet në raport 24 copë).

Gjatë periudhës në vazhdim janë marrë masat nga AAPSK dhe janë tërhequr automjetet dhe janë bërë hyrje në magazinë”.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezultoi se ka dalë udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 5, datë 55, datë 27.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe proceduarve të shitjes dhe depozitimin e të ardhurave nga shitja e pasurisë së sekuestruar të cilat dëmtohen dhe u bie vlera në mënyrë të ndjeshme ose dalin jashtë përdorimit. Kryeadministratori i AAPSK ka nxjerrë disa urdhra për inventarizimin e pasurive të paluajtshme. Në lidhje me shitjen e pasurive, rezultojnë se Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar ka marrë vendimin nr. 153, datë 23.10.2024 “Për tjetërsimin e pasurive të luajtshme të konfiskuara të llojit mjete nëpërmjet shitjet në ankand publik”, sipas të cilit janë nxjerrë në ankand 16 mjete të luajtshme. Rezultojnë se nuk janë nxjerrë përgjegjësitet në lidhje me mosdorëzimin e automjeteve në ambientet magazinuese.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

8.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masa:

-në bashkëpunim me Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike për dorëzimin e objekteve të shitura;

-të hartojë të gjitha shkresat zyrtare dhe të mbajë korrespondencë me institucionet dhe subjektet, me të cilat duhet të bashkëpunohet për administrimin, menaxhimin dhe tjetërsimin e pasurive të konfiskuara, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore.

-të realizojë ndarjen e fondit të të ardhurave nga shitja e pasurive të konfiskuara, pasi t'u zbriten detyrimet.

Përgjigje e subjektit:

Për pasurinë e paluajtshme “Garazh”, me sipërfaqe 31 m² me nr. Pasurie 5./3...G4, Zona Kadastrale 2..., me vendndodhje në Linzë, Tiranë është lidhur kontrata dhe është objekti të fituesi i ankandit. Për pasurinë tokë arë”, me sipërfaqe 745 m², me nr. Pasurie 1./27, Zona Kadastrale 2..., vol. 4, faqe 8, me vendndodhje në Gjirin e Lalzit, akoma nuk është lidhur kontrata e shitjes pasi prona fituesi i ankandit ka kërkuar kthimin e shumës për shkak të problemit të pronës dhe nuk pranon të lidh kontratën. Për pasurinë me sipërfaqe 51.70 m², me nr. Pasurie 2/1...+1-1/3, Zona Kadastrale 8.. është lidhur kontrata e shitjes. Për pasurinë “Asete të Shoqërisë A...” nuk është lidhur kontrata pasi fituesin nuk paraqitet për nënshkrimin e saj.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezulton se për 2 pasuri, konkretisht për pasurinë nr. 5.../3...-G4, Zona Kadastrale 2... dhe nr. 2/1...+1-1/3, Zona Kadastrale nr. 8... janë lidhur kontratat. Ndërsa për rastet e tjera ende nuk lidhur kontratat.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

9.1 Rekomandimi: Të ndërpritet disbursimi i kështit të dytë të financimit për projektin “Rehabilitimi dhe fuqizimi i viktimave të trafikimit nëpërmjet aktiviteteve informuese, kreative, okupacionale dhe argëtuese”, pa administruar dokumentacionin justifikues për realizimin e zërave të fazës së parë, në përmbushje të detyrimeve kontraktuale.

Përgjigje e subjektit:

Nga kësti i dytë është disbursuar vetëm 500,000 lekë pasi pjesa tjetër e zërave është e kushtëzuar nga ngritja e një godine e cila është në ndërtim.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezulton se me shkresën nr. 170/1, datë 20.12.2023 Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit ka dërguar raport përmbledhës për vitin 2023, për aktivitetin dhe shpenzimet e kryera së bashku me dokumentacionin justifikues. AAPSK, pas administrimit të dokumentacionit justifikues, me shkresën nr. 496, datë 02.02.2024 ka miratuar relacionin mbi realizimin e fondit të lëvruar të projektit “Rehabilitimi dhe fuqizimi i viktimave të trafikimit nëpërmjet aktiviteteve informuese, kreative, okupacionale dhe argëtuese”, në shumën 500,000 lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar plotësisht.

10.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në çdo rast, kur gjykata nuk është shprehur në lidhje me shpenzimet e kryera, të kërkojë plotësim vendimi, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe dorëzimi i pasurive në rastet e revokimit të masës së sekuestrimit të bëhet brenda afateve në përputhje me kërkesat e akteve ligjore.

Përgjigje e subjektit:

Pranohet pjesërisht, pasi marrja e masave, kërkimi i shpenzimeve, etj., janë veprime të cilat kryhen në kuadër të administrimit dhe janë në kompetencë të vetë administratorëve të cilët bazuar në nenin 11 të ligjit 34/2019. Mjeti i vetëm procedural që kemi si organ është të

njoftojmë prokurorin për të kërkuar përcaktimin e shpenzimeve pasi nuk jemi palë në kuptimin procedural për tu legjitimuar aktivisht në bërjen e një kërkesë të tillë sipas nenit 385/a të KPP. Po ashtu plotësimi i vendimit nga palët jo vetëm që ka afat 30 ditë, por ka të bëjë me plotësimin e vendimit kur gjykata nuk është shprehur mbi gjithçka që palët kanë kërkuar në proces. Pra në kuptimin juridik, administratorët kanë detyrim të informojnë prokurorin i cili ka qenë palë në proces në lidhje me shpenzimet.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezulton se AAPSK nuk ka marrë masa për kërkimin e plotësimin e vendimit të gjykatës në rastet kur gjykata nuk është shprehur në lidhje me shpenzimet e kryera.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

11.1 Rekomandimi: Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa:

-për vlerësimin e problematikave të konstatuara nga auditimi me qëllim shmangien e riskut në mirëfunksionimin e institucionit;

-që për shkeljet e konstatuara në kontratat e qirave, të verifikohen rast pas rasti pagesat si të detyrimeve ashtu dhe të penalteteve dhe në vijim për të gjitha rastet e klasifikuara me detyrime të papaguara të kërkohej arkëtimi i vlerave, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative.

-për respektimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, me qëllim rritjen e të ardhurave të përfituara nga kontratat e qirave të pasurive të paluajtshme.

Përgjigje e subjektit: Nuk ka përgjigje nga subjekti, në lidhje me këtë rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi nuk rezulton që AAPSK të këtë marrë masa për verifikimin rast pas rasti të pagesave të qirasë, (të detyrimeve ashtu dhe të penalteteve), si dhe më pas të jetë kërkuar arkëtimi i këtyre vlerave.

Konstatohet se gjatë vitit 2024 janë miratuar kontratat tip të qirave, në të cilat nuk parashikohen më penaltete në rast të pagesë së detyrimeve me vonesë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa:

-për një analizë të faktorëve, që kanë impakt negativ në realizimin e të ardhurave dhe për një planifikim të kujdesshëm të shpenzimeve që lidhen me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;

-për shfrytëzimin dhe rritjen e të ardhurave nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara aty ku është e mundur, me qëllim administrimin me eficiencë, efikasitet dhe efektivitet të tyre.

Përgjigje e subjektit:

“Mbështetur pika 1, gërma b, c, pika 2, pika 4, gërma b dhe c, pika 5 të ligjit nr. 34/2019, ku përcaktohet të ardhurat e Agjencisë.... në asnjë pikë të ligjit apo VKM-së nuk thuhet se AAPSK është e planifikuar të dalë me fitim apo dhe me humbje. Mbështetur në aktivitetin e përditshëm nuk është normale që AAPSK të mbulojë shpenzimet e kryera me të ardhurat nga qiratë. Buxheti i shtetit mbulon shpenzimet për mbajtjen dhe funksionimin e Agjencisë si dhe për administrimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara, vetëm në rastet kur të ardhurat të siguruara nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive nuk janë të mjaftueshme. Të ardhurat e financuara në rastin tonë, janë të ardhura nga tjetërsimi i pasurive dhe janë të ardhura me vendim Komiteti që i jepen AAPSK-së për të mbuluar shpenzimet.”

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi, nuk rezulton të jenë marra masa për analizimin e faktorëve me impakt negativ

për realizimin e të ardhurave dhe për shfrytëzimin e të ardhurave nga administrimi i pasurive të sekuestruara/ të konfiskuara.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

13.1.Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masat e nevojshme me qëllim zbatimin e dy rekomandimeve që rezultojnë pjesërisht të zbatuara.

Përgjigje e subjektit:

“Pavarësisht se sistemi elektronik i regjistrimit të pasurive të sekuestruara të regjistruara nuk i përgjigjet plotësisht kërkesave të AAPSK-së, shprehemi se rekomandimi nr. 6 është i realizuar pjesërisht (pra ekziston databasë e pasurive).- për sa i përket rekomandimit nr. 7 shprehemi se është realizuar.”

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezulton se në lidhje me rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm vazhdon e njëjta situatë, pra rekomandimet 6 dhe 7, vazhdojnë të kenë statusin të zbatuar pjesërisht, konkretisht:

Në lidhje me rekomandimin 6 është konstatuar se pavarësisht së AAPSK ka ndërtuar një sistem në lidhje për regjistrimin e vendimeve dhe pronave të sekuestruara, ky sistem nuk është plotësisht funksional dhe si rrjedhojë nuk përmbush funksionin e tij me qëllim uljen e riskut të humbjes së gjurmës së auditit dhe plotësisë së të dhënave dhe mbikëqyrjen e plotë të procesit të administrimit të pasurive.

Në lidhje me rekomandimin 7 është konstatuar se pavarësisht përpjekjeve për bashkëpunim dhe intensifikim me qëllim marrjen në administrim të pasurive në një kohë sa më të shpejt, nga praktikat e përzgjedhura janë konstatuar vonesa në marrjen në administrim të pasurive të sekuestruara, konfiskuara, revokuara.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

14.1. Rekomandimi: Nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të merren masa për rishikimin e gjithë veprimeve korrigjuese me qëllim paraqitjen e saktë dhe të drejtë të vlerave të aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Përgjigje e subjektit:

“Në vitin 2020 janë mbyllur dy bilance 11 muaj MF dhe 1 muaj MB, amortizimi në të dy bilancet është llogaritur për 12 muaj duhet ndarë për 11 muaj MF dhe 1 muaj MB.”

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezulton se pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2022 janë dërguar pranë degës së thesarit me shkresën nr. 1028, datë 10.03.2023. Nga verifikimi i pasqyrës së inventarizimit dhe vlerës kontabël neto të aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar rezulton se janë aplikuar normat e amortizimit në përputhje me kërkesat ligjore si dhe janë kryer veprimet përkatëse korrigjuese.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

15.1 Rekomandimi: Nga ana e Kryeadministratorit të AAPSK-së të merren masa për kryerjen e inventarizimit vjetor fizik të pronave dhe llogarive në administrim të AAPSK-së me qëllim shmangien e humbjes apo tjetërsimit të tyre. Nga ana e komisioneve të inventarizimit të merren masa që në përfundim të procedurave të inventarizimit të përgatisin relacionin përmbledhës drejtuar Kryeadministratorit, me qëllim përcjelljen e rezultateve dhe problematikave të konstatuara.

Përgjigje e subjektit:

“Ka dalë urdhri për ngritjen e komisionit të inventarizimit të pasurive të luajtshme dhe të

paluajtshme në administrim të AAPSK-së”

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezulton se Kryeadministratori ka nxjerrë urdhrin numër 614, datë 19.10.2023 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të pasurive të paluajtshme” si dhe urdhri 627, datë 24.10.2023 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të pasurive të paluajtshme në administrim të AAPSK”. Këto urdhra janë shoqëruar me relacionet përkatëse. Për arsye se një pjesë e pasurive nuk arritën të inventarizoheshin në fund të vitit 2023, kryeadministratori ka nxjerrë urdhrin nr. 255, datë 02.05.2024 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të pasurive të sekuestruar dhe konfiskuara”, me qëllimin inventarizimin e plotë të tyre. Në vijim të këtij urdhri, kanë dalë urdhra për kontrollin fizik të pasurive sipas administratorëve. Të gjithë urdhrat janë shoqëruar me relacionet përkatëse.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

16.1 Rekomandimi: Administratorët e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara së bashku me specialistin për kontrollin fizik dhe provave materiale të kryejnë kontrole periodike në terren dhe të raportojnë tek Kryeadministratori mbi çdo problematikë të hasur. Kryeadministratori i AAPSK-së në cilësinë e titullarit të institucionit, të marrë masa për administratorët e pasurive të cilët shmangin detyrat dhe përgjegjësitë nga detyrat e tyre funksionale.

Përgjigje e subjektit:

Përgjegjës i sektorit do të hartojë programe punë mujore dhe vjetore të miratuara nga titullari për kontrole periodike në terren për pasuritë në administrim dhe të raportojë për gjetjet tek Kryeadministratori.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezulton se Kryeadministratori me shkresën nr. 543, datë 07.02.2024 ka nxjerrë planin vjetor mbi kontrollin e pasurive për vitin 2024. Nga specialistët e kontrollit janë mbajtur akt konstatime mbi kontrollin fizik të pasurive dhe provave materiale. Më pas janë hartuar relacione për kryeadministratorin për gjendjen e pasurive.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

17.1 Rekomandimi: Nga ana e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në AAPSK, të merren masa:

-për hartimin e raporteve të monitorimit, shoqëruar me relacionet shpjeguese në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016, me qëllim përmirësimin e evidentimit të përdorimit të fondeve buxhetore.

-për planifikimin dhe përgatitjen e kërkesave buxhetore në përputhje me nevojat e Institucionit.

Përgjigje e subjektit:

Monitorimi për vitin 2023 është shoqëruar me relacion. Kërkesat buxhetore hartohen në bazë të strukturës së miratuar nga KM, struktura e pa plotësuar nga DAP ka sjellë mosrealizime të fondeve të planifikuara.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezulton se raporti i monitorimit për vitin 2023 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 737, datë 28.02.2024, brenda afateve të përcaktuara në pikën 33 të Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit nga Njësitë e Qeverisjes Qendrore”. Raportimi i monitorimit është i shoqëruar me relacion.

PBA për vitin 2024-2026 është dërguar me shkresën nr. 1110/3, datë 18.04.2023 dhe rezulton të jetë e shoqëruar me relacion.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

18.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për:

-argumentimin e fondit limit duke reflektuar nevojat reale të institucionit si dhe bazuar në përcaktimet ligjore për prokurimet;

-sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimin dhe arkivimin e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike me qëllim saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit në përputhje me ligjin e arkivave.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AAPSK rezultoi se ka realizuar 14 procedura prokurimi nga të cilat 8 procedura “Blerje me vlerë të vogël” në shumën totale 2,677 mijë lekë (pa TVSH) dhe 6 procedura “Blerje nën vlerën 100,000 lekë”, në vlerën 332 mijë lekë. Ndërsa për periudhën Janar-Nëntor 2024 janë zhvilluar 6 procedura prokurimi “Blerje me vlerë të vogël” në shumën totale 3,894 mijë lekë (pa TVSH) dhe 7 procedura “Blerje nën vlerën 100,000 lekë”, në vlerën 446 mijë lekë.

Përgjigje e subjektit:

Argumentimi i fondit limit për çdo procedurë është bërë konform ligjit dhe VKM, diferencat midis llogaritjes së fondit limit dhe vlerës së kontratës fituese janë si rezultat i konkureshmërisë së subjekteve, të gjitha procedurat janë shpallur në sistemin elektronik të APP-së, dosjet e vitit 2019-2021 do të inventarizohen sipas rekomandimit tuaj.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi me përzgjedhje i dy dosjeve të prokurimit, konkretisht “Blerje materiale kancelarie” dhe “Bërje shërbimi mirëmbajtje, riparim automjetesh”, u konstatua se ishte kryer inventarizimi i tyre. Komisioni i prokurimit ka mbajtur procesverbalet mbi përlllogaritjen e fondit limit, të cilët edhe janë protokolluar. Për procedurën “Blerje materiale kancelarie”, përlllogaritja e fondit limit është bazuar në çmimet për njësi të miratuara nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara. Ndërsa për procedurën “Bërje shërbimi mirëmbajtje, riparim automjetesh” janë marrë ofertat ekonomike nga 3 operatorë, që ofrojnë këtë shërbim.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

19.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrin masa për vlerësimin e problematikave të konstatuara në lidhje me vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm me qëllim ngritjen e një sistemi funksional dhe efektiv.

Përgjigje e subjektit:

Ekziston gjurma e auditit të të gjithave proceseve për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Gjurma e auditit është miratuar me Urdhrin e brendshëm nr. 634, datë 25.06.2018 dhe është audituar njëherë nga KLSH. Nga AAPSK është miratuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut miratuar me shkresën tonë nr. 3265 prot, dat 10.11.2022.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezultoi se AAPSK nuk ka pranuar rekomandimin me arsyetimin se ekziston gjurma e auditimit e të gjithë proceseve të administrimit të pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara, të cilat janë miratuar me urdhrin nr. 634, datë 25.06.2018. Ndërsa Strategjia e Menaxhimit të Riskut është miratuar me shkresën nr. 3625, datë 10.11.2022.

Ky rekomandim rezultoi i pa pranuar.

20.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, të ngrejë një grup pune për analizimin e situatës dhe më pas të përcaktojë kriteret e qarta lidhur me shpërndarjen e zërit të shpenzimit “paga e administratorit dhe personelit ndihmës”.

Përgjigje e subjektit:

Ka dalë urdhri për ngritjen e grupit të punës për propozimin e ndryshimeve ligjore.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezultoi se, Kryeadministratori ka nxjerrë urdhrin nr. 353, datë 16.05.2023 (nr. 1531/1 prot., datë 16.05.2023) “Për ngritjen e grupit të punës të përgatitjes së projekt akteve

ligjore në përmirësim të ligjit nr. 10192/2009, i ndryshuar, 34/2019 i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre”. Grupi ka përcjellë në Ministrinë e Brendshme propozimet për ndryshime ligjore. Pas dërgimit të propozimeve, nuk rezulton të vazhdojnë procedurat për ndryshimin e ligjit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

C. Zbatimi i rekomandimeve për masa për shpërblim dëmi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

1.1 Rekomandimi: Nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 1,140,000 lekë, nga Fondacioni “Aleanca Civile për Integritet” (CATI), për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 682, datë 26.02.2021 për projektin “Rehabilitimi dhe fuqizimi social i viktimave të trafikimit përmes integritit dhe punësimit”;

-Të ndiqet në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 2,500,000 lekë, nga Fondacioni “Gjurmët” për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 679, datë 26.02.2021 për projektin “Për rehabilitimin e familjeve të efektive të rënë në detyrë”.

Përgjigje e subjektit: AAPSK në zbatim të rekomandimit të KLSH do t’i drejtohet gjykatës për padi civile ndaj fondacionit (CATI).

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi konstatohet se AAPSK me shkresën nr. 1980, datë 13.06.2023 ka ngritur kërkesë padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndaj fondacionit “Gj”, me objekt: “Detyrim kthim shume prej 2,500,000 lekë (kësti i dytë) financuar me kontratën nr. 6..., datë 26.02.2021”. Çështja është në proces gjyqësor. Ndërsa në lidhje me Fondacionin “A C I” (C)”, për sa i përket shkeljeve të konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 6..., datë 26.02.2021 për projektin “Rehabilitimi dhe fuqizimi social i viktimave të trafikimit përmes integritit dhe punësimit” nuk rezulton të kenë filluar procedurat në rrugës gjyqësore, me pretendimin se Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar në mbledhjen e datës 29.12.2021 (procesverbali nr. 53, datë 29.02.2021) ka vendosur të njohë fondin që është shpenzuar dhe të mos vijojnë dhënien e pjesës tjetër të fondit dhe të ndërpresë aktivitetet me të dy fondacionet, me atë fitues dhe të kontraktuarin prej tij.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa që të kryhet verifikimi i të gjitha rasteve ku nuk janë mbajtur shpenzimet e administrimit dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, arkëtimi i vlerës prej 7,566,958 lekë.

Nga verifikimi u konstatua se Kryeadministratori ka nxjerrë urdhrin nr. 626, datë 24.10.2023 (nr. 3491 prot., datë 24.10.2023) “Për ngritjen e grupit të punës për adresimin e përgjegjësive lidhur me konstatimet, gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe auditit i Ministrisë së Brendshme”.

Përgjigje e subjektit:

Ka dalë urdhri për adresimin e përgjegjësive lidhur me konstatimet, gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga KLSH.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezultoi se, Kryeadministratori ka nxjerrë urdhrin nr. 626, datë 24.10.2023 (nr. 3491 prot., datë 24.10.2023) “Për ngritjen e grupit të punës për adresimin e përgjegjësive lidhur

me konstatimet, gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe auditi i Ministrisë së Brendshme”.

Nga auditimi rezultoi se me shkresën nr. 3564, datë 27.10.2023 “Njoftim mbi pagesën e shpenzimeve të administrimit” është njoftuar z. A. L (A N), për likuidimin e shpenzimeve të administrimit për pasuritë e sekuestruara me vendimin nr. 25, datë 19.11.2018, në vlerën 2,061,732 lekë.

Me shkresën nr. 131, datë 09.01.2024 është njoftuar z. M. F për likuidimin e shpenzimeve të administrimit për pasuritë e sekuestruara me vendimin nr. 5, datë 16.03.2018, në vlerën 604,007 lekë.

Me shkresën nr. 132 prot, datë 09.01.2024 është bërë njoftimi subjektit L. S për kthimin e shumës 817, 089 lekë.

Referuar Urdhër Transfertes së BKT, datë 11.11.2023, rezulton se për vendimin gjyqësor nr. 3, datë 27.02.2018, kanë kaluar në bankë, shpenzimet e administrimit në vlerën 816,783 lekë. Ndërsa për vendimet gjyqësore: nr. 1, datë 09.01.2019, në vlerën 817,089 lekë; nr. 7, datë 27.04.2018, në vlerën 704,829 lekë dhe nr. 8, datë 03.05.2018, në vlerën 2,562,518 lekë, nuk rezulton të jenë marrë për arkëtimin e tyre.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

D. Mbi zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

D.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

I. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, geramat “b”, “c” dhe “ç”; bazuar në nenin 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Ministrit të Brendshëm, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojë procedurat ligjore për dhënien e masave disiplinore si vijon:

a) “Largim nga shërbimi civil”

1. Z. A. K me detyrë Kryeadministrator.

Nga auditimi rezulton se z. K nuk ushtron më detyrën e kryeadministratorit, pasi është larguar nga AAPSK.

II. Mbështetur në nenin 15 shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; në nenin 11, kreu IV dhe nenit 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Rregulloren e Brendshme të AAPSK (Masat Disiplinore), si dhe në kontratën individuale të punës, i rekomandojmë Kryeadministratorit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojë procedurat ligjore për dhënien e masave disiplinore si vijon:

a) “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”, për 5 (pesë) punonjës si më poshtë:

1. Z. A. B, me detyrë administrator i pasurive;
2. Znj. B. I, me detyrë administrator i pasurive;
3. Z. E. B, me detyrë administrator i pasurive;
4. Z. S. M, me detyrë administrator i pasurive;
5. Z. E. R, me detyrë administrator i pasurive.

Nga verifikimi u konstatua se Kryeadministratori i AAPSK ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra” për punonjësit si në vijim:

- Me shkresën nr. 1771, datë 10.05.2024 për znj. B. I;

- Me shkresën nr. 1772, datë 10.05.2024 për z. A. B;
- Me shkresën nr. 1773, datë 10.05.2024 për z. S. M;
- Me shkresën nr. 1774, datë 10.05.2024 për z. E. B;
- Me shkresën nr. 1775, datë 10.5.2024 për z. E. R.

b) “vërejtje me shkrim”, për 2 (dy) punonjës si më poshtë:

1. Znj. E. A, me detyrë administrator i pasurive;
2. Znj. E. O, me detyrë administrator i pasurive.

Nga verifikimi u konstatua se me shkresën nr. 1776, datë 10.05.2024, znj. E. S (A) i është dhënë masa disiplinore “vërejtje me shkrim”, ndërsa me shkresën nr. 1777, datë 10.05.2024, znj. E. O i është dhënë masa disiplinore “vërejtje me shkrim”.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi rezultoi se me shkresën nr. 1776, datë 10.05.2024, znj. E. S (A) i është dhënë masa disiplinore “vërejtje me shkrim”, ndërsa me shkresën nr. 1777, datë 10.05.2024, znj. E. O i është dhënë masa disiplinore “vërejtje me shkrim”.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 17/13 prot., datë 04.10.2023, është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes është lënë **1** rekomandim për përmirësim ligjor, i cili është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit **pazbatuar**.
- b. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **20** rekomandime si masa organizative, nga ku janë pranuar **19** të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **6** zbatuar plotësisht, **6** pa zbatuar, **7** zbatuar pjesërisht.
- c. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **2** rekomandime për shpërblim dëmi në shumën **11,207 mijë lekë** nga ku **2** rekomandime të pranuar, dhe **2** kanë statusin e ecurisë **zbatuar pjesërisht**.
- d. Për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, janë lënë **8** rekomandime të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit **zbatuar plotësisht**.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.

Për sa më sipër ri kërkojmë që, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar, si dhe përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025.

PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1 Rekomandimi: Kryeadministratori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, të marrin masa për të paraqitur pranë Këshillit të Ministrave propozimet për përmirësim ligjor me qëllim harmonizimin e kuadrit ligjor në fuqi në lidhje me afatet e revokimit dhe marrjes në dorëzim të provave materiale.

MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Kryeadministratori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive në lidhje me

mungesën e aksesimit të regjistrimit elektronik, si dhe të komunikojë me strukturat drejtuese të Ministrisë së Brendshme dhe AKSHI-t, me qëllim vënien në përdorim dhe përditësimin e regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

2.1 Rekomandimi: Kryeadministratori të shqyrtojë situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për problematikat e konstatuara në administrimin e pasurive. Administratorët, të marrin masa për plotësimin e deklaratës me shkrim para lidhjes së kontratës së qirasë; marrjen në administrim në afatet përkatëse; njoftimin e menjëhershëm të masës së sekuestrimit, në organet dhe subjektet ku mbahen këta regjistra; për paraqitjen në afat të pasurive të konfiskuara me vendim gjykatë të formës së prerë pranë Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar; për paraqitjen e raporteve dhe kërkesave në afatet respektive, si dhe sigurimin e pasurisë për dëmtimet nga zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë.

3.1 Rekomandimi: Kryeadministratori të shqyrtojë situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe nga ana e administratorit përkatës dhe ndihmësit të tij, të merren masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurat e sipërcituara, duke cilësuar të gjithë procesin apo veprimtarinë administrative në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor.

4.1 Rekomandimi: Kryeadministratori të shqyrtojë situatën e krijuar, duke nxjerrë përgjegjësitë, si dhe nga ana e administratorit përkatës, në lidhje me mjetet motorike, të cilat ende nuk janë marrë në administrim (dorëzim), të merren masa, për njoftimin e DPSHTRR-së si dhe për vendosjen e RBS-së.

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, administratorët përkatës, në lidhje me shoqëritë tregtare të administruara në mënyrë të drejtpërdrejtë, të merren masa që:

- Vendimmarrja për administrimin e tyre të jetë e pavarur dhe e pandikuar nga subjekti mbi të cilin rëndon masa e sekuestros apo konfiskimit;
- Regjistrimi i bilancit vjetor kontabël pranë QKB-së, të kryhet brenda afateve ligjore.

6.1 Rekomandimi: Nga ana e Kryeadministratorit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa: që punësimi i administratorëve të kryhet me një procedurë konkurrimi të hapur dhe në përputhje me të gjitha kriteret e përcaktuara për pozicionin e punës; që gjatë dhënies së masave disiplinore, të respektohet procedura administrative duke i garantuar të drejtën e subjektit për t'u informuar, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar; që administratorët dhe ndihmës administratorët, të njihen me formularin përkatës të vlerësimit të performancës dhe ky i fundit të jetë pjesë e dosjeve të personelit. Gjithashtu, të merren masa për plotësimin e përditësimin e librezave të punës, si dhe për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me punonjësit që arrijnë moshën për dalje në pension pleqërie.

7.1 Rekomandimi: Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa:

- për shitjen e pasurive të cilat dëmtohen, u bie vlera në mënyrë të ndjeshme, ose dalin jashtë përdorimit, duke respektuar parimin e mirëadministrimit, si edhe shmangien e shpërdorimit të tyre.
- për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurive të luajtshme dhe provave materiale në administrim me qëllim shmangien e humbjes apo tjetërsimit të tyre.
- dorëzimin e pasurive të luajtshme në mjediset e caktuara magazinuese.

-nxjerrjen e përgjegjësi në lidhje me mosdorëzimin e automjeteve në ambientet magazinuese.

8.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masa:

-në bashkëpunim me Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike për dorëzimin e objekteve të shitura;

-të hartojë të gjitha shkresat zyrtare dhe të mbajë korrespondencë me institucionet dhe subjektet, me të cilat duhet të bashkëpunohet për administrimin, menaxhimin dhe tjetërsimin e pasurive të konfiskuara, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore.

-të realizojë ndarjen e fondit të të ardhurave nga shitja e pasurive të konfiskuara, pasi t'u zbriten detyrimet.

10.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në çdo rast, kur gjykata nuk është shprehur në lidhje me shpenzimet e kryera, të kërkojë plotësim vendimi, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe dorëzimi i pasurive në rastet e revokimit të masës së sekuestrimit të bëhet brenda afateve në përputhje me kërkesat e akteve ligjore.

11.1 Rekomandimi: Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa:

-për vlerësimin e problematikave të konstatuara nga auditimi me qëllim shmangien e riskut në mirëfunksionimin e institucionit;

-që për shkeljet e konstatuara në kontratat e qirave, të verifikohen rast pas rasti pagesat si të detyrimeve ashtu dhe të penalteteve dhe në vijim për të gjitha rastet e klasifikuara me detyrime të papaguara të kërkohej arkëtimi i vlerave, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative.

-për respektimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, me qëllim rritjen e të ardhurave të përfituara nga kontratat e qirave të pasurive të paluajtshme.

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa:

-për një analizë të faktorëve, që kanë impakt negativ në realizimin e të ardhurave dhe për një planifikim të kujdesshëm të shpenzimeve që lidhen me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;

-për shfrytëzimin dhe rritjen e të ardhurave nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara aty ku është e mundur, me qëllim administrimin me eficiencë, efikasitet dhe efektivitet të tyre.

13.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të marrë masat e nevojshme me qëllim zbatimin e dy rekomandimeve që rezultojnë pjesërisht të zbatuara.

20.1 Rekomandimi: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, të ngrejë një grup pune për analizimin e situatës dhe më pas të përcaktojë kritere të qarta lidhur me shpërndarjen e zërit të shpenzimit “paga e administratorit dhe personelit ndihmës”.

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1 Rekomandimi: Nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara:

- Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 1,140,000 lekë, nga Fondacioni “A C I” (C)”, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 6..., datë 26.02.2021 për projektin “Rehabilitimi dhe fuqizimi social i viktimave të trafikimit përmes integritit dhe punësimit”;
- Të ndiqet në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 2,500,000 lekë, nga Fondacioni “Gj” për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës nr. 6..., datë 26.02.2021 për projektin “Për rehabilitimin e familjeve të efektive të rënë në detyrë”.

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të merren masa që të kryhet verifikimi i të gjitha rasteve ku nuk janë mbajtur shpenzimet e administrimit dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe arkëtimin e vlerës përkatëse.

3.3 DREJTORIA E TATIMPAGUESVE TË MËDHENJ

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditimin tematik në **Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj** (*këtu e në vazhdim DTM*), me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar në vitin 2023”, për auditimin e përputhshmërisë, përcjellë me shkresën nr. 14/14 prot., datë 09.10.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
Vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve;
Vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Regjistrin elektronik institucional të zbatimit të rekomandimeve.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 1325/7 prot., datë 04.11.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga grupi i audituesve i përbërë nga:

- H. S, përgjegjës i grupit të auditimit
- R. Xh, auditues

Auditimi filloi më 04.11.2024 dhe përfundoi më 13.12.2024.

II/1. OBJEKTI I AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 14/14 prot., datë 09.10.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së.

II/2. QËLLIMI I AUDITIMIT

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda

tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 të nenit 31 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II/3. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditimi i plotë i të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH për përmirësimin e gjendjes së subjekteve në të ardhmen.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III/1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti **Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj** në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 14/14 prot., datë 09.10.2023 rezultoi se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 41 rekomandime si masa organizative, nga ku janë pranuar 41 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 19 rekomandime të zbatuara, 15 zbatuar pjesërisht, 5 në proces dhe 2 të pazbatuara.
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 18 rekomandime për të ardhura të munguara nga ku 18 rekomandime të pranuar, dhe 18 kanë statusin e ecurisë zbatuar pjesërisht.
- Për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, është lënë 1 rekomandime i cili është pranuar dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit zbatuar.

Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezultoi në nivel 100%, konkretisht nga 60 rekomandime gjithsej, janë pranuar 60 rekomandime.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën 33%, niveli i rekomandimeve të pa zbatuara rezultoi 3%, niveli i rekomandimeve zbatuara pjesërisht rezultoi 55% dhe niveli i rekomandimeve në proces zbatimi rezultoi 8%.

III/2. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në **DTM** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*” për periudhën 01.01.2022 deri në 31.12.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së, përcjellë me shkresën nr. 14/14 prot., datë 09.10.2023, rezultoi si më poshtë vijon:

A. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresën nr. 52/34 prot., datë 31.10.2023, “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DTM njoftuar me shkresën Nr.14/14 prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DTM me nr.52/29 prot., datë 11.10.2023”, drejtuar KLSH është nisur plani i masave në vijim të zbatimit të rekomandimeve, ***brenda afatit ligjor, prej 20 ditësh të vendosur nga KLSH***, veprim ky në përputhje me kërkesat e nenit 15, shkronja “j” të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, ku përcaktohet se: “*Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*”.

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresën Nr.52/64 prot., datë 07.05.2024, “Raportim lidhur me zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DTM njoftuar me shkresën Nr.14/14 prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DTM me Nr.52/29 prot., datë 11.10.2023”, drejtuar KLSH është nisur raportimi lidhur me ecurinë mbi zbatimin e rekomandimeve, ***brenda 6-muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna***, veprim ky në përputhje me kërkesat e nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, ku përcaktohet se: “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”.

B. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së në mënyrë më të detajuar rezulton si më poshtë:

1.1 Rekomandimi: Drejtori i DTM të analizojë faktorët të cilat kanë ndikuar në realizimin e planit të të ardhurave tatimore sipas zërave, veçanërisht për llojet e të ardhurave që rezultojnë me mos realizim referuar subjekteve që operojnë nën juridiksionin e DTM, duke nxjerrë edhe përgjegjësitë përkatëse në funksion të arritjes së objektivave institucional.

Komenti i subjektit:

Në zbatim të Urdhrit të Brendshëm nr.5, datë 09.11.2023 “Mbi raportimin e performancave mujore dhe progresive për çdo drejtori të DTM, sektorët kanë dërguar informacion në rrugë shkresore dhe via e-mail.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se me anë të Urdhrit nr.5, datë 09.11.2023, është urdhëruar dorëzimi i performancave mujore dhe progresive nga çdo drejtori deri në datën 30 të muajit pasardhës. Gjithashtu bashkëlidhur urdhrin janë vendosur formati narrativ i analizës mujore dhe formati plan/fakt. Nëpërmjet emailit është dërguar si dokumentacion justifikues i zbatimit të rekomandimit nr.1.1, “Analiza e të ardhurave tatimore për muajin shkurt 2024 dhe progresive 2 mujor”.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

2.1 Rekomandimi: Drejtori i DTM të marrë masat për përcaktimin e procedurave, detyrave dhe përgjegjësive konkrete, në drejtim të programimit dhe raportimit pranë DPT lidhur me progresin e bërë kundrejt planit të të ardhurave tatimore dhe shmangiet nga programi i miratuar, duke konsideruar edhe formate tip raportimi, me qëllim që ndjekja dhe realizimi i të ardhurave për çdo zë të bëhet më efektiv dhe eficient, duke garantuar planifikimin në funksion të një shpërndarje sa më të drejtë dhe reale të planit të të ardhurave sipas llojit dhe strukturës, me qëllim shmangien e rishikimeve të shpeshta të këtij plani përgjatë vitit.

Komenti i Subjektit:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së dhe shkresës së DPT-së nr.17094 prot., datë 27.10.2023, protokolluar në DTM me nr.9600 prot., datë 30.10.2023, është kryer raportimi periodik i të ardhurave në Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Statistikës në DPT si dhe rakordimi me Degën e Thesarit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se me anë të Urdhrit nr.5, datë 09.11.2023, është urdhëruar dorëzimi i performancave mujore dhe progresive nga çdo drejtori deri në datën 30 të muajit pasardhës. Gjithashtu bashkëlidhur urdhrin

janë vendosur formati narrativ i analizës mujore dhe formati plan/fakt. Nëpërmjet emailit është dërguar si dokumentacion justifikues i zbatimit të rekomandimit nr.1.1, “Analiza e të ardhurave tatimore për muajin shkurt 2024 dhe progresive 2 mujor”.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

2.2 Rekomandimi: Strukturat drejtuese pranë DTM të marrin masat për hartimin e planit operacional të veprimtarisë institucionale, planeve vjetore, dhe raporteve periodike, në funksion të mirë menaxhimit dhe monitorimit të institucionit për arritjen e objektivave.

Qëndrimi i Subjektit:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së dhe shkresës së DPT-së nr. 17094 prot., datë 27.10.2023, protokolluar në DTM me nr. 9600 prot., datë 30.10.2023, është kryer raportimi periodik i të ardhurave me shkrim realizimi i të ardhurave sipas klasave shtatë shifrore.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga ana e DTM nuk janë vendosur në dispozicion si dokumentacion justifikues plani operacional i veprimtarisë institucionale, planeve vjetore, dhe raporteve periodike, për të vërtetuar zbatimin e rekomandimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

3.1 Rekomandimi: Drejtori i DTM nëpërmjet Sektorit të Analizës së Riskut pranë DTM dhe Drejtorisë së Kontrollit pranë DTM, të vlerësojë procedurat aktuale të implementuara për efekt të vendimmarrjes në propozimin e subjekteve që do i nënshtrohen kontrollit në vend, duke shqyrtuar mundësinë e hartimit të një databazë të Sektorit të Analizës së Riskut për konsolidimin e propozimeve për kontroll në vend të përcjella nga Sektori i Zyrës apo atij në Vend sipas problematikave përkatëse, në mënyrë që të garantohet se konkluzionet për përzgjedhjen e subjekteve të DTM objekt kontrolli në vend, do të jenë produkt i prioritizimit të problematikave dhe analizave të përcjella nga njësitë e sipërcituara, duke shmangur duplikimin e detyrave nëpërmjet sektorëve.

Komenti i Subjektit:

Është krijuar databazë për vitin 2024, me të dhenat krahasuese për çdo subjekt. Databaza përbëhet nga të dhënat e viteve 2022/2023/2024 në vazhdim, për çdo muaj, të cilat gjenerohen nga sistemi C@ts, si dhe të dhëna të bashkëlidhura, sjellë nga Drejtoria e Kontrollit në DTM dhe problematika/indicie ardhur nga institucione të tjera, të cilat hasen në përditshmëri. Databaza përmirësohet, plotësohet dhe pasurohet vazhdimisht me të dhëna të reja.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi është konstatuar se databazës i janë shtuar të dhëna në lidhje me problematikat dhe indiciet që vijnë nga Sektori i Kontrollit në Vend si dhe në vijim propozimet për kontrole në DPT kryhen nga Sektori i Riskut në DTM, i cili mbasi konsolidon të dhënat i dërgon për miratim, duke shmangur duplikimin e punës me sektorët e tjerë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

3.2 Rekomandimi: Drejtori i DTM të marrë masat për përcjelljen e Rregullores së Brendshme për Sektorin e Analizës së Riskut pranë institucioneve eprore me qëllim miratimin e këtij dokumenti nga autoriteti përgjegjës për miratimin e rregulloreve që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit.

Qëndrimi i Subjektit:

Është miratuar Rregullorja për Sektorin e Analizës së Riskut pranë DTM, e cila është pjesë e Rregullores së Brendshme të DTM. Bashkëngjitur është vendosur në dispozicion Rregullorja e Funksionimit të DRT, miratuar me Urdhrin Nr.192., datë 12.08.2020 nga Ministri i Financave.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se rekomandimi i lënë nuk i referohet Rregullores së Funkcionimit të DRT, miratuar me Urdhrin Nr.192., datë 12.08.2020, por lidhet me aktin e miratimit të Rregullores së Brendshme për Sektorin e Analizës së Riskut miratuar me shkresën nr. 568/1, prot datë 25.01.2021 të miratuar nga ish Drejtori i DTM.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

4.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DTM dhe DPT të marrin masat për garantimin e mbulimit me kontroll në vend të propozimeve nga DTM në masën 50% të total kontrolleve të kryera, duke prioritarizuar në përzgjedhje të subjekteve që mbartin realisht risk, dokumentuar kjo në rezultatet e indikatorëve të implementuar në regjistrin e riskut të strukturës përgjegjëse.

Komenti i Subjektit:

Vijon procesi i mbulimit me kontrolle në vend të propozimeve nga DTM në masën 50% të totalit kontrolleve të kryera, bazuar kjo në orët e punës dhe jo në numër subjektesh.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga shqyrtimi i shkresave për propozime për kontroll të thelluar, konkretisht: Nr. 836 Prot., datë 22.10.2024 dhe Nr. 7639 Prot., datë 23.09.2024 drejtuar DPT është konstatuar se është kryer mbulimi i propozimeve për kontroll në masën 50% të orëve në dispozicion sipas inspektorëve sipas analizës së kriterëve të riskut të thyera.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

5.1 Rekomandimi: Nga ana e DTM në hartimin e programeve të kontrollit në tatimpagues që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e tregtisë të përcaktohet një metodologji e qartë e kontrollit duke shmangur mesatarizimet në analizën e marzheve në mënyrë që të arrihet siguria për deklarimin e saktë të detyrimeve tatimore ku për sektorë të veçantë si ai i tregtimit të energjisë elektrike dhe tregtimit të gazit natyror të përcaktohen specifika për kryerjen e kontrollit të krahasimit çmimesh të aplikuara dhe krahasimit me koston e mallit të shitur.

Komenti i Subjektit:

DTM në vijim të zbatimit të rekomandimit 5.1 të lënë nga KLSH, ka hartuar programet e kontrollit tatimor bazuar në templatën e Manualit të Kontrollit Tatimor, të miratuar, i cili në përmbajtjen e vet e përfshin edhe çështjen e ngritur në rekomandim për të shmangur mesatarizimet në analizën e marzheve, konkretisht pika e programit: “Përcaktimi i koston të blerjes dhe koston të plotë për çdo artikull dhe krahasimi me çmimet e shitjes të deklaruar nga subjekti, bërja e bilancit material të lëvizjes së mallit në sasi e në vlerë (për subjekte që kanë shumë artikuj, pas propozimit nga grupi kontrollit me miratimin e propozimit reduktio inventarin në artikuj kryesore që zënë peshën specifike më të madhe në shitje)”. Gjithashtu ju sqarohet se në lidhje me subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tregtisë në sektorin e energjisë po ju vendosim në dispozicion Vendimin e KSHAT Nr.149, datë 10.11.2021 në të cilën është përcaktuar metodologjia e krahasimit të çmimit mesatar të ponderuar të blerjes në një muaj me çmimet specifike të shitjes së atij muaj, në kushtet kur është i pamundur shoqërimi i blerje me një shitje për shkak të natyrës specifike të energjisë, ky model vlerësimi është marrë për bazë në vijim për t’u aplikuar nga DTM në rastet e kontrollit në subjekte që kryejnë tregtinë e energjisë elektrike.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, konkretisht i programeve të kontrollit të hartuara nga DTM si dhe Manualit të Kontrollit Tatimor, konstatohet se rekomandimi është zbatuar.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

5.2 Rekomandimi: Në rastin e subjekteve që së bashku me tregtimin e produkteve ofrojnë për përdorim aktive në mënyrë që të realizojnë shitjet, të implementohet në program kontrolli analiza mbi çmimet e diferencuara të shitjes me qëllim saktësimin e aplikimit ose jo të TVSH-së.

Komenti i Subjektit:

DTM në vijim të zbatimit të rekomandimit 5.2 të lënë nga KLSH, ka hartuar programet e kontrollit tatimor bazuar në templatën e Manualit të Kontrollit Tatimor, të miratuar, i cili në përmbajtjen e vet e përfshin edhe çështjen e ngritur në rekomandim për rastin e subjekteve që së bashku me tregtimin e produkteve ofrojnë për përdorim aktive në mënyrë që të realizojnë shitjet, të implementohet në program kontrolli analiza mbi çmimet e diferencuara të shitjes me qëllim saktësimin e aplikimit ose jo të TVSH-së, konkretisht pika e programit: *“Të verifikohet TVSH-ja e zbritëshme për çdo rast sipas kërkesave të ligjit dhe udhëzimit për TVSH-në. Verifikim lidhur me parimin e destinacionit dhe kreditimit të TVSH-se duke e lidhur me kërkesat ligjore për rimbursim”*.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, konkretisht i programeve të kontrollit të hartuara nga DTM si dhe Manualit të Kontrollit Tatimor, konstatohet se rekomandimi është zbatuar.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

6.1 Rekomandimi: DTM në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojnë një metodologji të qartë dhe të saktë nënligjore, ose një manual udhëzues për analizimin e llogarisë së ortakut, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.

Komenti i Subjektit:

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresën Nr. 52/34 Prot., datë 31.10.2023 “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DTM njoftuar me shkresën Nr.14/14 Prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DTM me nr.52/29 Prot., datë 11.10.2023”, ka vendosur në dijeni Drejtorin Juridike në DPT, lidhur me këtë problematikë nëpërmjet këtij plani masash. Gjithashtu janë mbajtur disa takime në DPT në lidhje me trajtimin e këtij rekomandimi së bashku edhe me DRT Tiranë për të njëjtën problematikë të lënë nga auditimi i KLSH. Bashkëngjitur po ju vendosim në dispozicion emailin dhe memon e dërguar nga Drejtori i DRT Tiranë drejtuar Drejtorisë Juridike në DPT, në lidhje me rekomandimin e KLSH për analizimin e llogarisë së ortakut, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se DTM ka informuar DPT në lidhje me rekomandimin nr.6.1 të KLSH për të cilat janë kryer disa mbledhje për hartimin e një metodologji të qartë dhe të saktë nënligjore ose një manual udhëzues për analizimin e llogarisë së ortakut, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil, e cila deri në përfundim të periudhës së auditimit në terren nuk është finalizuar.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe në proces zbatimi.

6.2. Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me DPT, të analizojë situatën e kontrollit të kryer në subjektet “A” SH.A, “I” SHPK, “A” SHPK, “K P T D” SHPK, “A” SHPK, “F” SHPK dhe “B E” SHPK, referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH-së, si dhe të vlerësojë përcjelljen e tyre pranë strukturës kompetente pranë Drejtorisë së

Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, për vlerësimin dhe identifikimin e mëtejshëm të burimeve të financimit.

Komenti i Subjektit:

Në lidhje me zbatimin e rekomandimit 6.2 nga ana e DTM janë nxjerrë autorizimet për verifikim në vend, konkretisht:

- Është nxjerrë autorizimi për verifikim në vend për subjektin “F” SHPK me nr.52/41 datë 13.12.2023, verifikimi ka përfunduar sipas raportit me nr.2153 datë 25.03.2024.
- Është nxjerrë autorizimi për verifikim në vend të tatimpaguesve “A” SHPK me nr.52/40 datë 12.12.2023, verifikimi ka përfunduar sipas raportit me nr.2602. datë 11.04.2024.
- Është nxjerrë autorizimi për verifikim në vend të tatimpaguesve “A” SHPK me nr.52/59 datë 13.12.2023, verifikimi ka përfunduar sipas raportit me nr.1247 datë 15.02.2024.

Rekomandimi 6.2, i KLSH është trajtuar në procedurën e rikontrollit tatimor, konkretisht për tatimpaguesit:

- Për tatimpaguesin “I” SHPK, referuar rekomandimit të KLSH me shkresën nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/53 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.9 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.84/1 datë 14.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikontrollit i cili është evaduar me shkresën nr.84/9 datë 28.06.2024.

- Për tatimpaguesin “K P T D” SHPK, Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresë nr.14/14 datë 9.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/45 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.1 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresë nr.94/1 datë 14.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikontrollit i cili është evaduar me shkresën nr.94/10 datë 13.06.2024.

- Subjekti “B E” SHPK është transferuar në DRT Tiranë, ky rekomandim është përcjellë pranë kësaj drejtorie me shkresën nr.52/52 datë 13.12.2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga shqyrtimi i autorizimeve për verifikim në vend dhe rikontrolleve është konstatuar analiza e situatës së subjekteve të lëna në rekomandim nga KLSH, por nuk është kryer përcjellja e tyre pranë strukturës kompetente të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, për vlerësimin dhe identifikimin e mëtejshëm të burimeve të financimit. Për rastin e tatimpaguesit “B E” SHPK, i cili është transferuar pranë DRT Tiranë, fakt ky i verifikuar edhe nga sistemi C@ts, në këto kushte DTM nuk e ka më në juridiksionin e saj dhe nuk ka më kompetencë për të kryer verifikime ose rikontrolle ndaj tij.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

7.1 Rekomandimi: Nga ana e DTM në subjektet që përfshijnë procese prodhimi dhe përpunimi të cilat janë objekt miratimit të kartës teknologjike, të kryhet verifikimi i miratimit të gjitha kartave teknologjike në rast se janë dorëzuar pranë organit tatimor. Nga ana e DTM, të përcaktohet kampioni i përzgjedhur për auditim pas miratimit nga strukturat drejtuese si aneks i programit të kontrollit tatimor përpara fillimit të tij, në mënyrë që të jetë përfaqësues.

Komenti i Subjektit:

Sektori i kontrollit nga zyra dhe monitorimit kreu edhe njëherë verifikimin e tatimpaguesve të cilët kanë detyrimin ligjor për të dorëzuar kartat teknologjike. Sektori i kontrollit nga zyra dërgoi zyrtarisht listën e tatimpaguesve që kanë dorëzuar kartat teknologjike Sektorit të Riskut në DTM dhe Sektorëve të Kontrollit në Vend me shkresën nr.52/39 Prot., datë 12.12.2023. Në lidhje me pjesën e rekomandimit ku nga ana e DTM, të përcaktohet kampioni i përzgjedhur për auditim pas miratimit nga strukturat drejtuese si aneks i programit të kontrollit tatimor përpara

fillimit të tij, në mënyrë që të jetë përfaqësues, gjykojmë se kjo pjesë e rekomandimit është zbatuar me hartimin e programeve të kontrollit sipas templatit të Manualit të Kontrollit Tatimor të miratuar, konkretisht sipas pikës ku përcaktohet se *“Përcaktimi i kostos së blerjes dhe kostos së plotë për çdo artikull dhe krahasimi me çmimet e shitjes të deklaruar nga subjekti, bërja e bilançit material të lëvizjes së mallit në sasi e në vlerë (për subjekte që kanë shumë artikuj, pas propozimit nga grupi kontrollit me miratimin e propozimit reduktio inventarin në artikuj kryesore që zenë peshen specifike më të madhe në shitje).*

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga shqyrtimi i shkresës nr.52/39 Prot., datë 12.12.2023, rezulton se është verifikuar lista e tatimpaguesve të cilët kanë detyrimin ligjor për të dorëzuar kartat teknologjike si dhe është dërguar zyrtarisht sektorit të riskut në DTM dhe sektorit të kontrollit në vend, për të pasur dijeni rast pas rasti për t’u analizuar nga çdo inspektor i kontrollit operacional në raportet që mbahen për tatimpaguesit e prodhimit dhe përpunimit ose inspektorët e riskut në analizat e tyre. Si dhe gjithashtu nga shqyrtimi i programeve të kontrollit të hartuara nga DTM si dhe Manualit të Kontrollit Tatimor, konstatohet se rekomandimi është zbatuar.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, të kryejë të gjitha veprimet e duhura ligjore dhe administrative, me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore të ri llogarituara për subjektin “B & C” SHPK me NIPT: K....., në shumën 50,000 lekë.

Komenti i Subjektit:

Në bazë të Akt Konstatimit nr.5, datë 30.06.2023 të lënë nga KLSH, DTM ka marrë masa për të verifikuar situatën financiare të tatimpaguesit “B & C” SHPK sipas sistemit C@ts, për librin e blerjes dhe FDP për periudhën nëntor 2021, ku rezulton se në datën 06.07.2023, subjekti ka vet korrigjuar situatën në bazë të nenit 67 të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të cilën DTM ka mbajtur akt konstatim duke gjykuar që subjekti nuk mund të penalizohet sepse ka kryer vetrregullimin bazuar në dispozitatat ligjore të cituara më sipër.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i situatës financiare të tatimpaguesit “B & C” SHPK sipas sistemit C@ts, rezulton se është kryer ndryshimi në FDP dhe librin e blerjes.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet Sektorit të Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave dhe Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, të marrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative, me qëllim hartimin e një qarkoreje dhe metodologjie të mirë përcaktuar, për standardizimin e procedurave të kontroleve tatimore të rimbursimit të TVSH-së për kontrollin e tatimpaguesve me aktivitet përpunimin dhe tregtimi i naftës dhe nënprodukteve të saj, duke përcaktuar qartësisht periudhat për kontrollin e bilancit material.

Komenti i Subjektit:

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresën Nr.52/34 Prot., datë 31.10.2023, “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DTM njoftuar me shkresën Nr.14/14 Prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DTM me nr.52/29 Prot., datë 11.10.2023”, ka vendosur në dijeni Drejtorin Juridike në DPT, lidhur me këtë problematikë nëpërmjet këtij plani masash.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga shqyrtimi i shkresës së DTM Nr.52/34 Prot., datë 31.10.2023, “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DTM njoftuar me shkresën Nr.14/14 Prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DTM me nr.52/29 Prot., datë 11.10.2023”, konstatohet

se është vendosur në dijëni DPT, në lidhje me problematikën e konstatuar dhe rekomandimin e lënë nga KLSH, por deri në momentin e verifikimit rezultoi se nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative nga ana e DPT-së, me qëllim hartimin e një qarkoreje dhe metodologjie të mirë përcaktuar, për standardizimin e procedurave të kontrolleve tatimore të rimbursimit të TVSH-së për kontrollin e tatimpaguesve me aktivitet përpunimin dhe tregtimi i naftës dhe nënprodukteve të saj, duke përcaktuar qartësisht periudhat për kontrollin e bilancit material.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesit “F” SHA dhe “A” SHA, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në analizimin e të dhënave të paraqitura në Raport Kontrolli, të kryejë një analizë të thelluar nga zyra ose të propozojë kryerjen e kontrolleve të thelluara/vizitave fiskale, për vlerësimin e situatës financiare.

Komenti i Subjektit:

Në lidhje me zbatimin e rekomandimit 10.1 nga ana e DTM janë nxjerrë autorizimet për verifikim në vend, konkretisht:

- Është nxjerrë autorizimi për verifikim në vend për subjektin “F” SHPK me nr.52/36 datë 12.12.2023, verifikimi ka përfunduar sipas raportit me nr.52/61 datë 12.01.2024.
- Është nxjerrë autorizimi për verifikim në vend për subjektin “A” SHPK me nr.52/37 datë 12.12.2023, verifikimi ka përfunduar sipas raportit me nr.2076 datë 20.03.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se në zbatim të rekomandimit 10.1, janë kryer verifikimet në terren për tatimpaguesit “F” SH.A dhe “A” SH.A, ku rezultoi se janë trajtuar mangësitë dhe parregullsitë në analizimin e të dhënave sipas rekomandimit të KLSH.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, për tatimpaguesit “A” SHA, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në analizimin e të dhënave të paraqitura në Raport Kontrolli, të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, të kryerje një analizë të thelluar nga zyra të situatës financiare të tatimpaguesit duke bërë vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse ose të propozojë kryerjen e kontrolleve të thelluara në vend/vizitave fiskale, në rastin e vlerësimit me risk të lartë të mos pasqyrimin të saktë të situatës financiare dhe mos llogaritjen e detyrimeve tatimore me efekt mungesën e të ardhurave për buxhetin e shtetit.

Komenti i Subjektit:

Shoqëria “A” SH.A është transferuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, ky rekomandim është përcjellë pranë kësaj drejtorie me shkresën nr.52/52 prot., datë 13.12.2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi sipas sistemit C@ts rezultoi se shoqëria “A” SH.A është transferuar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe nga ana e DTM me shkresën nr.52/52 prot., datë 13.12.2023 është njoftuar për rekomandimin e lënë nga KLSH, dhe në kushtet kur DTM nuk e ka më në juridiksionin e saj, nuk ka më kompetencë për të kryer analiza dhe rivlerësime për të.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për artikullin “Naftë Bruto” me origjinë nga “Prodhimi Vendas Shqipëri” sipas kushtit të lëvrimit FOB, bazuar në faktet dhe provat e trajtuara dhe të paraqitura sa më sipër si dhe në materialin e Raportit të Auditimit të gjykojë dhe të kërkojë ndjekjen e procedurave për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pagesës së rentës minerare të

konstatuar si diferenca pagese në shitje malli në procedura eksporti në shumën 131,528,466 lekë, dhe bazuar në çmimet e publikuara të bursës Platts të kërkohet pagesa e detyrimeve të tjera tatimore, për vlerën e mallit të shitur të rivlerësuar të ri trajtuar sipas çmimit të bursës brend të rivlerësuar në procedure eksporti në shumën 1,315,284,657 lekë për të cilat nga DTM duhet të llogariten edhe detyrimet e tatimit mbi të ardhurat e rivlerësuar nga shitja duke marrë konsideratë llojin e aktivitetit, në përmbushje të përcaktimeve të ligjit Hidrokarbur në Republikën e Shqipërisë, neni 5 dhe 6 i Ligjit nr.153/2020 “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur renta minerare” dhe në përcaktimet e legjislacionit tatimor në R.SH.

Qëndrimi i Subjektit:

Është përcjellë me shkresën nr.1681 datë 04.03.2024 në cilësinë e agjentes për mbledhjen e taksës së rentës e cila llogaritet si % e shitjeve sipas rekomandimit nr.12.1 të KLSH. Në varësi të përgjigjes nga DPD do të reflektohet ose jo në rritjen e të ardhurave tatimore për këtë periudhë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se DTM me anë të shkresës zyrtare nr.1681 prot., datë 04.08.2024 i është drejtuar DPD, për dijeni edhe DPT, në të cilën është adresuar rekomandimi nr.12.1 i KLSH për subjektin “B P A” LTD në lidhje me eksportin e produktit “Naftë bruto” me origjinë nga “Prodhimi Vendas Shqipëri” sipas kushtit të lëvrimit FOB, ku kërkohet informacion mbi çmimet e publikuara të bursës Platts, me qëllim që kryerjen e rivlerësimeve përkatëse, por deri në momentin e verifikimit nuk ka një informacion të dërguar nga ana e DPD në lidhjet me çmimet e bursës për produktin naftë bruto.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces zbatimi.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj nisur nga situata e mbartur në lidhje me këtë problematikë të diskutuar edhe më parë në çështje gjyqësore siç pretendohet nga observimi i bërë nga nëpunësit e autorizuar për problematikën e investimeve dhe lejes së situacioneve dhe kriterëve të investimeve të bëra brenda zonës operuese të kërkim/prodhimit në zonën Patos-Marinëz bazuar në faktet dhe provat e trajtuara dhe të paraqitura sa më sipër si dhe në materialin e Raportit të Auditimit të gjykojë dhe të kërkojë ndjekjen e procedurave tatimore bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi me qëllim analizimin e vlerës së TVSH-së së kredituar në tepicë dhe të pa trajtuar në procedura blerje situacione për punime brenda zonës së kërkim-prodhimit për punime në:

- Shumën 2,499,219 lekë për mallra e shërbime me vlerë TVSH-je të cilat duhet të ishin trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar bazuar në pikën 2 të Udhëzimit të Përbashkët i MF dhe ME nr.17, datë 12.6.2015.

- Në shumën 412,068,235 leke vlerë totali blerje jashtë kriterëve ligjore për të cilat nga DTM duhet të trajtohen edhe detyrimet përkatëse tatimore për vlerën e TVSH-së së kredituar në blerje në shumën 82,413,646 lekë, e cila nuk duhet të ishte trajtuar si shërbim me TVSH të kredituar por duhej trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar.

- Në shumën 69,894,293 lekë për të cilat nuk është trajtuar si shërbim me TVSH-të pagueshme por është trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar për blerje shërbimi nga shoqëri të huaja dhe vendase për shërbime dhe mallra me TVSH të përjashtuar për mallra dhe shërbime jashtë kriterëve ligjore për të cilat duhet të trajtohen edhe detyrimet përkatëse tatimore për transaksione dhe vlerë punime në shumën 69,894,293 lekë, për të cilat nuk është trajtuar si shërbim me TVSH-të pagueshme por është trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar.

Komenti i Subjektit:

Në raport kontrolllet e ushtruara në shoqërinë “B P” LTD janë kontrolluar për kriteret e kreditimit të TVSH-së, lidhur me faturat tatimore si dhe është lënë shënim në çdo raport kontrolli që pas qëndrimit zyrtar të AKBN i cili përcakton në mënyrë të saktë ndarjen e blerjeve

për kërkim apo prodhim do të reflektohen nga administrata tatimore. Në shkresa nga DTM i është kërkuar AKBN-së raportet e auditit të lidhur me këtë shoqëri. Lidhur me këtë rekomandim DTM do të ri përsëriti kërkesën ndaj AKBN për qëndrimin zyrtar për këtë periudhë referuar rekomandimit të KLSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se DTM ka iniciuar procedurën për përcaktimin e saktë nga AKBN për ndarjen e blerjeve për kërkim apo prodhim objekt kreditimi të TVSH-së, proces ky që deri në përfundim të periudhës së auditimit në terren nuk është finalizuar, pasi nuk ka përgjigje zyrtare nga ana e AKBN-së.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces zbatimi.

14.1 Rekomandimi: DTM në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për parapagimet nga shitja e njësive ndërtimore me certifikatë shfrytëzimi por pa kalim titulli pronësie, të hartojnë një metodologji të qartë ose një manual udhëzues për njohjen e të ardhurave duke analizuar rrethanat e transaksionit dhe vlerësimi nëse një njësi ekonomike ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi.

Komenti i Subjektit:

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresën Nr.52/34 Prot., datë 31.10.2023, “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DTM njoftuar me shkresën Nr.14/14 Prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DTM me Nr.52/29 Prot., datë 11.10.2023”, ka vendosur në dijëni në DPT, lidhur me këtë problematikë nëpërmjet këtij plani masash.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit rezulton se DTM ka vendosur në dijëni DPT në lidhje me rekomandimin nr.14.1, por deri në momentin e verifikimit nga grupi i auditimit rezulton se ende nuk përfunduar hartimi i metodologjisë ose manualit udhëzues për njohjen e të ardhurave për parapagimet nga shitja e njësive ndërtimore me certifikatë shfrytëzimi por pa kalim titulli pronësie, duke analizuar rrethanat e transaksionit dhe vlerësimi nëse një njësi ekonomike ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

15.1 Rekomandimi: DTM të analizojë dhe vlerësojë situatën financiare të tatimpaguesit “F” SHPK, në lidhje me zbatimin e koeficientit të rregullimit të TVSH jo në baza vjetore, për “Blerjet e tatueshme me 20% TVSH nga furnitorë vendas”, “Importet e investimeve me shkallë 20%” dhe “Investimet nga furnitorë vendas me shkallë 20%”, për vitin 2020, në total në vlerën e tatueshme 632,864,089 lekë dhe me 126,571,910 lekë TVSH, të cilat janë blerje të furniturave, investimeve në mjete pune dhe ndërtim godinash për nevoja të biznesit, të cilat janë vështirë të ndashme masa e të cilave ka kontribuar dhe është përdorur për si për kryerjen e transaksioneve të tatueshme që sjellin të drejtën e zbritjes së TVSH-së mbi bazën e neneve 69 dhe 70, të këtij ligji, edhe për transaksionet që nuk e sjellin këtë të drejtë.

Komenti i Subjektit:

Nga ana e DTM është nxjerrë urdhër verifikimi në vend nr.52/38 prot., datë 12.12.2023, për saktësimin e situatës referuar rekomandimit të KLSH-së, për tatimpaguesin “F” Shpk, për të cilin është mbajtur akt-verifikimi në vend me nr.4002 prot., datë 15.05.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se DTM ka nxjerrë autorizimin nr.52/38 prot., datë 12.12.2023, për verifikim në vend të tatimpaguesit “F” Shpk, sipas rekomandimit të lëna nga KLSH për analizimin dhe vlerësimin e zbatimit të koeficientit të rregullimit të TVSH jo në baza vjetore, për “Blerjet e tatueshme me 20% TVSH nga furnitorë vendas”, “Importet e investimeve me shkallë 20%” dhe “Investimet nga furnitorë

vendas me shkallë 20%”, për vitin 2020, për të cilin është hartuar akt verifikimi në vend me nr.4002 prot., datë 15.05.2024.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

15.2 Rekomandimi: DTM nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare informacion dhe dokumentacion justifikues nga tatimpaguesi “F” SHPK, për furnizimet në vlera të larta me karburant si dhe për shfrytëzimin e mjeteve të transportit dhe autovegurave, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së kreditimit të TVSH-së, së karburantit konform përcaktimeve të legjislacionit fiskal në fuqi.

Komenti i Subjektit:

Nga ana e DTM është nxjerrë urdhër verifikimi në vend nr.52/38 prot., datë 12.12.2023, për saktësimin e situatës referuar rekomandimit të KLSH-së, për tatimpaguesin “F” Shpk, për të cilin është mbajtur akt-verifikimi në vend me nr.4002 prot., datë 15.05.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se DTM ka nxjerrë autorizimin nr.52/38 prot., datë 12.12.2023, për verifikim në vend të tatimpaguesit “F” Shpk, sipas rekomandimit të lëna nga KLSH për analizimin dhe vlerësimin e kreditimit të TVSH-së për furnizimet me karburant si dhe për shfrytëzimin e mjeteve të transportit dhe autovegurave, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh, për të cilin është hartuar akt verifikimi në vend me nr.4002 prot., datë 15.05.2024.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

15.3 Rekomandimi: DTM nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të kryejë verifikimin e miratimit të kartës teknologjike të tatimpaguesit “F” SHPK, për prodhimin e binderit dhe asfaltobetonit.

Komenti i Subjektit:

Nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra i është kërkuar tatimpaguesit karta teknologjike me shkresën Nr.8032 Prot., datë 06.09.2023, Nr.8032/2 Prot, datë 27.09.2023 dhe Nr.8032/4 Prot., datë 12.10.2023, nga ku përgjigja tatimpaguesi ka depozituar kartën teknologjike miratuar nga Instituti i Ndërtimit e depozituar në dosjen e tatimpaguesit arshivuar me shkresën Nr.8032/6 Prot., datë 23.10.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se tatimpaguesi “F” Shpk ka depozituar në DTM kartën teknologjike për prodhimin e binderit dhe asfaltobetonit e cila rezulton e miratuar nga Instituti i Ndërtimit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

16.1 Rekomandimi: DTM nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare informacion dhe dokumentacion justifikues nga tatimpaguesi “Gj K” SHA, për diferencat e pajustificuara të konstatuara midis bilancit të lëvizjes materiale dhe akt konstatimit të inxhinierit, me qëllim vlerësimin e mëtejshëm të tyre

Komenti i Subjektit:

Nga ana e DTM është nxjerrë urdhër verifikimi në vend për saktësimin e situatës referuar rekomandimit të KLSH-së me nr.52/29 prot., datë 11.10.2023 si dhe autorizim për inxhinier nr.52/62 prot., datë 07.03.2024 ku është mbajtur akt verifikimi në vend me nr.52/63 prot., datë 26.04.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se DTM ka nxjerrë autorizimin nr.52/29 prot., datë 11.10.2023 si dhe autorizim për inxhinier nr.52/62 prot., datë 07.03.2024, për verifikim në vend të tatimpaguesit “Gj” Shpk, sipas rekomandimit

të lëna nga KLSH për analizimin dhe vlerësimin e diferencave të pajustificuara të konstatuara midis bilancit të lëvizjes materiale të inspektorit të kontrollit tatimor dhe akt konstatimit të inxhinierit, për të cilin është mbajtur akt verifikimi në vend me nr.52/63 prot., datë 26.04.2024.
Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

16.2 Rekomandimi: DTM nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare informacion dhe dokumentacion justifikues nga tatimpaguesi “Gj K” SHA, për shfrytëzimin e mjeteve të transportit dhe autoveturave, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së kreditimit të TVSH-së, së karburantit konform përcaktimeve të legjislacionit fiskal në fuqi.

Komenti i Subjektit:

Nga ana e DTM është nxjerrë urdhër verifikimi në vend për saktësimin e situatës referuar rekomandimit të KLSH-së me nr.52/29 prot., datë 11.10.2023 si dhe autorizim për inxhinier nr.52/62 prot., datë 07.03.2024 ku është mbajtur akt verifikimi në vend me nr.52/63 prot., datë 26.04.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se DTM ka nxjerrë autorizimin nr.52/29 prot., datë 11.10.2023 si dhe autorizim për inxhinier Nr.52/62 Prot., datë 07.03.2024, për verifikim në vend të tatimpaguesit “Gj” Shpk, sipas rekomandimit të lëna nga KLSH për analizimin dhe vlerësimin e kreditimit të TVSH-së për furnizimet me karburant si dhe për shfrytëzimin e mjeteve të transportit dhe autoveturave, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh, për të cilin është mbajtur akt verifikimi në vend me nr.52/63 prot., datë 26.04.2024.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

17.1 Rekomandimi: Drejtori i DTM të marrë masat për përcjelljen pranë DPT të propozimit për parashikimin e procedurës së marrëveshjeve me këste të detyrimeve tatimore në aktet nënligjore miratuar prej saj, ose reflektimin e kësaj çështjeje në një dokument/manual të vetë institucionit, për t’u zbatuar nga strukturat përkatëse të kontrollit.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar kërkesave të tatimpaguesve për lidhjen e marrëveshjeve me këste, nga ana e DPT është kërkuar plotësimi i formularit bashkëlidhur nga data 1 korrik 2023, përpara lidhjes së marrëveshjes dhe dërgimi nëpërmjet postës elektronike për miratim në DPT. Me ardhjen e kërkesës për lidhje marrëveshje, verifikohen plotësimi i kushteve të nenit 77 të Ligjit Nr.9920/2008, i ndryshuar, hartohet formulari dhe dërgohet në DPT, gjithashtu pas miratimit të formularit nga ana e DPT, hartohet memo nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra lidhur me situatën e tatimpaguesit dhe konfirmimit nga ana e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara nëse ka filluar procedura e shitjes në ankand e pasurive të tatimpaguesit si dhe konfiskim për efekt të detyrimit tatimor të pashlyer, më pas hartohet lidhja e marrëveshjes sipas formatit tip të miratuar nga DPT pas hapjes së çështjes në sistemin C@ts.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga shqyrtimi i Manualit të kontrollit nga zyra dhe monitorimit, miratuar në dhjetor 2022, konkretisht pika 5.8 “Marrëveshjet për pagesë me këste të detyrimeve tatimore të papaguara” është parashikuar procedura për marrëveshjet me këste të detyrimeve tatimore të papaguara.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

17.2 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DTM të marrin masat për kryerjen e analizave efektive përpara lidhjes së akt-marrëveshjeve duke shqyrtuar historikun dhe aftësinë paguese të tatimpaguesit; si dhe të forcojnë procedurat aktuale të ndjekura përgjatë monitorimit

të zbatimit të tyre, me qëllim përmbushjen e kushteve dhe minimizimin e riskut të anulimit, apo përsëritjen e tyre , si një alternativë për të mos kaluar në masa të tjera shtrënguese.

Komenti i Subjektit:

Pra siç u theksua në qëndrimin sipas rekomandimit nr.17.1, formulari tip përveç të dhënave të përgjithshme të tatimpaguesit kërkon edhe plotësimin me të dhëna të tjera lidhur me analizimin e qarkullimit, kontratave të lidhura, listë klientësh, gjendjen e llogarive bankare, nëse ka marrëveshje me këste për detyrime tatimore të lidhura të mëparshme, nëse janë respektuar apo jo këto marrëveshje më herët dhe nëse është paguar 20% i detyrimeve tatimore si kusht për lidhjen e një marrëveshje me këste.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga shqyrtimi i disa praktikave për lidhjen e akt-marrëveshjeve, konstatohet se është kryer analizimi i qarkullimit, kontratave të lidhura, listave të klientëve, gjendja e llogarive bankare, nëse ka marrëveshje me këste për detyrime tatimore të lidhura të mëparshme, nëse janë respektuar apo jo këto marrëveshje më herët dhe nëse është paguar 20% i detyrimeve tatimore si kusht për lidhjen e një marrëveshje me këste.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

18.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DTM të marrë masat për hartimin e planit operacional institucional pjesë e të cilit të jetë edhe plani i Drejtorisë së Kontrollit, me qëllim përcaktimin e objektivave kryesore vjetore në luftën kundër informalitetit, objektiv bazë për realizimin e të ardhurave tatimore në funksion të mbarëvajtjes normale të punës.

Komenti i Subjektit:

Është hartuar plani operacional i vitit 2023 dhe 2024 nga ana e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dërguar me e-mail e datës 29.12.2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga shqyrtimi dokumentacionit justifikues të vendosur në dispozicion është konstatuar se është hartuar plani operacional për vitet 2023 dhe 2024 nga ana e drejtorisë së Kontrollit dhe dërguar me email.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

19.1 Rekomandimi: Sektori i Kontrollit nga Zyra pranë DTM të marrë masat për të kërkuar informacion lidhur me kategoritë që rezultojnë me diferenca sipas databazës së kasës së gjeneruar nga DPT, për të identifikuar shkaqet e diferencave, duke rekomanduar edhe kryerjen e kontroleve në vend sipas rasteve.

Komenti i Subjektit:

Nga ana e DTM është kërkuar elektronikisht it.helpdesk në DPT, informacion lidhur me kasat fiskale sipas kodeve ML01, ML05, ML09 dhe ML13 për t'u analizuar më tej me deklarin e të ardhurave të periudhës së audituar nga KLSH dhe për cdo diferencë të pa argumentuar Sektori i Kontrollit nga Zyra do ta përcjellë për t'u planifikuar verifikim në vend. Me email e datë 01.02.2024 it.helpdesk (A.G) na njofton se IT nuk e disponon informacionin se kujt subjekteve i përkasin kodet e mësipërme. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" nga janari 2021 tatimpaguesit lëshojnë fatura vetëm nëpërmjet sistemit selfcare dhe administrata tatimore monitoron mbi bazën e sistemit CPCM.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga shqyrtimi i emailit të datës 01.02.2024 të vendosur në dispozicion, ku vërtetohet se nga Sektori i Kontrollit nga Zyra në DTM është kërkuar informacion në lidhje me kasat fiskale sipas kodeve ML01, ML05, ML09 dhe ML13, për të cilat IT në DPT është sqaruar se nuk disponon informacion se kujt i përkasin. Gjithashtu në kuadër të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" nga janari 2021, tatimpaguesit lëshojnë fatura vetëm nëpërmjet sistemit selfcare dhe administrata tatimore

monitoron mbi bazën e sistemit CPCM dhe nuk monitorohen më nga Nexusi, i cili nuk është më aktiv dhe funksional.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

19.2 Rekomandimi: Sektori i Kontrollit në Vend të dokumentojë procesverbalet e gabimeve të kasës për çdo rast të konstatuar me diferencë, dhe të përcjellë këtë informacion pranë Sektorit të Kontrollit nga Zyra.

Komenti i Subjektit:

Siç u theksua edhe në rekomandimin 19.1, nga janari 2021 tatimpaguesit lëshojnë fatura vetëm nëpërmjet sistemit selfcare dhe administrata tatimore monitoron mbi bazën e sistemit CPCM, bazuar në Ligjin Nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në kuadër të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” nga janari 2021, tatimpaguesit lëshojnë fatura vetëm nëpërmjet sistemit selfcare dhe administrata tatimore monitoron mbi bazën e sistemit CPCM dhe nuk monitorohen më nga Nexusi, i cili nuk është më aktiv dhe funksional.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

20.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DPT në bashkëpunim me DPD-në dhe AKSHI-n, të ngrenë një grup pune me përfaqësues nga këto institucione, me qëllim verifikimin e shkaqeve që sjellin rezultate të ndryshme mes deklarimeve sipas DPT dhe DPD, me qëllim ndërmarrjen më pas të veprimeve rregulluese në sistemet sipas së cilave funksionojnë këto institucione, për të shmangur ekzistencën e diferencave në deklaram.

Komenti i Subjektit:

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresën Nr.52/34 Prot., datë 31.10.2023, “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DTM njoftuar me shkresën Nr.14/14 Prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DTM me Nr.52/29 Prot., datë 11.10.2023”, ka vendosur në dijëni në DPT, lidhur me këtë problematikë nëpërmjet këtij plani masash. Gjithashtu sqarojmë edhe se në lidhje me problematikën e diferencave midis importeve dhe eksporteve sipas të dhënave të DPT dhe DPD, ngritura nga grupi i auditimit gjykojmë se i ka dhënë zgjidhje hyrja në fuqi e Ligjit Nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, ku importet dhe eksportet fiskalizohen dhe shfaqen automatikisht në sistemin CPCM dhe në librat e shitje/blerjeve në sistemin C@ts, duke minimizuar diferencat midis deklarimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me problematikën e diferencave midis importeve dhe eksporteve midis të dhënave sipas DPT dhe DPD, sipas gjetjes dhe rekomandimit 20.1, konstatohet se është vendosur në dijëni DPT nëpërmjet planit të masave për zbatimin e rekomandimeve mbi problematikën, por deri në momentin e verifikimit nuk rezulton të jenë ngritur grupe pune në bashkëpunim me DPD-në dhe AKSHI-n. Gjithashtu nga verifikimi sipas të dhënave të vendosura në dispozicion mbi importet dhe eksportet e tatimpaguesve për periudha të ndryshme sipas të dhënave të sistemit CPCM, konstatohet se janë minimizuar diferencat, objekt verifikimi në mënyrë më të detajuar në auditimin e radhës.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

20.2 Rekomandimi: Sektori i Kontrollit nga Zyra të marrë masat për rastet ku nga sektori janë identifikuar problematika dhe për të cilat subjektet kanë qenë objekt kontrolli i thelluar në vend, të administrojë konkluzionet e raporteve përfundimtare, me qëllim analizimin dhe verifikimin e diferencave në deklarime ose problematikave të tjera.

Komenti i Subjektit:

Sektori i Kontrollit nga Zyra diferencat e importeve dhe eksporteve i ka kryer për çdo vit fiskal

duke kërkuar rakordimet përkatëse me tatimpagesin apo DPD. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, importet dhe eksportet fiskalizohen dhe shfaqen automatikisht në sistemin CPCM dhe në librat e shitje/blerjeve në sistemin C@ts.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Gjithashtu nga verifikimi sipas të dhënave të vendosura në dispozicion mbi importet dhe eksportet e tatimpaguesve për periudha të ndryshme sipas të dhënave të sistemit CPCM, konstatohet se janë minimizuar diferencat, objekt verifikimi në mënyrë më të detajuar në auditimin e radhës.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

21.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DTM në bashkëpunim me DPT të vlerësojnë zgjidhje optimale në sistemin C@ts në drejtim të procedurave të aplikueshme për efekt të aplikimit automatik të penaliteteve për tatimpaguesit që kanë likuiduar me vonesë këstet e parapagimeve të tatim fitimit, pagesës së tatimpaguesit për këstin do të shkojë për detyrimin më të hershëm të tij, rivlerësimeve të kësteve apo edhe proporcionalitetit të parapagimeve të kësteve të tatim fitimit krahasimisht me tatim fitimin e periudhës, me qëllim përmirësimin e analizës së kryer për miratimin e kërkesave për rishikimin e kësteve të tatim fitimit, për të mundësuar një vendimmarrje sa më të drejtë të sektorit të kontrollit nga zyra për këtë çështje.

Komenti i Subjektit:

Njoftuar DPT nëpërmjet planit të masave. Nga nëntor 2024 ka filluar aplikimi automatik i gjobave për pagesë të vonuar të kësteve të tatim fitimit për periudhën janar-shtator 2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Rekomandimi i KLSH lidhet me vlerësimin e zgjidhjeve optimale të tërësisë së problematikave të konstatuar në lidhje me sistemin sistemin C@ts dhe jo vetëm me pjesën e aplikimit automatik të gjobave për pagesë të vonuar të kësteve të tatim fitimit, rekomandim i cili deri në përfundim të auditimit në terren nuk rezulton të jetë kryer plotësisht.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

22.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DTM, për subjektet që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare, pavarësisht tejkallimit të afateve ligjore dhe rikujtesave të përcjella nga institucioni të kryejnë vlerësim nga zyra të situatës financiare, si dhe të përfshijnë në programe të kontrollit tematik në vend, me qëllim verifikimin e diferencave të konstatuara.

Komenti i Subjektit:

Për çdo tatimpagues mosdeklarues, Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit ka hartuar letër kujtesa për këta tatimpagues dhe i ka dërguar pranë Sektorit të Riskut për të vijuar më tej me planifikimin për kontroll në vend. Vlerësimin alternativ për mosdeklaruesit e deklaratës së tatim fitimit sistemi C@ats e kryen automatikisht sipas programimit vlerësimin alternativ.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion si letërkujtesave dhe shkresave dërguar Riskut për mosdeklaruesit për t'i propozuar për kontroll të thelluar si dhe pamjes së sistemit C@ts në lidhje me vlerësimin alternativ për mosdeklaruesit e deklaratës së tatim fitimit, sistemi C@ats e kryen automatikisht, gjykojmë se ky rekomandim është i realizuar.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

23.1 Rekomandimi: Nga DPT të merren masa për rishikimin e strukturës së Drejtorisë së Shërbimeve të Tatimpaguesve në DTM, referuar treguesve të performancës në rënie nga viti 2021 në vitin 2022, efektivitetit të kësaj drejtorie si dhe procesit të dixhitalizimit dhe rritjes së numrit të shërbimeve të ofruara online.

Komenti i Subjektit:

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresën Nr.52/34 Prot., datë 31.10.2023, “Plani i

masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DTM njoftuar me shkresën Nr.14/14 Prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DTM me nr.52/29 Prot., datë 11.10.2023”, ka vendosur në dijëni DPT-në, lidhur rekomandimin 23.1 nëpërmjet këtij plani masash.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se DTM ka vendosur në dijëni DPT nëpërmjet shkresës nr.52/34 prot., datë 31.10.2023, në lidhje me rekomandimin 23.1 të lënë nga KLSH, por deri në momentin e verifikimit rezultoi se nuk është marrë asnjë masë nga ana e DPT-së.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

24.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të papaguara në DTM të merren masa konkrete në ushtrimin e kompetencave të dhëna sipas legjisllacionit në fuqi duke zbatuar mënyrat e vlerësimit të riskut, për të përcaktuar dhe zbatuar, në çdo rast, masën më të përshtatshme të mbledhjes me forcë si edhe duke siguruar mbulimin e borxhit tatimor me të gjithë masat shtrënguese, në mënyrë që të maksimalizohet mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara.

Komenti i Subjektit:

Aktualisht detyrimet tatimore të papaguara deri në 31.10.2024 janë 7,970,376 mijë lekë, pra kemi një ulje të vlerës së detyrimeve tatimore të papaguara nga fundi i vitit 31.12.2023 që ishte 12,609,965 mijë lekë, ulje kjo që ka ardhur jo vetëm si rezultat i transferimit të tatimpaguesve debitorë nga DTM në DRT-të përkatëse, por edhe si rezultat i arkëtimeve të realizuara nga masat e marra nga DMDTP në DTM. Ku konkretisht janë njoftuar tatimpaguesit debitorë nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm me telefon, postës elektronike dhe njoftimit të dërguar me shkresë zyrtare. Janë vendosur Urdhër Bllokimi të llogarive bankare, është vendosur Bllokim i aktivitetit në doganë. Dërguar njoftime dhe kërkesa për pagesë të detyrimeve për palët e treta, në zbatim të nenit 98 të ligjit, si dhe është kryer verifikim dhe monitorim në terren i aktivitetit tregtar për konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% e qarkullimit të realizuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e rekomandimit, është verifikuar vlera e detyrimeve tatimore të papaguara deri në 31.10.2024 që janë 7,970,376 mijë lekë sipas debitorëve analitik, gjithashtu për debitorë specifikë është vendosur në dispozicion edhe pamja e sistemit C@ts si dokument justifikue, si dhe praktikat shkresore të masave të marra ndaj këtyre subjekteve. Gjithashtu është vendosur në dispozicion si dokumente justifikues edhe formulari për evidentimin e masave shtrënguese progresive tetor-dhjetor 2024, i cili i përmbledhur rezultoi si më poshtë:

Nr	Llojet e masave shtrënguese	Vendosura		Arkëtuara		Liruar	
		Nr raste	Shuma	Nr raste	Shuma	Nr raste	Shuma e masës shtrënguese
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	1,449	2,212,855,975	1,035	2,137,600,165	0	
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	139	309,969,493	79	87,012,939	73	221,593,148
3	Urdhër ekzekutime	94	289,148,635	18	289,148,635	0	
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	3	11,590,560	0	0	1	888,705
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguroese	6	11,650,981	0	0	0	0
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	3	11,590,560	0	0	0	0
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguroese	3	11,590,560	0	0	0	0
8	Urdhër sekuestrimi	0	0	0	0	0	0
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	0	0	0	0	0	0
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	3	57,444	0	0	0	0
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	0	0	0	0	0	0

12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	84	493,881,59 9	56	151,197,97 4	51	264,203,977
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	8	41,340,155	2	10,779,971	2	37,189,129
	Totali	1,792	3,393,675, 962	1,190	2,675,739,6 84	127	523,874,959

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

25.1 Rekomandimi: Titullari i DTM të marrë masa për përcjelljen e kësaj problematike pranë MFE, ku Struktura e Apelit Tatimor në MFE të shqyrtojë situatën e mësipërme, në mënyrë që të garantohet raportimi i informacionit në sistemin C@TS sipas përcaktimeve ligjore për rastet që janë në proces ankimimi.

Komenti i Subjektit:

Sektori i Monitorimit dhe Analizës për Masat Shtrënguese në DMDTP në DTM ka vënë në dijeni Drejtorinë e Apelit Tatimor në MFE dhe DPT në lidhje me rekomandimin Nr.25 të lënë nga KLSH-ja, nëpërmjet shkresës me Nr.52/32 Prot., datë 24.10.2023. Nga ana e DAT-së në MFE nuk kemi ende një përgjigje zyrtare në lidhje me këtë problematik sipas rekomandimit të lënë nga KLSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacioni të vendosur në dispozicion është konstatuar se DMDTP në DTM i është drejtuar me shkresën zyrtare Nr.52/32 Prot., datë 24.10.2023, Drejtorisë së Apelit Tatimor në MFE në lidhje me rekomandimin e lënë nga auditimi i KLSH, ku kërkohet zgjidhja e problematikës së konstatuar, për dijeni edhe DPT. Por nga DAT në MFE nuk ka kthim përgjigje për problematikën.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

26.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimin dhe arkivimin e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike, me qëllim garantimin e saktësisë dhe plotësisë në administrimin e dokumentacionit. Komisionet e prokurimit të marrin masa që për çdo procedurë prokurimi të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke garantuar siguri dhe transparencë mbi procedurën e prokurimit blerje e vogël.

Komenti i Subjektit:

Në lidhje me informacionin për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ana juaj ju bëjmë me dije se:

1. Kemi bërë arshivimin e çdo praktike për prokurimet e bëra;
2. Kemi arshivuar një kopje të kontratës nr.6111/2 datë 12.07.2022;
3. Në lidhje me plotësimin e deklaratës së konfliktit të interesit për çdo rast prokurimi nën vlerën 100.000 lekë, nuk kemi mund ta plotësojmë pasi të dyja anëtarët e komisionit kanë dhënë dorëheqjen Znj. E. K Maj 2023 dhe Znj. J. P ka qenë me leje lindje dhe pas përfundimit të lejes së lindjes ka dhënë dorëheqjen.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga subjekti janë vendosur në dispozicion si dokumente justifikuese vetëm praktikat e prokurimeve me vlerë të vogël të cilat janë dërguar arkivës për arkivim.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

27.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa të menjëhershme për përcaktimin e efekteve të vlerësimeve alternative, me pasojë të ardhura tatimore të munguara në buxhetin e shtetit, si dhe në vijimësi, të ndjekë zbatimin e përcaktimeve ligjore në lidhje me respektimin e kostos minimale fiskale, çmimit minimal fiskal dhe fitimit minimal fiskal në sektorin e ndërtimit.

Qëndrimi i Subjektit:

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresën Nr.52/34 Prot., datë 31.10.2023, “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DTM njoftuar me shkresën Nr.14/14 Prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DTM me nr.52/29 Prot., datë 11.10.2023”, ka vendosur në dijëni DPT-në, lidhur rekomandimin 27.1 nëpërmjet këtij plani masash.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se DTM ka vendosur në dijëni DPT nëpërmjet shkresës nr.52/34 prot., datë 31.10.2023, në lidhje me rekomandimin 27.1 të lënë nga KLSH, por deri në momentin e verifikimit rezultoi se nga DPT nuk janë masa për përcaktimin e efekteve të vlerësimeve alternative, me pasojë të ardhura tatimore të munguara në buxhetin e shtetit, si dhe në vijimësi, të ndjekë zbatimin e përcaktimeve ligjore në lidhje me respektimin e kostos minimale fiskale, çmimit minimal fiskal dhe fitimit minimal fiskal në sektorin e ndërtimit.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

28.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj të merren masa menjëherë dhe në vijimësi të zbatohen me korrektësi procedurat dhe afatet e përcaktuara ligjore për ushtrimin e kontrollove tek tatimpaguesit.

Qëndrimi i Subjektit:

Nga DTM janë marrë masa me qëllim respektimin e të gjitha hapave proceduriale në kryerjen e kontrolleve tatimore, ku filluar nga njoftim kontrolli, programi i kontrollit, përgatitja, dërgimi në subjekt dhe pasqyrimi në sistemin C@ts të projekt raporteve dhe raporteve përfundimtare të kontrollit tatimor ka pasur përmirësim në respektimin e afateve administrative ligjore, gjithësesi sqarohet se ka pasur disa tejkalime të këtyre afateve, të cilat kanë ardhur për arsye objektive siç janë kërkesat për rimbursim me kontroll në vend, të cilat sipas legjislacionit kanë prioritet në trajtim.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga ana e subjektit janë vendosur në dispozicion si dokumente justifikuese evidenca e kontrolleve të zhvilluara për periudhën e fundit 6 mujore, disa praktika të kontrolleve dhe pasqyrimi i tyre në sistemin C@ts, ku konstatohet se ekzistojnë përsëri raste të vonesave respektimin e afateve të përcaktuara ligjore, objekt verifikimi në auditimin e radhës.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe në proces zbatimi.

29.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshme të Tatimeve, të merren masa dhe të bëhen përmirësime në aktet ligjore dhe nënligjore për përcaktimin e afatit maksimal nga përfundimi i përgatitjes së Projekt Raportit nga Inspektori deri në miratimin e tij nga eprorët (Përgjegjës Sektor/Drejtor).

Qëndrimi i Subjektit:

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresën Nr.52/34 Prot., datë 31.10.2023, “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DTM njoftuar me shkresën Nr.14/14 Prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DTM me nr.52/29 Prot., datë 11.10.2023”, ka vendosur në dijëni DPT-në, lidhur rekomandimin 29.1 nëpërmjet këtij plani masash.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se DTM ka vendosur në dijëni DPT nëpërmjet shkresës nr.52/34 prot., datë 31.10.2023, në lidhje me rekomandimin 29.1 të lënë nga KLSH, por deri në momentin e verifikimit rezultoi se nuk është marrë asnjë masë nga ana e DPT-së.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

29.2 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit për afatet të marrë masa për:

- Pasqyrimin në kohë të akteve të kontrollit (procesverbale, akt konstatime) në sistemin informatik tatimor;
- Të fillojë kontrollet duke respektuar afatet e njoftimit të kontrollit;
- Të përmirësojë procedurën e hartimit të raportit paraprak të kontrollit në kohë;
- Të mbajë komunikim të vazhdueshëm me tatimpaguesit për pasqyrimin e observacioneve dhe respektimin e afatit të përfundimit në kohë të raportit të kontrollit tatimor përfundimtar.

Qëndrimi i Subjektit:

Nga DTM janë marrë masa me qëllim respektimin e të gjitha hapave proceduriale në kryerjen e kontrolleve tatimore, ku filluar nga njoftim kontrolli, programi i kontrollit, përgatitja, dërgimi në subjekt dhe pasqyrimi në sistemin C@ts të projekt raporteve dhe raporteve përfundimtare të kontrollit tatimor ka pasur përmirësim në respektimin e afateve administrative ligjore, gjithësesi sqarojmë se ka pasur disa tejkalime të këtyre afateve, të cilat kanë ardhur për arsye objektive siç janë kërkesat për rimbursim me kontroll në vend, të cilat sipas legjislacionit kanë prioritet në trajtim.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga ana e subjektit janë vendosur në dispozicion si dokumente justifikuese evidenca e kontrolleve të zhvilluara për periudhën e fundit 6 mujore, disa praktika të kontrolleve dhe pasqyrimin e tyre në sistemin C@ts, konstatohet se ekzistojnë përsëri raste të vonesave respektimin e afateve të përcaktuara ligjore, objekt verifikimi në auditimin e radhës.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces zbatimi.

30.1 Rekomandimi: Titullari i DTM, në bashkëpunim edhe me DPT, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil sipas pozicioneve të miratuara në Urdhrin e Kryeministrit Nr.33, datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”.

Qëndrimi i Subjektit: Në zbatim të Rekomandimeve sipas raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr.14/14 prot, datë 09.10.2023 për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj me objekt “Auditim Përputhshmërie”, protokolluar me tonën Nr. 52/29 datë 11.10.2023, dhe në vijim të zbatimit të planit të masave, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka njoftuar me shkresën Nr.52/33 datë 01.11.2023 “Dërgim i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” (Kopje bashkëlidhur) Rekomandimin Nr.30.1 lidhur me plotësimin e vendeve vakante pjesë e shërbimit civil, sipas pozicioneve të miratuara në Urdhrin e Kryeministrit Nr 33 datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”. Për rrjedhojë me marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është realizuar pjesërisht plotësimi i vendeve vakante si vijon:

- Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve plotësuar, aktualisht vend vakant 1;
- Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara plotësuar, vende vakant 3;
- Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit plotësuar, vende vakante 2 aktualisht;
- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse plotësuar vendi vakant i specialistit të burimeve njerëzore dhe Drejtorit të Drejtorisë, vende vakante 3 aktualisht.(pjesë e shërbimit civil);
- Drejtoria e Kontrollit Tatimor plotësuar, aktualisht 7 vende vakante.

Nr	Punonjës sipas strukturës për cdo Drejtori	Plani	Fakti	Vende vakante
1	Dr/Sekretaria	2	1	1
1	Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve	7	6	1
2	Drejtorja e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	11	8	3
3	Drejtorja e Kontrollit Tatimor	77	70	7
4	Drejtorja e Analizës, Riskut dhe Kontabilitetit të Ardhurave	8	6	2
5	Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse	22	18	4
	Gjithsej	127	109	18

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se ekzistojnë përsëri vende vakante në organikën e DTM pa plotësuar.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

C. Zbatimi i rekomandimeve për masat për të ardhura të munguara. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “K P T D” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 4,725,971 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresë nr.14/14 datë 9.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/45 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.1 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresë nr.94/1 datë 14.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikontrollit i cili është evaduar me shkresën nr.94/10 datë 13.06.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 12.06.2024 sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 0 lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “K P T D” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/45 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.1 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.94/1 datë 14.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikontrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.94/10 datë 13.06.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 12.06.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 0 lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “B. E” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 56,146,215 lekë si dhe ulja e humbjes në vlerën 230,296,205 lekë.

Qëndrimi i Subjektit: Nga DTM ky tatimpagues duke qenë në juridiksionin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr.52/52 datë 13.12.2023 është dërguar rekomandimi i KLSH për rikontroll sipas periudhave të lëna nga KLSH-ja.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacioneve të vendosura në dispozicion, rezulton se subjekti “B. E” SHPK është nën juridiksionin e DRT Tiranë e cila ka kompetencat për të kryer rikontrollin, në këto kushte ky rekomandim në tërësinë e vet do të konsiderohet i zbatuar nga ana e DTM me përcjelljen e rekomandimit pranë DRT Tiranë, e cila duhet të vijojë më procedurën e rikontrollit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 51,584,082 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.14/14 datë 9.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023. DTM me shkresën nr.52/42 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.4 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.87/1 datë 14.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikontrollit i cili është evaduar me shkresën nr.87/7 datë 27.05.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 27.05.2024 sipas njoftim vlerësimit të detyrimit në shumën 2,286 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “A” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/42 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.4 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.87/1 datë 14.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikontrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.87/7 datë 27.05.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 27.05.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 2,286 mijë lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 34,510,323 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/43 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.16 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.99/1 datë 14.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikontrollit i cili është evaduar me shkresën nr.99/12 datë 28.06.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 28.06.2024 sipas njoftim vlerësimit të detyrimit në shumën 714 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “A” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/43 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.16 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.99/1 datë 14.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikontrollit tatimor i cili është

evaduar me shkresën nr.99/12 datë 28.06.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 28.06.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 714 mijë lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 57,260,666 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/44 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.3 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.85/3 datë 29.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikontrollit i cili është evaduar me shkresën nr.85/8 datë 15.05.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 16.05.2024 sipas njoftim vlerësimit të detyrimit në shumën 604 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “A” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/44 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.3 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.85/3 datë 29.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikontrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.85/8 datë 15.05.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 16.05.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 604 mijë lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “B” SHA, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 1,804,167 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/54 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.15 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.1160 datë 14.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikontrollit i cili është evaduar me shkresën nr.1160/3 datë 10.07.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 17.07.2024 sipas njoftim vlerësimit të detyrimit në shumën 1,610 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “B” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/54 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.15

datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.1160 datë 14.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikontrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.1160/3 datë 10.07.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 17.07.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 1,610 mijë lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “F K C F” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 33,225,144 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/46 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.2 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.1161 datë 14.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikontrollit i cili është evaduar me shkresën nr.1161/5 datë 12.07.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 02.08.2024 sipas njoftim vlerësimit të detyrimit në shumën 8,661 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “F K C F” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/46 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.2 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.1161 datë 14.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikontrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.1161/5 datë 12.07.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 02.08.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 8,661 mijë lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “M C I” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 292,965,611 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/50 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.7 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.86/1 datë 14.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikontrollit i cili është evaduar me shkresën nr.86/8 datë 15.05.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 14.05.2024 sipas njoftim vlerësimit të detyrimit në shumën 4,587 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “M C I” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/50 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.7 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.86/1 datë 14.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikotrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.86/8 datë 15.05.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 02.08.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 4,587 mijë lekë.
Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “E” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 9,199,387 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/56 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.13 datë 5.1.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.95/3 datë 27.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikotrollit i cili është evaduar me shkresën nr.95/8 date 26.04.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 26.04.2024 sipas njoftim vlerësimit të detyrimit në shumën 1,157 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “E” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/56 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.13 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.95/3 datë 27.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikotrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.95/8 date 26.04.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 26.04.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 1,157 mijë lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A K” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 16,403,478 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/49 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.6 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.91/2 datë 22.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikotrollit i cili është evaduar me shkresën nr.91/7 datë 27.05.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 12.07.2024 sipas njoftim vlerësimit të

detyrimin në shumën 1,413 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “A K” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/49 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.6 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.91/2 datë 22.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikotrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.91/7 datë 27.05.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 12.07.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 1,413 mijë lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “N C” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 76,958,615 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresë nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/51 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.8 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.1163 datë 14.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikotrollit i cili është evaduar me shkresën nr.1163/6 datë 24.06.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 28.06.2024 sipas njoftim vlerësimet të detyrimit në shumën 832 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “N C” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/51 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.8 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.1163 datë 14.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikotrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.1163/6 datë 24.06.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 28.06.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 832 mijë lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “M K” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 23,313,420 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/30 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/48 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.5 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim

kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.92/1 datë 14.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikotrollit i cili është evaduar me shkresën nr.92/5 datë 18.07.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 22.07.2024 sipas njoftim vlerësimit të detyrimit në shumën 300 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “M K” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/48 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.5 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.92/1 datë 14.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikontrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.92/5 datë 18.07.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 22.07.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 300 mijë lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A-S” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 550,650,758 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/47 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.10 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.88/3 datë 29.02.2024. Mbi baze të programit është hartuar Raporti i Rikotrollit i cili është evaduar me shkresën nr.88/7 datë 05.07.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 08.07.2024 sipas njoftim vlerësimit të detyrimit në shumën 2,854 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “A-S” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/47 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.10 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.88/3 datë 29.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikotrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.88/7 datë 05.07.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 08.07.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 2,854 mijë lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “I” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 46,388,064 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresë nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/53 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për

rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkresë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr. 9, datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.84/1 datë 14.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikontrollit i cili është evaduar me shkresën nr.84/9 datë 28.06.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 02.07.2024 sipas njoftim vlerësimit të detyrimit në shumën 944 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “I” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/53 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve rikontrolli me vendim nr.9 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.84/1 datë 14.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikotrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.84/9 datë 28.06.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 02.07.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 944 mijë lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

15.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A A S E” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 623,002,752 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresë nr.14/14 datë 9.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/55 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkresë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.14 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.96/1 datë 14.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikotrollit i cili është evaduar me shkresën nr.96/7 datë 25.07.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 24.07.2024 sipas njoftim vlerësimit të detyrimit në shumën 9,935 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “A A S E” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/55 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve rikontrolli me vendim nr.14 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.96/1 datë 14.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikotrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.96/7 datë 25.07.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 24.07.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 9,935 mijë lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

15.2 Rekomandimi: DTM në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në rastet e praktikave të kontrolleve të plota ose rimbursimit të TVSH-së, të tatimpaguesve me aktivitet prodhim i energjisë elektrike, të përcaktojë grupe kontrolli me përbërje minimumi dy inspektorë kontrolli tatimor dhe një inxhinier ndërtimi nga DTM dhe të kryejë marrëveshje bashkëpunimi me AKBN-në, me qëllim përfshirjen të një specialisti të AKBN-së, në grup kontrolli, me qëllim vlerësimin e investimit në përputhje me afatet dhe dokumentacionin ligjore për bazueshmërinë e kreditimit dhe ligjshmërinë e TVSH-së rimbursueshme.

Qëndrimi i Subjektit:

Në kontrollin e plotë të ushtruar nga DTM për tatimpaguesin e “D H” me NIPT K....., sipas Njoftim Kontrollit Tatimor paraprak me nr.6954/2 prot., datë 04.09.2023 dhe Njoftim Kontrollit Tatimor me nr.6954/3 prot datë 18.12.2023, me aktivitet prodhim i energjisë elektrike në zbatim të rekomandimeve të KLSH me shkresë nr.14/14 datë 09.10.2023 Prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, grupi i kontrollit është përcaktuar me dy inspektorë të DTM-së.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga verifikimi i dokumentacioni të vendosur në dispozicion është konstatuar se në kontrollin e plotë të zhvilluar në tatimpaguesin “D H” me aktivitet prodhim i energjisë elektrike, janë përcaktuar dy inspektor kontrolli nga DTM, por rezulton se nuk është kryer marrëveshje bashkëpunimi me AKBN, me qëllim përfshirjen të një specialisti të AKBN-së, në grup kontrolli, me qëllim vlerësimin e investimit në përputhje me afatet dhe dokumentacionin ligjore për bazueshmërinë e kreditimit dhe ligjshmërinë e TVSH-së rimbursueshme.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “B M T” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 13,214,552 lekë.

Qëndrimi i Subjektit:

Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/57 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.12 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.1357 datë 20.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikotrollit i cili është evaduar me shkresën nr.1357/5 datë 08.08.2024. Raporti rezulton i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 08.08.2024 sipas njoftim vlerësimit të detyrimit në shumën 2,310 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “B M T” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/57 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.12 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.1357 datë 20.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikotrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.1357/5 datë 08.08.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 08.08.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 2,310 mijë lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A Ch” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim analizimin dhe verifikimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 133,357,882 lekë.

Qëndrimi i Subjektit: Referuar rekomandimeve të KLSH me shkresën nr.14/14 datë 09.10.2023 prot në DTM nr.52/29 datë 11.10.2023, DTM me shkresën nr.52/58 datë 13.12.2023 ka propozuar tatimpaguesin për rikontroll. Mbi bazën e kësaj shkrese Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar Rikontrollin me Vendim Nr.11 datë 05.01.2024. Nga ana e DTM është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.1162 datë 14.02.2024. Mbi bazë të programit është hartuar Raporti i Rikotrollit i cili është evaduar me shkresën nr.1162/5 datë 11.07.2024. Raporti rezultoi i pasqyruar në sistemin C@ts në datën 09.07.2024 sipas njoftim vleresimit të detyrimit në shumën 371 mijë lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, dhe është vijuar me propozimin për rikontroll të subjektit “A Ch” SHPK, nëpërmjet shkresën nr.52/58 datë 13.12.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve rikontrolli me vendim nr.11 datë 05.01.2024. Është nxjerrë njoftim kontrolli dhe programi përkatës me shkresën nr.1162 datë 14.02.2024, mbi bazë të programit është hartuar raporti i rikotrollit tatimor i cili është evaduar me shkresën nr.1162/5 datë 11.07.2024 dhe është ngarkuar në sistemin C@ts në datën 09.07.2024, sipas njoftim vlerësimeve të detyrimit në shumën 371 mijë lekë.

Ky rekomandim rezultoi i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

D. Mbi zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Mbështetur në nenin 59 të Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM-në Nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe Drejtorit Rajonal të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, që në vlerësimin e shkeljeve dhe gjykimit përfundimtar që lidhet me kontabilizimin e detyrimeve tatimore të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, proces i cili duhet të kryhet në bashkëpunim të plotë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas vlerësimit të problematikave, të urdhëroje dhe të konkludojë me nisjen e procedurave të parashikuara në pikën 1 gërma “b”, “c” të nenit 58 të Ligjit Nr.152/2013, për shkeljet e konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda, duke urdhëruar fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, për personat përgjegjës në proporcion të plotë me shkeljet e kryera, vlerat e konstatuara, apo veprimet e kryera në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, sipas nenit 58 gërma “b” dhe “c” të nenit 57 dhe 58 të Ligjit Nr.152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”.

Qëndrimi i Subjektit: Referuar rekomandimeve të KLSH, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresën nr.52/34 prot., datë 31.10.2023 “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DTM njoftuar me shkresën nr.14/14 prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DTM me nr.52/29 Prot., datë 11.10.2023”, ka vendosur në dijeni DPT, lidhur me shkeljet dhe parregullësitë sipas raportit të auditimit. DTM gjithashtu konform përcaktimeve ligjore në fuqi, konkretisht nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe pikës 85 “Rikontrolli tatimor” të Udhëzimit Nr.24 date 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ka propozuar për rikontroll të subjektit së bashku me inspektorët përkatës nëpërmjet shkresave nr.52/56 datë 13.12.2023, nr.52/44 datë 13.12.2023, nr.52/42 datë 13.12.2023, nr.52/50 datë 13.12.2023, nr.52/49 datë 13.12.2023, nr.52/43 datë 13.12.2023, nr.52/51 datë 13.12.2023, nr.52/45 datë 13.12.2023, nr.52/53 datë 13.12.2023, nr.52/47 datë 13.12.2023, nr.52/55 datë 13.12.2023, nr.52/54 datë 13.12.2023, nr.52/46 datë 13.12.2023, nr.52/58 datë 13.12.2023, nr.52/48 datë 13.12.2023, nr.52/57 datë 13.12.2023, të cilat janë miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me vendimet nr.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8,

9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16 datë 05.01.2024. Në përfundim të proceseve të rikontrollit nga rezultatet e arritur është si dhe nga analiza e të gjitha gjetjeve të trajtuara në raportin përfundimtar të KLSH, është gjykuar dhe vlerësuar se parregullsitë nuk përbëjnë element të një shkelje disiplinore, ku analiza është bazuar në performancën e strukturave të DTM në përmbushjen e objektivit kryesor që ka në mbledhjen dhe realizimin e të ardhurave tatimore, është proceduar me mosfillimin e procedimit disiplinor për nëpunësit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj është pranuar rekomandimi i lënë nga KLSH, si dhe është vendosur në dijeni DPT nëpërmjet shkresës nr.52/34 prot., datë 31.10.2023 “Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të KLSH për auditimin në DTM njoftuar me shkresën nr.14/14 prot., datë 09.10.2023, protokolluar në DTM me nr.52/29 Prot., datë 11.10.2023”, lidhur me shkeljet dhe parregullsitë sipas raportit të auditimit. Gjithashtu nga DTM është vijuar nxjerrjen e shkresave për propozimet për rikontroll të subjekteve së bashku me inspektorët përkatës, për të cilat janë konstatuar parregullësi, konform përcaktimeve të pikës 1, gërma c të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit në zbatim të tij. Në përfundim të proceseve të rikontrollit nga rezultatet e arritur si dhe nga analiza e të gjitha gjetjeve të trajtuara në raportin përfundimtar të KLSH, është gjykuar dhe vlerësuar se parregullësitë nuk përbëjnë element të një shkelje disiplinore dhe është proceduar me mosfillimin e procedimit disiplinor për nëpunësit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 14/14 prot., datë 09.10.2023 është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **41** rekomandime si masa organizative, nga ku janë pranuar **41** rekomandime të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **19** zbatuar plotësisht, **5** në proces zbatimi, **2** pa zbatuar, **15** zbatuar pjesërisht.
- b. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **18** rekomandime për të ardhura të munguara nga ku **18** rekomandime të pranuar, dhe **18** kanë statusin e ecurisë **zbatuar pjesërisht**.
- c. Për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, është lënë **1** rekomandim i cili është pranuar dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit **zbatuar**.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.

Për sa më sipër ri kërkojmë që, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar, si dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi, brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025.

MASA ORGANIZATIVE

2.1 Rekomandimi: Drejtori i DTM të marrë masat për përcaktimin e procedurave, detyrave dhe përgjegjësiive konkrete, në drejtim të programimit dhe raportimit pranë DPT lidhur me progresin e bërë kundrejt planit të të ardhurave tatimore dhe shmangiet nga programi i miratuar, duke konsideruar edhe formate tip raportimi, me qëllim që ndjekja dhe realizimi i të ardhurave për çdo zë të bëhet më efektiv dhe eficient, duke garantuar planifikimin në funksion të një shpërndarje sa më të drejtë dhe reale të planit të të ardhurave sipas llojit dhe strukturës, me qëllim shmangien e rishikimeve të shpeshta të këtij plani përgjatë vitit.

2.2 Rekomandimi: Strukturat drejtuese pranë DTM të marrin masat për hartimin e planit operacional të veprimtarisë institucionale, planeve vjetore, dhe raporteve periodike, në funksion të mirë menaxhimit dhe monitorimit të institucionit për arritjen e objektivave.

3.2 Rekomandimi: Drejtori i DTM të marrë masat për përcjelljen e Rregullores së Brendshme për Sektorin e Analizës së Riskut pranë institucioneve eprore me qëllim miratimin e këtij dokumenti nga autoriteti përgjegjës për miratimin e rregulloreve që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit.

6.1 Rekomandimi: DTM në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojnë një metodologji të qartë dhe të saktë nënligjore, ose një manual udhëzues për analizimin e llogarisë së ortakut, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.

6.2. Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me DPT, të analizojë situatën e kontrollit të kryer në subjektet “A” SHA, “I” SHPK, “A” SHPK, “K P T D” SHPK, “A” SHPK, “F” SHPK dhe “B E” SHPK, referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH-së, si dhe të vlerësojë përcjelljen e tyre pranë strukturës kompetente pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, për vlerësimin dhe identifikimin e mëtejshëm të burimeve të financimit.

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet Sektorit të Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave dhe Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, të marrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative, me qëllim hartimin e një qarkoreje dhe metodologjie të mirë përcaktuar, për standardizimin e procedurave të kontroleve tatimore të rimbursimit të TVSH-së për kontrollin e tatimpaguesve me aktivitet përpunimin dhe tregtimi i naftës dhe nënprodukteve të saj, duke përcaktuar qartësisht periudhat për kontrollin e bilancit material.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, për tatimpaguesit “A” SHA, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në analizimin e të dhënave të paraqitura në Raport Kontrolli, të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, të kryerje një analizë të thelluar nga zyra të situatës financiare të tatimpaguesit duke bërë vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse ose të propozojë kryerjen e kontroleve të thelluara në vend/vizitave fiskale, në rastin e vlerësimit me risk të lartë të mos pasqyrimit të saktë të situatës financiare dhe mos llogaritjen e detyrimeve tatimore me efekt mungesën e të ardhurave për buxhetin e shtetit.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për artikullin “Naftë Bruto” me origjinë nga “Prodhimi Vendas Shqipëri” sipas kushtit të lëvrimit FOB, bazuar në faktet dhe provat e trajtuara dhe të paraqitura sa më sipër si dhe në materialin e Raportit të Auditimit të gjykojë dhe të kërkojë ndjekjen e procedurave për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pagesës së rentës minerare të konstatuar si diferenca pagese në shitje malli në procedura eksporti në shumën 131,528,466 lekë, dhe bazuar në çmimet e publikuara të bursës Platts të kërkojë pagesa e detyrimeve të tjera tatimore, për vlerën e mallit të shitur të rivlerësuar të ri trajtuar sipas çmimit të bursës brend të rivlerësuar në procedure eksporti në shumën 1,315,284,657 lekë për të cilat nga DTM duhet të llogariten edhe detyrimet e tatimit mbi të ardhurat e rivlerësuar nga shitja duke marrë konsideratë llojin e aktivitetit, në përmbushje të përcaktimeve të ligjit Hidrokarbur në

Republikën e Shqipërisë, neni 5 dhe 6 i Ligjit nr.153/2020 “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur renta minerare” dhe në përcaktimet e legjislacionit tatimor në R.SH.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj nisur nga situata e mbartur në lidhje me këtë problematikë të diskutuar edhe më parë në çështje gjyqësore siç pretendohet nga observimi i bërë nga nëpunësit e autorizuar për problematikën e investimeve dhe lejes së situacioneve dhe kriterëve të investimeve të bëra brenda zonës operuese të kërkim/prodhimit në zonën Patos-Marinëz bazuar në faktet dhe provat e trajtuara dhe të paraqitura sa më sipër si dhe në materialin e Raportit të Auditimit të gjykojë dhe të kërkojë ndjekjen e procedurave tatimore bazuar në legjislacionin tatimor ne fuqi me qëllim analizimin e vlerës së TVSH-së së kredituar në tepricë dhe të pa trajtuar në procedura blerje situacione për punime brenda zonës së kërkim-prodhimit për punime në:

- Shumën 2,499,219 lekë për mallra e shërbime me vlerë TVSH-je të cilat duhet të ishin trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar bazuar në pikën 2 të Udhëzimit të Përbashkët i MF dhe ME nr.17, datë 12.6.2015.

- Në shumën 412,068,235 lekë vlerë totali blerje jashtë kriterëve ligjore për të cilat nga DTM duhet të trajtohen edhe detyrimet përkatëse tatimore për vlerën e TVSH-së së kredituar në blerje në shumën 82,413,646 lekë, e cila nuk duhet të ishte trajtuar si shërbim me TVSH të kredituar por duhej trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar.

- Në shumën 69,894,293 lekë për të cilat nuk është trajtuar si shërbim me TVSH-të pagueshme por është trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar për blerje shërbimi nga shoqëri të huaja dhe vendase për shërbime dhe mallra me TVSH të përjashtuar për mallra dhe shërbime jashtë kriterëve ligjore për të cilat duhet të trajtohen edhe detyrimet përkatëse tatimore për transaksione dhe vlerë punime në shumën 69,894,293 lekë, për të cilat nuk është trajtuar si shërbim me TVSH-të pagueshme por është trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar.

14.1 Rekomandimi: DTM në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për parapagimet nga shitja e njësive ndërtimore me certifikatë shfrytëzimi por pa kalim titulli pronësie, të hartojnë një metodologji të qartë ose një manual udhëzues për njohjen e të ardhurave duke analizuar rrethanat e transaksionit dhe vlerësimi nëse një njësi ekonomike ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi.

19.1 Rekomandimi: Sektori i Kontrollit nga Zyra pranë DTM të marrë masat për të kërkuar informacion lidhur me kategoritë që rezultojnë me diferenca sipas databazës së kasës së gjeneruar nga DPT, për të identifikuar shkaqet e diferencave, duke rekomanduar edhe kryerjen e kontrolleve në vend sipas rasteve.

19.2 Rekomandimi: Sektori i Kontrollit në Vend të dokumentojë procesverbalet e gabimeve të kasës për çdo rast të konstatuar me diferencë, dhe të përcjellë këtë informacion pranë Sektorit të Kontrollit nga Zyra.

20.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DPT në bashkëpunim me DPD-në dhe AKSHI-n, të ngrenë një grup pune me përfaqësues nga këto institucione, me qëllim verifikimin e shkaqeve që sjellin rezultate të ndryshme mes deklarimeve sipas DPT dhe DPD, me qëllim ndërmarrjen më pas të veprimeve rregulluese në sistemet sipas së cilave funksionojnë këto institucione, për të shmangur ekzistencën e diferencave në deklaram.

20.2 Rekomandimi: Sektori i Kontrollit nga Zyra të marrë masat për rastet ku nga sektori janë identifikuar problematika dhe për të cilat subjektet kanë qenë objekt kontrolli i thelluar në vend,

të administrojë konkluzionet e raporteve përfundimtare, me qëllim analizimin dhe verifikimin e diferencave në deklarime ose problematikave të tjera.

21.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DTM në bashkëpunim me DPT të vlerësojnë zgjidhje optimale në sistemin C@ts në drejtim të procedurave të aplikueshme për efekt të aplikimit automatik të penaliteteve për tatimpaguesit që kanë likuiduar me vonesë këstet e parapagimeve të tatim fitimit, pagesës së tatimpaguesit për këstin do të shkojë për detyrimin më të hershëm të tij, rivlerësimeve të kësteve apo edhe proporcionalitetit të parapagimeve të kësteve të tatim fitimit krahasimisht me tatim fitimin e periudhës, me qëllim përmirësimin e analizës së kryer për miratimin e kërkesave për rishikimin e kësteve të tatim fitimit, për të mundësuar një vendimmarrje sa më të drejtë të sektorit të kontrollit nga zyra për këtë çështje.

23.1 Rekomandimi: Nga DPT të merren masa për rishikimin e strukturës së Drejtorisë së Shërbimeve të Tatimpaguesve në DTM, referuar treguesve të performancës në rënie nga viti 2021 në vitin 2022, efektivitetit të kësaj drejtorie si dhe procesit të dixhitalizimit dhe rritjes së numrit të shërbimeve të ofruara online.

25.1 Rekomandimi: Titullari i DTM të marrë masa për përcjelljen e kësaj problematike pranë MFE, ku Struktura e Apelit Tatimor në MFE të shqyrtojë situatën e mësipërme, në mënyrë që të garantohet raportimi i informacionit në sistemin C@TS sipas përcaktimeve ligjore për rastet që janë në proces ankimi.

26.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimin dhe arkivimin e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike, me qëllim garantimin e saktësisë dhe plotësisë në administrimin e dokumentacionit. Komisionet e prokurimit të marrin masa që për çdo procedurë prokurimi të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke garantuar siguri dhe transparencë mbi procedurën e prokurimit blerje e vogël.

27. 1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa të menjëhershme për përcaktimin e efekteve të vlerësimeve alternative, me pasojë të ardhura tatimore të munguara në buxhetin e shtetit, si dhe në vijimësi, të ndjekë zbatimin e përcaktimeve ligjore në lidhje me respektimin e kostos minimale fiskale, çmimit minimal fiskal dhe fitimit minimal fiskal në sektorin e ndërtimit.

28.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj të merren masa menjëherë dhe në vijimësi të zbatohen me korrektësi procedurat dhe afatet e përcaktuara ligjore për ushtrimin e kontrollove tek tatimpaguesit.

29.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshme të Tatimeve, të merren masa dhe të bëhen përmirësime në aktet ligjore dhe nënligjore për përcaktimin e afatit maksimal nga përfundimi i përgatitjes së Projekt Raportit nga Inspektori deri në miratimin e tij nga eprorët (Përgjegjës Sektor/Drejtor).

29.2 Rekomandimi: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit për afatet të marrë masa për:

- Pasqyrimin në kohë të akteve të kontrollit (procesverbale, akt konstatime) në sistemin informatik tatimor;

- Të fillojë kontrollet duke respektuar afatet e njoftimit të kontrollit;
- Të përmirësojë procedurën e hartimit të raportit paraprak të kontrollit në kohë;
- Të mbajë komunikim të vazhdueshëm me tatimpaguesit për pasqyrimin e observacioneve dhe respektimin e afatit të përfundimit në kohë të raportit të kontrollit tatimor përfundimtar.

30.1 Rekomandimi: Titullari i DTM, në bashkëpunim edhe me DPT, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil sipas pozicioneve të miratuara në Urdhrin e Kryeministrit Nr.33, datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”.

3.4 LICENCIMI DHE MONITORIMI I SUBJEKTEVE ME VEPRIMTARI NË FUSHËN MINERARE

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditimin tematik në **Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore** (*këtu e në vazhdim MIE dhe AKBN*), me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në vitin 2023”, për auditimin mbi licencimin dhe monitorimin e subjekteve me veprimtari në fushën minerare, përcjellë me shkresën nr. 983/18 prot., datë 17.10.2024, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

Vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

Vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

Vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve;

Vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Regjistrin elektronik institucional të zbatimit të rekomandimeve.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 1325/7 prot., datë 04.11.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga grupi i audituesve i përbërë nga:

- H. S, përgjegjës i grupit të auditimit
- K. N, auditues
- R. G, auditues

Auditimi filloi më 04.11.2024 dhe përfundoi më 13.12.2024.

II/1. OBJEKTI I AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 983/18 prot., datë 17.10.2023, mbi veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së.

II/2. QËLLIMI I AUDITIMIT

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 të nenit 31 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II/3. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditimi i plotë i të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH për përmirësimin e gjendjes së subjekteve në të ardhmen.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III/1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti MIE dhe AKBN në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 983/18 prot., datë 17.10.2023, rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 11 rekomandime si masë organizative, nga ku janë pranuar 11 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 4 zbatuar plotësisht, 6 pa zbatuar, 1 zbatuar pjesërisht,
- Për marrjen e masave për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike janë lënë 5 rekomandime, të cilat janë pranuar dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit, 3 zbatuar pjesërisht, 1 në proces zbatimi dhe 1 pazbatuar.
- Për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, është lënë 1 rekomandim i cilat është pranuar dhe ka statusin e ecurisë së pazbatuar.

Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel 100%, konkretisht nga 17 rekomandime gjithsej, janë pranuar 17 rekomandime.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën 23.5%, niveli i zbatimit të rekomandimeve në proces zbatimi rezultoi 6%, niveli i rekomandimeve pa zbatuara rezultoi 47%, niveli i rekomandimeve zbatuara pjesërisht rezultoi 23.5%.

III/2. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

Nga auditimi i ushtruar në MIE dhe AKBN për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së, përcjellë me shkresën nr. 983/18 prot., datë 17.10.2023, rezultoi si më poshtë vijon:

A. Mbi hartimin e programit (Planit të veprimit) dhe respektimin e afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi ka rezultuar:

Në lidhje me hartimin e “Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se:

Me shkresën e KLSH nr. 983/18 prot., datë 17.10.2024 protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë të ushtruar në Agjencinë

Kombëtare të Burimeve Natyrore, sipas Programit të Auditimit me nr. 983/1 prot., datë 31.10.2022.

-Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, me shkresën nr. 1333/16 prot., datë 08.11.2023, gjithashtu, nga institucioni nuk ka patur kundërshtime për rekomandimet e KLSH, për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse, **pra janë pranuar të gjitha rekomandimet.** Drejtori Ekzekutiv ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kthyer përgjigje në tejkallim të afatit ligjor prej 20 ditëve, me shkresën nr. 8986/1 prot., datë 20.11.2023, gjithashtu, nga institucioni nuk ka pasur kundërshtime për rekomandimet e KLSH, për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse, **pra janë pranuar të gjitha rekomandimet, me përjashtim të rekomandimeve numër 10.1 dhe 11.1 për të cilat nuk është shprehur në planin e masave.** Gjithashtu është përgatitur programi i masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, drejtoritë përgjegjëse.

Në zbatim të afatit ligjor të përcaktuar në pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, e cila citon: “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*” rezultoi se:

- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore nuk ka përcjellë brenda afatit raportin mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve i cili duhet të dërgohej brenda afatit 6-mujor për statusin e zbatimit të tyre.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka përcjellë brenda afatit raportin mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve i cili duhet të dërgohej brenda afatit 6-mujor për statusin e zbatimit të tyre.

B. Zbatimi i rekomandimeve për masat organizative. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Në mënyrë më të detajuar, auditimi i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve për secilin rekomandim të përcjellë në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë paraqitet:

1.1. Rekomandimi: Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të merren masat për zbatimin e procedurës së licencimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare duke respektuar kushtet e detajuara dhe dokumentet shoqëruese për vlerësimin e përmbushjes së kushteve që duhet të plotësojnë aplikuesit për një leje minerare dhe procedura e trajtimit të kërkesave me afatet, të përcaktuara me aktet ligjore.

- MIE si organ i drejtimit politik i cili ushtron detyrat dhe funksionet e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, nëpërmjet Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minerave, midis të tjerave të sigurojë mbajtjen e kontakteve edhe me strukturat paralele në ministrinë e linjës, duke i dhënë MIE të gjitha kompetencat dhe mekanizmat ligjor për zgjidhjen e të gjitha çështjeve me institucionet e varësisë (AKBN) si dhe me ministrinë e linjës (MTM), për të shmangur procedurat e ri aplikimit për pajisje me leje minerare.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të marrë masat për revokimin e licencave të mësipërme me parregullsi dhe shkelje të rënda ligjore, nënligjore dhe rregullative në zbatimin e kritereve për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare.

Përgjigja e subjektit: Në planin e masave është parashikuar që Ministri i MIE do të ngrejë një grup pune për shqyrtimin me përparësi të këtij rekomandimi dhe zbatimin e tij bazuar në Ligjin

nr. 10304 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në vijim të këtij rekomandimi nga ana e MIE është konkluduar se ndërmarrje e një hapi të tillë si revokim i lejeve minerare të përmendura nga KLSH do të çonte në akte administrative absolutisht të pavlefshme të cilat do të sillnin edhe pasoja financiare për MIE.

Referuar nenit 108 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose

iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;

një veprim i tillë në mënyrë absolute do të ishte në kundërshtim me ligjin për sa i përket procedurës së nxjerrjes së tij dhe shkaqeve për të cilat do të fillonte procedura e revokimit.

Neni 48 i ligjit 10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” përcakton se: “Procedura e revokimit të lejes

1. Procedura e revokimit të lejes fillon, si rregull, me raportin e propozimit të strukturës përgjegjëse ose me kërkesë të zotëruesit të saj, kur ky i fundit ka plotësuar të gjitha detyrimet e saj. 2. Ministri, në bazë të propozimit të strukturës përgjegjëse, njofton zotëruesin e lejes minerare, duke specifikuar qëllimin e tij për të revokuar lejen minerare dhe arsyen e një veprimi të tillë. Njoftimi konsiderohet se është bërë, në rast se kanë kaluar 10 ditë kalendarike nga data e dërgimit me postë, në adresën që zotëruesi ka deklaruar në përmbajtjen e lejes minerare dhe nëse është publikuar në faqen zyrtare të ministrisë.

Zotëruesi i lejes minerare ka të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare. 3. Ministri vendos revokimin e lejes minerare 30 ditë kalendarike pas kalimit të afateve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni. Në rast se brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e dytë, të pikës 2, zotëruesi i lejes minerare paraqet argumente dhe prova të mjaftueshme që provojnë mungesën e shkaqeve, për të cilat është iniciuar revokimi, ministri vendos pushimin e procedurës së revokimit. 4. Në rastet e parashikuara shkronjën "a" të pikës 2 të nenit 47 të këtij ligji, zotëruesi duhet të njoftojë strukturën përgjegjëse jo më vonë se 1 vit para datës, në të cilën kërkohet revokimi. Njoftimi përmban arsyet e detajuara të mbylljes, dokumentacionin tekniko-ekonomik dhe planin e aktualizuar të rehabilitimit. Me marrjen e kërkesës, njësia përgjegjëse inspekton zonën dhe harton një raport që ia paraqet ministrit. 5. Revokimi në të gjitha rastet vendoset nga ministri, në bazë të raportit të strukturës përgjegjëse. 6. Kundër vendimit të ministrit bëhet ankim në gjykatën administrative, sipas legjislacionit në fuqi”.

Pra procedura e revokimit fillon me propozim të strukturave përgjegjëse në pikën 35 të nenit 2 të ligjit përkufizohet se: "Strukturë përgjegjëse" është institucioni shtetëror, i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për të siguruar zbatimin e këtij ligji. Për qëllime dhe në funksion të veprimtarisë inspektuese, strukturë përgjegjëse do të nënkuptojë Inspektoratin Shtetëror përkatës, të caktuar në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

Gjithashtu në të gjitha rastet e përmendura në raportin përfundimtar të KLSH nuk janë arsye për të filluar procedurën e revokimit të lejeve minerare, në neni 47 të ligjit 10304 datë 15.07.2010 në të cilat përcaktohen rastet se kur revokohet leja minerare përcaktohet se:

“Revokimi i lejes 1. Leja revokohet kur: a) pas dhënies së saj, konstatohet se në dokumentacionin e paraqitur për lejen minerare ka të dhëna të rreme apo se subjekti nuk përmbush kushtet e lejimit; a/1) konstatohet se zona e licencuar ka mbivendosje të plotë ose të pjesshme, me një leje minerare që është dhënë më parë konform legjislacionit në fuqi në atë

periudhë kohore. Në këtë rast, leja minerare, e cila është dhënë në një periudhë kohore të mëvonshme është e pavlefshme për zonën e mbivendosur dhe ministri e revokon atë vetëm për zonën e mbivendosur. b) zotëruesi i lejes minerare nuk fillon veprimtarinë minerare në afatin e përcaktuar më poshtë nga hyrja në fuqi e lejes: i) leje kërkim-zbulimi për të gjitha grupet e mineraleve, 120 ditë kalendarike; ii) leje shfrytëzimi për të gjitha grupet e mineraleve, 180 ditë kalendarike; c) zotëruesi i lejes minerare pezullon për 1 vit ose ndërpret veprimtarinë minerare, pa njoftuar më parë, jo më vonë se 90 ditë kalendarike, strukturat përgjegjëse të veprimtarisë minerare, duke përfshirë në njoftim dhe arsyet e këtij pezullimi ose ndalimi; ç) zotëruesi i lejes minerare, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e çdo viti në vazhdim, që i korrespondon datës së hyrjes në fuqi të lejes, nuk paraqet dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të planit të rehabilitimit, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të programit minimal të punës, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të investimit; d) zotëruesi nuk paguan rentën minerare sipas afateve të legjislacionit në fuqi; dh) zotëruesi i lejes së shfrytëzimit minerar të grupit të mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet apo grupit të mineraleve ndërtime vazhdon të përdorë praktika të dëmshme të shfrytëzimit të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, ose i drejton operacionet e punës në kundërshtim me projektin e miratuar; e) zotëruesi i lejes minerare nuk respekton kërkesat e planit të rehabilitimit, të planit të mbylljes së veprimtarisë minerare e të planit të menaxhimit të mbetjeve; ë) zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit dështon në realizimin e programit minimal të punës; f) zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për dy vjet radhazi dështon në realizimin e 90 për qind të vlerës së investimit, që ka parashikuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare; g) nuk kryen detyrat e lëna nga struktura përgjegjëse, brenda afateve të caktuara në vendimin e pezullimit, në përputhje me nenin 46 të këtij ligji; gj) zotëruesi nuk i paraqet informacionet e kërkuara nga struktura përgjegjëse, paraqet informacione të pavërteta apo pengon strukturën përgjegjëse në ushtrimin e funksioneve të inspektimit, në zbatim të këtij ligji; h) organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, ka revokuar lejen mjedisore; i) zotëruesi i lejes minerare nuk respekton kërkesat e shkronjës "c" të pikës 25 të nenit 36 të këtij ligji. j) Në rast se zotëruesi i lejes minerare shkel kërkesat e shkronjës "e", të pikës 1, të nenit 18.

2. Leja minerare, që përfshin shfrytëzimin minerar, revokohet edhe: a) me kërkesë të zotëruesit, kur ai ka plotësuar të gjitha detyrimet e lejes minerare; b) kur janë mbaruar rezervat gjeologjike dhe zotëruesi e kërkon revokimin e lejes; c) kur, për shkaqe natyrore apo gjeologjiko-minerare, bëhet e papërshtatshme për vazhdimin e shfrytëzimit; ç) kur vazhdimi i shfrytëzimit të minierës krijon premisa për rreziqe gjeologjike dhe mjedisore."

Në përfundim nisur nga shkaqet dhe arsyet e lartpërmendura jemi të mendimit se një rekomandim I tillë është I pa mundur të përmbushet pasi si pasojë do çonte në akte të cilat siç përmendëm më lartë do të ishin absolutisht të pavlefshëm dhe që nuk do të prodhonin asnjë pasojë pasi referuar nenit 108 të K. Pr. Administrative procedura e nxjerrjes së këtyre akteve do të ishte në kundërshtim me ligjin 10304 datë 15.07.2010. Gjithashtu për MIE do të kishte pasojë shumë të rënda financiare në procese gjyqësore të ardhshme për këto akte. Në lidhje me këtë revokim do të bëhen ndryshime në VKM 320 datë 21.04.2011, e cila do të parashikojë një mënyrë të re konkurrimi si dhe dokumentacion të përmirësuar për konkurrimin në zonat minerare konkurruese si do të adresohet edhe problematika e ngritur nga KLSH.

Komenti i grupit të auditimit: Nga auditimi në lidhje me këtë rekomandim konstatohet se është pranuar duke parashikuar ngritjen e grupit të punës për zbatimin e tij, ndërkohë që rezultoni të mos jetë marrë asnjë masë për revokimin e lejeve.

Ky rekomandim rezultoni i pranuar dhe i pazbatuar.

2.1. Rekomandimi: MIE, AKBN të marrë iniciativat për hartimin e akteve administrative nënligjore për të përcaktuar procedurën dhe afatet e pezullimit të përkohshëm, për rastin e kërkesës së vetë subjektit dhe të ndëshkimit nga strukturat përgjegjëse, në funksion të

disiplinimit dhe zhvillimit të sektorit mineral, me qëllim lehtësimin e veprimtarinë monitoruese dhe inspektuese të strukturave përgjegjëse, veçanërisht të AKBN në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e planeve vjetore, ndëshkimin për mos dorëzimin në afat të dokumentacionit teknik dhe financiar, si dhe kryerjen e raportimin e monitorimeve.

Përgjigja e subjektit:

Në planin e masave është përcaktuar DM së bashku me Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore për hartimin/përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse. Drejtoria Minerare pranë AKBN-së në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Shërbimeve ka marrë masat e nevojshme për hartimin/përmirësimin e ligjit mineral 10304. Është dërguar pranë MIE me shkresën nr.1156 prot datë 09.02.2024 “Propozimi për disa shtesa mbi ligjin 10304 i shoqëruar dhe me draft-projektin”. Në këtë propozim është parashikuar përcaktimi i afateve të pezullimit të përkohshëm të aktivitetit mineral të kërkuar nga vetë subjekti dhe mos miratimi i pezullimit të përkohshëm në rastet kur kjo kërkesë vjen gjatë tre viteve të para të lejes minerare.

DM pranë AKBN-së në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, ka dërguar në MIE shkresën me nr.1333/17 datë 13.11.2023 për të zgjidhur këtë ngërç ligjor, mbi të drejtën e dhënies së miratimit të pezullimit të përkohshëm të aktivitetit mineral shoqëruar me afatet e pezullimit, nga ana e MIE-s është kthyer përgjigje me shkresën nr. 4764/14 prot (MIE) datë 24.11.2023 në të cilën citon se janë në përgatitjen e një udhëzimi për përcaktimin e procedurës dhe afateve të pezullimit të përkohshëm.

Komenti i grupit të auditimit:

Në referencë të akteve të administruar për veprimet e AKBN për zbatimin e këtij rekomandimi konstatohet se janë ndërmarrë iniciativat përkatëse për ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore për pezullimin e përkohshëm.

Ky rekomandim rezultoi pranuar dhe zbatuar plotësisht.

3.1. Rekomandimi: MIE, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masat për të kualifikuar shpallur fitues subjekte të cilët në përputhje me procedurën konkurruese plotësojnë kriteret e konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën kombëtare të Biznesit për zonat minerare konkurruese.

- Për sa konstatuar nga auditimi mbi procedurën e shpalljes dhe konkurrimit të zonës minerare nr.270/5, MIE të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për revokimin e lejes minerare nr. 1943, datë 17.02.2023 të subjektit “B S” SHPK, për shkak se shoqëria e mësipërme nuk plotëson asnjë nga kushtet thelbësore të kërkesave ekonomiko-financiare, teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin e kontratës.

Përgjigja e subjektit:

Në planin e masave është parashikuar ndryshimi i VKM-së nr.320, datë 21.04.2011“Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar, ku të përcaktohen në mënyrë më të detajuar kriteret e konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën Kombëtare të Biznesit për zonat minerare konkurruese dhe që Ministri i MIE do të ngrejë një grup pune për të shqyrtuar dokumentacionin e shoqërisë "B S" shpk, bazuar në Ligjin nr. 10304 “Për Sektorin Mineral në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Vonesat në lidhje me ndryshimin e VKM-së kanë ardhur si pasojë e përfshirjes së kësaj procedure në shërbime të cilat do të ofrohen nëpërmjet platformave on-line. Në lidhje me propozimin e revokimit të lejes së sipërpërmendur është konkluduar se revokimi i kësaj leje do të ishte një veprim absolutisht i pavlefshëm i cili do të sillte pasojë për MIE.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi në lidhje me këtë rekomandim konstatohet se është pranuar ndërkohë që nuk janë kryer propozimet për ndryshim e VKM nr. 320 datë 21.04.2011 dhe në të njëjtën kohë nuk janë marrë masa për revokimin e lejes minerare të subjektit “B S” SHPK.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pazbatuar.

4.1. Rekomandimi: AKBN, Strukturat Përgjegjëse në plotësim të kuadrit ligjor dhe rregullator të miratuar:

- Të hartojnë dhe miratojnë një udhëzues të detajuar, ku të pasqyrohen të dhënat mbi procedurat e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e të domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen.
- të kryejnë inspektimin çdo 6 muaj të të gjitha subjekteve minerare dhe të miratojnë planet vjetore të punës të subjekteve-zotërues të lejes minerare;
- Të marrin masat për të përputhur treguesit e paraqitur në raportet e mbikëqyrjes dhe monitorimit me treguesit e raportuar në sistemin Revzone dhe treguesit e planit vjetor të miratuar të veprimtarisë minerare të dërguara online nga subjektet AKBN.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për rastet e moskryerjes së inspektimeve dhe mbikëqyrjeve nga AKBN sipas ligjit të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive apo rishikimin e kapaciteteve njerëzore dhe fondeve në dispozicion të kësaj strukture.

Përgjigja e subjektit:

DM-re pranë AKBN-së në zbatim të ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, i ndryshuar, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, akteve nënligjore që rrjedhin prej tij dhe V.K.M-së nr.547, datë 09.08.2006 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, ka marrë masat e nevojshme mbi hartimin dhe miratimin e një udhëzuesi të detajuar, ku janë pasqyruar të dhënat mbi procedurën e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e të domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen. Ketë projekt draft e kemi dërguar ne MIE me shkresën nr. 5796 prot (AKBN) datë 28.12.2023.

Referuar detyrave të lëna AKBN me shkresën nr.5769 prot (AKBN) date 26.12.2023 kemi dërguar ne MIE parashikimin e monitorimit për vitin 2024 ne zbatim të urdhrit 382 date 20.05.2011.

Gjatë periudhës së vitit 2024 të ardhurat financiare të AKBN kanë qenë të pamjaftueshme për kryerjen e monitorimit sipas parashikimeve të bëra. Në mënyrë të vazhdueshme AKBN ka njoftuar këshillin Drejtues dhe Ministrin në lidhje me fondet e pamjaftueshme për kryerjen e monitorimit të aktivitetit minerar dhe të atij post minerar. (shkrese nr.3320 prot AKBN date 14.07.2023)

Sipas VKM 506, datë 01.8.2024 “Mbi disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin 547 datë 09.08.2006 të Këshillit të Ministrave për krijimin e AKBN të ndryshuar”, sipas këtij vendimi AKBN do të sigurojë të ardhura financiare nga shërbimet që kryhen sipas veprimtarisë së saj në fushën minerare, hidrokarbure, energjitike si dhe tarifa të tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Sigurimi i këtyre të ardhurave të cilat do të depozitohen në llogari të AKBN, do të krijojë mundësinë për realizimin e detyrave të drejtorisë minerare lidhur me monitorimet dhe detyrat funksionale të saj.

Për raportimet në sistemin RevZone, në mënyrë të vazhdueshme AKBN ka njoftuar në rrugë elektronike operatorët ekonomikë që zotërojnë leje shfrytëzimi (plotësim i saktë mbi prodhimin, shitjen, rentën minerare, nr e punonjësve etj) me qëllim përputhshmërinë e të dhënave të raportuara me mbikëqyrjen e aktivitetit minerar dhe detyrimet e zotëruesve të Lejeve. Ky rekomandim është realizuar menjëherë nga Sektori përkatës në DM që në deklaratimet e realizuara nga subjektet për 6 mujorin e I-rë 2024. Gjithashtu, duke vazhduar praktikën e deritanishme, do të vazhdojë komunikimi me Institucionet e tjera (Tatime, dogana, etj) në lidhje me përputhshmërinë e të dhënave të vetë deklaruara. për raportimet vjetore 2023 janë marre 10 masa me gjobë ndaj subjekteve të cilat nuk kanë raportuar në përputhje me detyrimet e përcaktuara.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion për zbatimin e këtij rekomandimi

rezulton se është hartuar por nuk është miratuar udhëzimi për procedurat e kryerjes së monitorimit, nuk janë inspektuar në 6-mujor të gjitha subjektet minerare si pasojë e mungesës në burime dhe janë marrë masa për rakordimin e treguesve të mbikëqyrjes/monitorimit me ato në revzone. Duke qenë se nuk janë përmbushur të gjithë parashikimet e rekomanduara sipas gjetjes përkatëse, rekomandimi vlerësohet pjesërisht i zbatuar.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

5.1. Rekomandimi: Nga AKBN të merren masat që gjatë shqyrtimit të dosjeve të planeve të respektohen forma e informacioneve tremujore e vjetore përfundimtare dhe përmbajtja e planeve vjetore të punës nga ana e zotëruesit të lejes minerare të shfrytëzimit në karriera për grupin e mineraleve jometalore me qëllim shlyerjen e detyrimeve të Lejes Minerare të Shfrytëzimit.

Përgjigja e subjektit:

Komisioni i Shqyrtimit dhe Miratimit të Planeve Vjetore të Punës, funksionon mbi bazën e rregullore së Miratuar nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së me Urdhër nr.122 datë 05.06.2023. Gjatë veprimtarisë së tij, ky komision, ka respektuar në mënyrë rigorozë këtë rregullore duke Miratuar/Mos Miratuar planet vjetore të punës. Janë ndjekur të gjitha afatet ligjore për shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet private dhe dokumenti zyrtar përkatës është dërguar brenda afateve.

Gjate vitit 2023 janë shqyrtuar dhe kthyer përgjigje: 361 miratime, 68 kthim përgjigje dhe 61 mosmiratime. Për vitin 2024 janë 408 miratime, 25 mosmiratime dhe 36 kthim përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi mbi verifikimin e zbatimit të këtij rekomandimi referuar veprimtarisë së Komisionit të Shqyrtimit dhe Miratimit të Planeve Vjetore të Punës dhe përcaktimeve të aktit Rregullor miratuar me Urdhër nr. 122 datë 05.06.2023 të Drejtorit Ekzekutiv dhe të dhënave për aktivitetin e vitit 2024, vlerësohet se janë marrë masat për shqyrtimin e planeve në vijimësi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

6.1. Rekomandimi: AKBN të marrë masat për të mbajtur të azhornuar regjistrin e lejeve sipas viteve me rastet e pezullimeve dhe revokimeve.

- AKBN, struktura përgjegjëse të marrin masat për të ushtruar të drejtat dhe detyrimet e tyre lidhur me plotësimin dhe zbatimin nga subjektet minerare të planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare dhe planit të menaxhimit të mbetjeve minerare; sigurimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve; realizimin e programit të investimit, të parashikuar në planin vjetor të veprimtarive minerare dhe projektin e zhvillimit të këtyre veprimtarive; të informacioneve dhe shpjegimeve, jo më pak se 1 vit para, nëse kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar etj. Në rastet e mosplotësimit dhe mos zbatimit të tyre të kërkojë vendosjen e masa administrative gjobë, për subjektet minerare.

Përgjigja e subjektit:

Drejtoria Minerare pranë AKBN-së ka mbajtur dhe vazhdojë të mbajë të azhornuar regjistrin e lejeve minerare lidhur me të gjitha ndryshimet që bëhen për lejen minerare si: revokimet, pezullimet, ç'revokimet, ndryshim Administratori, drejtues teknik etj. Gjithashtu, janë marrë masat që subjektet e Revokuara, të mos kenë të drejta hyrje në sistemin elektronik RevZone për deklarim prodhim/shitje/rentë. Leje minerare aktive deri në tetor 2024 janë 542 leje, të revokuara gjatë vitit 2024 janë 24 nga të cilat 20 janë për mos pagesë të garancisë së rehabilitimit dhe 4 për arsye të tjera.

- Përsa i përket zbatimit të planit të rehabilitimit dhe menaxhimit të mbetjeve minerare, sqarojmë se: Shumica e objekteve minerare aktive, janë në zhvillim e sipër te aktivitetit minerar të shfrytëzimit dhe nuk janë plotësuar kushtet teknike për zbatimin e rehabilitimit progresiv/përfundimtar të mjedisit. Në rastet kur kanë mbaruar rezervat/shfrytëzimi,

rehabilitimi progresiv është realizuar në ato leje minerare të cilat kanë prodhim të madh si psh. Fabrikat e çimentos (A C, F K C F, S, M B etj). Në shqyrtimin e programeve vjetore të punës për karrierat në qiell të hapur, aty ku është e mundur, subjekteve i është lënë detyrë për realizim të rehabilitimit progresiv.

Për çdo vit kalendarik subjektet depozitojnë në thesarin e shtetit Garancinë e rehabilitimit të mjedisit, përcaktuar sipas Akt-miratimit të lejes minerare. Kjo pagesë është llogaritur sipas Udhëzimit nr. 718 date 03.10.2011 “ Për mënyrën e vlerësimit të garancive financiare të lejeve minerare”, ky vlerësim është ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 30.07.2024 në të cilin janë rritur vlerat 1.5 deri në 2 herë lidhur me shpenzimet që duhen për rehabilitimin e 1 ha sipërfaqe të prekur nga shfrytëzimi apo mbylljen e grykave të galerive.

Në çdo rast të mos pagesës së garancisë së rehabilitimit nga ana e AKBN janë propozuar në MIE masat për revokimin e tyre. - Megjithëse plani i investimeve në objektet minerare përcaktohet qartë si në projektin fillestar të hapjes së objektit, ashtu edhe në Akt Miratimit e MIE, AKBN si strukturë përgjegjëse ka verifikuar pagesën e garancisë së investimit e cila është 10% e vlerës së vitit maksimal të investimit. Kjo vlerë paguhet në momentin e marrjes së lejes minerare dhe depozitohet në thesarin e shtetit.

Komenti i grupit të auditimit:

Në referencë të shpjegimeve nga subjekti i audituar dhe dokumentacionit mbi regjistrin e përditësuar të lejeve minerare deri në tetor 2024 (megjithëse në faqen web të institucionit gjendet i publikuar deri në Shkurt 2023) rekomandimi vlerësohet i zbatuar plotësisht.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

7.1. Rekomandimi: AKBN të marrë masat për njoftimin e subjektit menjëherë me përshkrimin e arsyes së pezullimit për shkeljet që bëhen shkak për pezullim, të konstatuara nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit dhe në të njëjtën kohë ti propozojnë Ministrin për masat e penalitetet që duhet të ndërmerren ndaj subjekteve që nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit minerar mbi bazën e rezultateve të mbikëqyrjes dhe monitorimit të veprimtarive minerare.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim është zbatuar dhe zbatohet rigorozisht nga Drejtoria Minerare pranë AKBN-së duke respektuar Ligjin Minerar, VKM-të dhe Urdhërata në zbatim të tij.

Komenti i grupit të auditimit:

Për zbatimin e këtij rekomandimi nuk janë paraqitur evidenca bazuar në gjetjen e auditimit për marrjen e masave për pezullim në rastet e konstatimeve në raportet e monitorimit apo si rezultat i mbikëqyrjes të shkaqeve për pezullim.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

8.1. Rekomandimi: AKBN në cilësinë e strukturës përgjegjëse të marrë masat dhe të ushtrojë kompetencat e saj për t'i propozuar MIE revokimin e lejeve minerare për ato subjekte që ushtrojnë veprimtari minerare dhe nuk japin informacionin e kërkuar nga strukturat përgjegjëse, paraqesin informacione të pavërteta, apo pengojnë strukturën përgjegjëse në ushtrimin e funksioneve të inspektimit, në zbatim të këtij ligji.

Përgjigja e subjektit:

Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, ka marrë dhe do vazhdojë të marrë masat administrative mbi propozimin për revokim të lejes minerare ndaj subjekteve që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara sipas Ligjit minerar, VKM-së dhe Urdhërave përkatës. Nga Sektori i procedurave, statistikës, koordinimit dhe GIS, janë marrë dhe do vazhdojnë të merren masat administrative, propozim për revokim të lejes minerare ndaj subjekteve që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara sipas Ligjit minerar, lidhur me pagesën e garancisë së rehabilitimit. Gjatë vitit 2023 nga sektori i monitorimit metalorë janë propozuar për revokim 14 leje minerare, dhe nga sektori

jometallore janë propozuar 10 leje minerare. Masat administrative për Sektorin jometallore për vitin 2023 janë: Masë Administrative pezullim aktiviteti 1 subjekt; Masë Administrative në vlerë 500 000 lekë, për 1 subjekt; Gjatë vitit 2024 janë propozuar 7 subjekte për revokim të lejes minerare të cilat nuk kanë paguar garancinë e rehabilitimit të mjedisit.

Komenti i grupit të auditimit:

Në referencë të shpjegimeve të subjektit të audituar për këtë rekomandim është konstatuar se nuk janë marrë masa për revokimin e lejeve minerare për subjektet të cilat nuk kanë raportuar apo kanë raportuar të dhëna të pavërteta, pasi masat e marra nga AKBN për revokim leje janë marrë në vitin 2024 për mos pagesë të garancisë së rehabilitimit të mjedisit.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pa zbatuar.

9.1. Rekomandimi: Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të ushtrijë përgjegjësive sipas përcaktimeve ligjore në zbatimin e politikave dhe strategjisë së zhvillimit të sektorit minerar dhe ushtrimin e një roli më aktiv në drejtim të heqjes nga fondi pyjor e kullësor, të zonave të lejuara të shfrytëzimit pronë shtetërore si dhe ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullësor, nga zëri *“Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”*, dhe regjistrimit në zërin *“Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”*.

Përgjigja e subjektit:

Në planin e masave është parashikuar që do të propozohen ndryshimet përkatëse të kuadrit ligjor minerar për zbatimin e këtij rekomandimi në lidhje me heqjen e zonës së lejuar për shfrytëzim, nga fondi pyjor e kullësor, pronë shtetërore, zëri *“Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”* dhe regjistrimin në zërin *“Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”*. MIE do t'i propozojë ministrisë përgjegjëse për mjedisin, ndërmarrë ndryshimet ligjore përkatëse, për të mundësuar që procedura për heqjen e zonës së lejuar për shfrytëzim, nga fondi pyjor e kullësor, pronë shtetërore, zëri *“Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”* dhe regjistrimin në zërin *“Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”*, të kryhet njëkohësisht me procedurën e pajisjes së subjektit me lejen mjedisore përkatëse. Në lidhje me rekomandimin e mësipërm problematika e ngritur është përmirësuar në draftin e ndryshimeve të ligjit 10304 datë 15.07.2010 *“Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë i cili është në fazat e fundit të miratimit të tij”*

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi dhe dokumentacioni i vendosur në dispozicion për projekt ligjin e propozuar të ndryshimeve të ligjit 10304 datë 15.07.2010 *“Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”*, i cili është në fazat e dhënies së mendimit nga ministrinë e tjera të linjës, konstatohet se janë ndërmarrë masat për zbatimin e rekomandimit

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar plotësisht.

10.1. Rekomandimi: AKSEM të marrë masat për kryerjen e plotë dhe në mënyrë të vazhdueshme të inspektimeve në veprimtaritë minerare dhe ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave energjetike për verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë e mbrojtjen e shëndetit të punonjësve gjatë veprimtarisë së tyre në minierat nëntokësore dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, minierat sipërfaqësore, fabrikat e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve.

Përgjigja e subjektit:

Subjekti i audituar nuk është shprehur në planin e masave për zbatimin e rekomandimeve.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga ana e subjektit të audituar nuk janë vendosur në dispozicion informacione dhe dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pazbatuar.

11.1. Rekomandimi: MIE dhe AKBN të marrin masa të përshpejtuara për të siguruar nga:

- MIE monitorimin zyrtar për burimet e Kozelit, duke arritur në një rezultat në këtë drejtim;
- AKBN, institucion në varësi të MIE monitorimin e përvitshëm këtyre HEC-eve.
- MIE të ezaurojë plotësisht dhe në kohë detyrimin për mbarëvajtjen e koncesionit, të përcaktuar në pikën 7.6 të kontratës koncesionare me nr.119 Rep., dhe nr.94 Kol., të datës 12.01.2011 midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “K-K” SHPK dhe “L V T” SHPK.

Përgjigja e subjektit:

Subjekti i audituar nuk është shprehur në planin e masave për zbatimin e rekomandimeve.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga ana e subjektit të audituar nuk janë vendosur në dispozicion informacione dhe dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pazbatuar.

C. Zbatimi i rekomandimeve për masa për eliminimin e efekteve negative. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: rekomandime të pranuar dhe nga këto, sa janë zbatuar plotësisht; zbatuar pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pazbatuara.

1.1. Rekomandimi: Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative të vlerësojë dhe shqyrtojë provat e sjella nga subjekti për shfuqizimin e masave administrative të marra ndaj zotërueseve të lejeve minerare nëse janë të mjaftueshme për të marrë vendim shfuqizimi ose lënien në fuqi të aktit administrativ, me argumentimin e zbatimit të drejtë të procedurave dhe ligjshmërinë në veprimet apo mosveprimet, për të cilat ankuesi ka pretenduar shkelje.

Përgjigja e subjektit:

Nga ana e subjektit të audituar është parashikuar vlerësimi dhe shqyrtimi më i detajuar i provave të sjella nga subjektet, nga Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative. Në vijimësi është përmirësuar standardi i marrjes së provave gjatë procesit, komisioni ka kërkuar informacion dhe prova shtesë edhe nga strukturat përgjegjëse të cilat kanë konstatuar shkeljet.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi konstatohet se në planin e masave dhe si praktikë për shqyrtimin e masave administrative është parashikuar marrja e informacioneve dhe provave shtesë, ndërkohë që nuk është paraqitur dokumentacion referuar vendimmarrjes për shfuqizimin ose lënien në fuqi të Vendimit nr.431, datë 16.09.2022.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

2.1. Rekomandimi: AKBN, Strukturat Përgjegjëse në plotësim të kuadrit ligjor dhe rregullator të miratuar:

- të miratojnë programe periodike ose të posaçëm, për të ushtruar kontrole në çdo veprimtari minerare; duke hartuar raporte për mbikëqyrjen e monitorimin e këtyre subjekteve për çdo 6-mujor; ku të shprehen për numrin e punëtorëve, realizimin e prodhimit, treguesit teknologjikë, realizimin e investimeve, realizimi i shitjeve brenda dhe jashtë vendit, të ardhurat e realizuara nga shitjet brenda vendit dhe eksportet, realizimi i rentës minerare; etje.

Përgjigja e subjektit:

AKBN në zbatim të ligjit minerar nr. 10304 date 15.07.2010, i ndryshuar, neni 43 pika 3 harton dhe çdo 6-muaj raportin e veprimtarisë minerare të subjekteve për mineralet metalore dhe jometalorë ku pasqyrohen realizimi i prodhimit, numri i punëtorëve, pagesa e rentës minerare, pagesa e garancisë së rehabilitimit, realizimin e shitjeve brenda dhe jashtë vendit, të ardhurat e realizuara etj. Referuar detyrave të lëna AKBN me shkresën nr.5769 prot (AKBN) date

26.12.2023 kemi dërguar në MIE parashikimin e monitorimit për vitin 2024 në zbatim të urdhërit 382 datë 20.05.2011.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga subjekti i audituar mbi monitorimin rezulton se është kryer monitorimi për vitin 2023 dhe monitorimin për periudhën e 6-mujorit të parë të vitit 2024 (i pa miratuar ende dhe në versionin draft) së bashku me parashikimin e monitorimit për vitin 2024.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

3.1. Rekomandimi: AKBN në zbatim të kërkesave të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 të marrë masat për nisjen e procedurës së vjeljes së detyrimit në shumën **27,200 mijë** lekë si masa administrative ndaj 121 subjekteve zotërues të lejeve minerare me qëllim disiplinimin e veprimtarisë së sektorit minerar.

Përgjigja e subjektit:

Në planin e masave të miratuar nga Drejtori Ekzekutiv është parashikuar që *“DM-re në bashkëpunim dhe me Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore ka marrë të gjitha masat e nevojshme lidhur me vjeljen e të gjitha detyrimeve, si masa administrative të marra ndaj subjekteve dhe të lëna në fuqi”*.

Komenti i grupit të auditimit:

Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria Minerare dhe Drejtoria Ligjore pranë AKBN rezulton se lista e masave administrative gjoha ndaj subjekteve minerare për procedura të mëtejshme i është dërguar Drejtorisë së Shërbimeve Juridike:

- me shkresën nr. 4257 datë 19.10.2022, për 132 masa, pasi 7 masa administrative janë shfuqizuar. Për këto 139 masa në vlerën 14,200,000 lekë, janë në ndjekje prej Drejtorisë Ligjore në AKBN 132 masa në vlerën 13,400,000 lekë pasi 7 masa administrative në vlerën 800,000 lekë janë shfuqizuar nga Komisioni i Apelit në MIE;

- me shkresën nr. 4487 datë 25.10.2022 për 11 masa për vonesa në raportim që lidhen me 6 mujorin e parë, me shkresën nr. 1195 datë 20.02.2023 për 19 masa administrative për mos dorëzim të planit të punës dhe me shkresën nr. 2145 datë 24.04.2023 për 42 masa nga të cilat 27 masa për vonesa në raportim që lidhen me 6 mujorin e parë dhe 15 masa për mos raportim për informacionin vjetor në total për 72 masa. Për këto 72 masa në vlerën 11,800,000 lekë, janë në ndjekje prej Drejtorisë Ligjore në AKBN 64 masa në shumën 11,000,000 lekë pasi 8 masa administrative në shumën 800,000 lekë janë shfuqizuar nga Komisioni i Apelit në MIE.

Në total rezultojnë të jenë në ndjekje të Drejtorisë Ligjore 196 masa sipas katër shkresave për marrjen e masave nga Drejtoria Minerare në shumën 24,400,000 lekë.

Statusi i masave në ndjekje nga Drejtoria Ligjore paraqitet:

-për 38 masa në shumën 2,850,000 lekë janë depozituar në gjykatë kërkesat për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit;

-për 79 masa në shumën 11,200,000 lekë, 37 prej tyre janë kthyer nga Posta Shqiptare (problematikë adresat jo të sakta të subjekteve minerare dhe 42 prej tyre Posta Shqiptare nuk ka informacion nëse subjektet kanë marrë dijeni apo jo për to.

-për 22 masa administrative në shumën 3,050,000 lekë janë në proces duke u trajtuar nga Drejtoria Ligjore, po përgatiten kërkesat për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit;

-për 14 masa në shumën 1,800,000 lekë ka pasur ekzekutim vullnetar nga ana e subjekteve minerare;

-për 15 masa në shumën 2,000,000 lekë janë në proces gjyqësor, nga të cilat 1 proces gjyqësor i fituar (pritet zbardhja e vendimit të gjykatës), 1 proces është lëshuar urdhri i ekzekutimit nga Gjykata, 3 të humbura sipas vendimit nr. 1390 datë 05.06.2023 pa të drejtë animimi dhe 10 masa janë në Gjykatën Administrative të Apelit (Ankime të veçanta).

-për 28 masa në vlerën 3,500,000 lekë janë në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm me

përmbaram.

Përsa më sipër, nuk ka përfunduar procesi i mbledhjes së detyrimeve, arkëtimi është kryer vetëm për një pjesë të vogël të detyrimit dhe ka ende masa të cilat janë në proces trajtimi pa kaluar në gjykatë apo të pa njoftuara subjekteve.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

4.1. Rekomandimi: AKBN në të ardhmen të mara masat për hartimin e raporteve të monitorimit me një informacion të plotë dhe të detajuar për zbatimin e planit të rehabilitimit, zbatimin e procedurave të mbylljes së minierave të braktisura të shfrytëzuar nga shteti, si dhe hartimi i një pasqyrimi të plotë për zonat e lejeve minerare të propozuara për konservim me qëllim rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike si investime në hartimin e raporteve vjetore mbi monitorimin e fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura.

Përgjigja e subjektit:

Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, sektori i Akt-verifikimeve dhe monitorimit postminerar, në zbatim të detyrave të lëna ka hartuar tabelat përkatëse sipas llojit të mineralit shoqëruar me vendimet e Këshillit të Ministrave për mbylljen e tyre dhe varësia administrative.

Me shkresën nr. 2198 prot, date 23.04.2024 është dërguar në MIE lista e subjekteve të revokuara ndër vite dhe pas verifikimeve në arkiven teknike të AKBN, me shkresën nr.2198/4 prot. datë 19.9.2024, kemi dërguar në MIE lejet minerare të cilat kanë një vendim për mbyllje të aktivitetit minerar, të miratuar nga Këshilli Teknik i AKBN-së. Sa me sipër jemi në pritje të një përgjigje nga MIE lidhur me lejet e revokuara të cilat kemi dërguar, duhet të kalojnë në mbyllje dhe monitorim postminerar apo konservim dhe monitorim postminerar.

Lidhur me rehabilitimin mjedisor në ish minierat, dampat e sterileve, stoqet e sterileve dhe mineraleve nga monitorimi ka rezultuar se një pjese e sipërfaqeve është rehabilituar në mënyrë natyrale. Pjesa më e madhe e tyre nuk janë rehabilituar kjo e përshkruar dhe në projektin vjetor të vitit 2023 me temë “Gjendja Mjedisore në Industrinë Minerare dhe Metalurgji”. Për mungesë të fondeve për vitin 2023 nuk është bërë e mundur monitorimi postminerar në pjesën më të madhe të ish minierave. Për vitin 2024 është realizuar rreth 75% e monitorimit postminerar, deri në fund të vitit mendojmë të realizohet dhe monitorimi postminerar për pjesën e mbetur të ish minierave.

Komenti i grupit të auditimit:

Në referencë të dokumentacionit të përcjellë për tabelat sipas llojit të mineralit dhe njoftimit të MIE me shkresa zyrtare konstatohet se nga AKBN janë ndërmarrë veprime për zbatimin e rekomandimit. Megjithatë, duke qenë se nuk ka një përgjigje nga MIE dhe në të njëjtën kohë ka pasur mungesë fondesh për kryerjen e monitorimit vlerësohet se nuk është kryer monitorimi post minerar në pjesën më të madhe të ish-minierave.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe në proces zbatimi.

5.1. Rekomandimi: MIE dhe “A” SHA të marrin masat për rivlerësimin e aktiveve afatgjata pasuri sipërfaqësore që administrohen nga “A” SHA në likuidim e sipër, të cilat janë kontabilizuar sipas të dhënave që i përkasin periudhës 1970 e në vijim, për përputhjen e gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me dokumentacionin financiar me qëllim pasqyrimin e vërtetë të vlerave të këtyre pasurive.

- Nga MIE të përshpejtohet procesi ligjor i likuidimit të këtyre shoqërive, deri në shkrirjen dhe çregjistrimin përfundimtar të këtyre shoqërive duke evituar shpenzimet e konsiderueshme që i ngarkohen buxhetit të shtetit për kostot e stafit administrativ të minierave, shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe shpenzimet për kontraktimin e ekspertëve kontabël me status “Sha në likuidim e sipër” pasi këto shoqëri nuk kryejnë asnjë aktivitet prodhues por vetëm monitorimin e minierave dhe asetëve. Gjithashtu nga MIE, të studiohet dhe gjykohet mundësia e bashkimit me anë të përthithjes së të këtyre tre sha-ve që operojnë në sektorin e

industrisë minerare, në një shoqëri më vete, e cila duhet të realizojë procedurat e likuidimit të shoqërisë dhe të përjashtohet nga skema e financimit buxhetor.

- Nga MIE të merren masat për koordinimin dhe bashkërendimin me shoqëritë në likuidim e sipër, për rastet kur këto pasuri, galeri dhe zona minerare, jepen për shfrytëzim sipas lejeve të shfrytëzimit, për zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit, që janë pjesë e këtyre shoqërive në likuidim e sipër.

Përgjigja e subjektit:

Nga subjekti i audituar është përcaktuar që do të kryhet rivlerësimi i aktiveve afatgjata pasuri sipërfaqësore që administrohen nga shoqëria "A" SHA, si dhe do të kryhet përputhja e gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me dokumentacionin financiar të shoqërisë. Në të njëjtën kohë është parashikuar që t'i ri propozohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë bashkimi me anë të përthithjes së tre shoqërive "A" SHA, "A" SHA dhe "A" SHA në një shoqëri më vete. Nga subjekti i audituar është referuar se është proces në vazhdimësi pasi vlerësimi i aseteve me vlerën aktuale kërkon ekspert përkatës si dhe fonde të cilat do të parashikohen në PBA për kryerjen e këtij procesi.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga auditimi mbi verifikimin e zbatimit të këtij rekomandimi konstatohet se nuk janë vendosur në dispozicion dokumentacion për nisjen e procesit të rivlerësimit të aktiveve apo referimit për bashkimin me përthithje të shoqërive të rekomanduara. Për këtë proces nuk janë parashikuar fonde në PBA përkatëse të viteve buxhetore.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pazbatuar.

D. Mbi zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, geramat (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, i rekomandohet Titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë disiplinore për drejtuesit e institucioneve të audituara, si dhe këto të fundit për punonjësit e varësisë sipas përgjegjësisë individuale dhe funksioneve zyrtare që mbajnë, si dhe të nisin procedurat për dhënien e masave disiplinore, në përputhje me kuadrin ligjor të rregullimit të marrëdhënieve përkatëse të punës.

Përgjigja e subjektit:

Subjekti i audituar AKBN dhe MIE nuk është shprehur në planin e masave për zbatimin e rekomandimeve.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga ana e subjektit të audituar nuk janë vendosur në dispozicion informacione dhe dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe i pazbatuar.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 983/18 prot., datë 17.10.2023, është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **11** rekomandime si masa organizative, nga ku janë pranuar **11** të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, **4** zbatuar plotësisht, **6** pa zbatuar, **4** zbatuar pjesërisht.

b. Për marrjen e masave për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike janë lënë 5 rekomandime, ku 5 rekomandime janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 pazbatuar, 1 në proces zbatimi dhe 3 zbatuar pjesërisht.

c. Për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, janë lënë 8 rekomandime të cilat janë pranuar dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit **pazbatuar**.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për sa më sipër, rikërkojmë që Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar, si dhe përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi, brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025.

MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të merren masat për zbatimin e procedurës së licencimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare duke respektuar kushtet e detajuara dhe dokumentet shoqëruese për vlerësimin e përmbushjes së kushteve që duhet të plotësojnë aplikuesit për një leje minerare dhe procedura e trajtimit të kërkesave me afatet, të përcaktuara me aktet ligjore.

- MIE si organ i drejtimit politik i cili ushtron detyrat dhe funksionet e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, nëpërmjet Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minerave, midis të tjerave të sigurojë mbajtjen e kontakteve edhe me strukturat paralele në ministritë e linjës, duke i dhënë MIE të gjitha kompetencat dhe mekanizmat ligjor për zgjidhjen e të gjitha çështjeve me institucionet e varësisë (AKBN) si dhe me ministritë e linjës (MTM), për të shmangur procedurat e ri aplikimit për pajisje me leje minerare.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të marrë masat për revokimin e licencave të mësipërme me parregullsi dhe shkelje të rënda ligjore, nënligjore dhe rregullative në zbatimin e kriterëve për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e minerare.

3.1. Rekomandimi: MIE, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave të marrin masat për të kualifikuar shpallur fitues subjekte të cilët në përputhje me procedurën konkurruese plotësojnë kriteret e konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën kombëtare të Biznesit për zonat minerare konkurruese.

- Për sa konstatuar nga auditimi mbi procedurën e shpalljes dhe konkurrimit të zonës minerare nr.270/5, MIE të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për revokimin e lejes minerare nr. 1943, datë 17.02.2023 të subjektit “B S” SHPK, për shkak se shoqëria e mësipërme nuk plotëson asnjë nga kushtet thelbësore të kërkesave ekonomiko-financiare, teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin e kontratës.

4.1. Rekomandimi: AKBN, Strukturat Përgjegjëse në plotësim të kuadrit ligjor dhe rregullator të miratuar:

- Të hartojnë dhe miratojnë një udhëzues të detajuar, ku të pasqyrohen të dhënat mbi procedurat e kryerjes së monitorimit, sistemin e detyrueshëm, e të domosdoshëm të çështjeve që do të mbikëqyren dhe monitorohen;

- të kryejnë inspektimin çdo 6 muaj të të gjitha subjekteve minerare dhe të miratojnë planet vjetore të punës të subjekteve-zotërues të lejes minerare;

- Të marrin masat për të përputhur treguesit e paraqitur në raportet e mbikëqyrjes dhe monitorimit me treguesit e raportuar në sistemin Revzone dhe treguesit e planit vjetor të miratuar të veprimtarisë minerare të dërguara online nga subjektet AKBN.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për rastet e moskryerjes së inspektimeve dhe mbikëqyrjeve nga AKBN sipas ligjit të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive apo rishikimin e kapaciteteve njerëzore dhe fondeve në dispozicion të kësaj strukture.

7.1. Rekomandimi: AKBN të marrë masat për njoftimin e subjektit menjëherë me përshkrimin e arsyes së pezullimit për shkeljet që bëhen shkak për pezullim, të konstatuara nga punonjësit e strukturës përgjegjëse dhe akti i konstatimit dhe në të njëjtën kohë ti propozojnë Ministrin për masat e penalitetet që duhet të ndërmerren ndaj subjekteve që nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit minerar mbi bazën e rezultateve të mbikëqyrjes dhe monitorimit të veprimtarive minerare.

8.1. Rekomandimi: AKBN në cilësinë e strukturës përgjegjëse të marrë masat dhe të ushtrojë kompetencat e saj për t'i propozuar MIE revokimin e lejeve minerare për ato subjekte që ushtrojnë veprimtari minerare dhe nuk japin informacionin e kërkuar nga strukturat përgjegjëse, paraqesin informacione të pavërteta, apo pengojnë strukturën përgjegjëse në ushtrimin e funksioneve të inspektimit, në zbatim të këtij ligji.

10.1. Rekomandimi: AKSEM të marrë masat për kryerjen e plotë dhe në mënyrë të vazhdueshme të inspektimeve në veprimtaritë minerare dhe ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave energjetike për verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë e mbrojtjen e shëndetit të punonjësve gjatë veprimtarisë së tyre në minierat nëntokësore dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike, minierat sipërfaqësore, fabrikat e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve.

11.1. Rekomandimi: MIE dhe AKBN të marrin masa të përshpejtuara për të siguruar nga:

- MIE monitorimin zyrtar për burimet e Kozelit, duke arritur në një rezultat në këtë drejtim;
- AKBN, institucion në varësi të MIE monitorimin e përvitshëm këtyre HEC-eve.
- MIE të ezaurojë plotësisht dhe në kohë detyrimin për mbarëvajtjen e koncesionit, të përcaktuar në pikën 7.6 të kontratës koncesionare me nr. 119 Rep., dhe nr. 94 Kol., të datës 12.01.2011 midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive "K K" SHPK dhe "L V T" SHPK.

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE, SI DHE MUNGESË TË ARDHURASH.

1.1. Rekomandimi: Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative të vlerësojë dhe shqyrtojë provat e sjella nga subjekti për shfuqizimin e masave administrative të marra ndaj zotërueseve të lejeve minerare nëse janë të mjaftueshme për të marrë vendim shfuqizimi ose lënien në fuqi të aktit administrativ, me argumentimin e zbatimit të drejtë të procedurave dhe ligjshmërinë në veprimet apo mosveprimet, për të cilat ankuesi ka pretenduar shkelje.

2.1. Rekomandimi: AKBN, Strukturat Përgjegjëse në plotësim të kuadrit ligjor dhe rregullator të miratuar:

- të miratojnë programe periodike ose të posaçëm, për të ushtruar kontrolle në çdo veprimtari minerare; duke hartuar raporte për mbikëqyrjen e monitorimin e këtyre subjekteve për çdo 6-mujor; ku të shprehen për numrin e punëtorëve, realizimin e prodhimit, treguesit teknologjikë,

realizimin e investimeve, realizimi i shitjeve brenda dhe jashtë vendit, të ardhurat e realizuara nga shitjet brenda vendit dhe eksportet, realizimi i rentës minerare; etje.

3.1. Rekomandimi: AKBN në zbatim të kërkesave të ligjit minerar nr. 10304, datë 15.7.2010 të marrë masat për nisjen e procedurës së vjeljes së detyrimit në shumën **27,200 mijë** lekë si masa administrative ndaj 121 subjekteve zotërues të lejeve minerare me qëllim disiplinimin e veprimtarisë së sektorit minerar.

4.1. Rekomandimi: AKBN në të ardhmen të mara masat për hartimin e raporteve të monitorimit me një informacion të plotë dhe të detajuar për zbatimin e planit të rehabilitimit, zbatimin e procedurave të mbylljes së minierave të braktisura të shfrytëzuar nga shteti, si dhe hartimi i një pasqyrimi të plotë për zonat e lejeve minerare të propozuara për konservim me qëllim rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike si investime në hartimin e raporteve vjetore mbi monitorimin e fenomeneve të post shfrytëzimit në minierat e mbyllura.

5.1. Rekomandimi: MIE dhe “A” SHA të marrin masat për rivlerësimin e aktiveve afatgjata pasuri sipërfaqësore që administrohen nga “A” SHA në likuidim e sipër, të cilat janë kontabilizuar sipas të dhënave që i përkasin periudhës 1970 e në vijim, për përputhjen e gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me dokumentacionin financiar me qëllim pasqyrimin e vërtetë të vlerave të këtyre pasurive.

- Nga MIE të përshpejtohet procesi ligjor i likuidimit të këtyre shoqërive, deri në shkrirjen dhe çregjistrimin përfundimtar të këtyre shoqërive duke evituar shpenzimet e konsiderueshme që i ngarkohen buxhetit të shtetit për kostot e stafit administrativ të minierave, shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe shpenzimet për kontraktimin e ekspertëve kontabël me status “*Sha në likuidim e sipër*” pasi këto shoqëri nuk kryejnë asnjë aktivitet prodhues por vetëm monitorimin e minierave dhe asetëve. Gjithashtu nga MIE, të studiohet dhe gjykohet mundësia e bashkimit me anë të përthithjes së të këtyre tre SHA-ve që operojnë në sektorin e industrisë minerare, në një shoqëri më vete, e cila duhet të realizojë procedurat e likuidimit të shoqërisë dhe të përjashtohet nga skema e financimit buxhetor.

- Nga MIE të merren masat për koordinimin dhe bashkërendimin me shoqëritë në likuidim e sipër, për rastet kur këto pasuri, galeri dhe zona minerare, jepen për shfrytëzim sipas lejeve të shfrytëzimit, për zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit, që janë pjesë e këtyre shoqërive në likuidim e sipër.

MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, geramat (b, c, ç) e nenin 58 “*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës*”, i ndryshuar, i rekomandohet Titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë disiplinore për drejtuesit e institucioneve të audituara, si dhe këto të fundit për punonjësit e varësisë sipas përgjegjësisë individuale dhe funksioneve zyrtare që mbajnë, si dhe të nisin procedurat për dhënien e masave disiplinore, në përputhje me kuadrin ligjor të rregullimit të marrëdhënieve përkatëse të punës.

V. ANEKSE

Aneksi nr. 1: “Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve për përmirësimet ligjore”

Subjekti	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar pjesërisht	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
						Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara	1			1	100				1
Totali	1			1	100				1

Aneksi nr. 2: “Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve për masat organizative”

Subjekti	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar pjesërisht	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
						Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
Kontrata e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”	32	2	8	22	94	2	9	2	17
Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	41	0	0	41	100	19	15	5	2
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë & Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	11	0	0	11	100	4	1		6
Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara	20	1		19	95	6	7		6
Totali	104	3	8	93	88.5	31	32	7	31

Aneksi nr. 3: “Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve për masat 3E, të ardhura të munguara”

Subjekti	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar pjesërisht	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
						Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	18	0	0	18	100		18		
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë & Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	5			5	100		3	1	1
Totali	23			23	100		21	1	1

Aneksi nr. 4: “Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve për dëmin ekonomik”

Subjekti	Rekomandime gjithsej	Pa pranuar	Pranuar pjesërisht	Pranuar	Shkalla e pranimit %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
						Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara	2			2	100		2		
Totali	2			2	100		2		

Aneksi nr. 5: “Të dhëna mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve për masat disiplinore”

Subjekti	Rekomandim e gjithsej	Pa pranuar	Pranuar pjesërisht	Pranuar	Pranimi %	Statusi i zbatimit të rekomandimeve			
						Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuar
Kontrata e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”	1		1		100	-	-	-	1
Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	1			1	100	1			
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë & Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	1			1	100				1
Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara	8			8	100	8			
Totali	11		1	10	100	9			2

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT